BESTSELLER

ALBERT CAMUS

I HUAJI

NJË ROMAN RRETH MOSKUJDESJES DHE ABSURDIT

"Sot, nëna vdiq. Ose ndoshta dje,
s'di."



ALBER KAMY

I HUAJI

PJESA E PARË

Alber Kamy-I huaji

I

Mamaja vdiq sot. Ndoshta edhe dje, nuk e di. Në telegramin që mora nga azili shkruhej: "Nëna vdiq. Varrimi nesër. Ngushëllime." Por kjo nuk do të thotë asgjë. Ndoshta ajo vdiq dje.

Azili i pleqve ndodhet në Marengo, tetëdhjetë kilometra larg Algjerit. Do t'i hipja autobusit të orës dy dhe do të mbërrija aty mbasdite. Kështu do të kisha mundësi të përgjoja kufomën dhe të kthehesha të nesërmen në mbrëmje. I kërkova pronarit tim dy ditë lejë, të cilat nuk kishte si të mos m'i jepte, kur ishte fjala për një rast të tillë. Por ai nuk tregoi ndonjë kënaqësi të madhe për nderin që po më bënte. Nga që u ndjeva ngushtë i thashë: "Nuk është për fajin tim." Ai nuk u përgjigj. Atëherë mendova se nuk duhej t'ia thosha ato fjalë. Por, në fund të fundit, nuk kisha përse të kërkoja falje. I takonte atij të më shprehte ngushëllimet e veta. Por këtë me siguri do ta bëjë pasnesër, kur të më shohë që po mbaj zi. Hë për hë, është njëlloj sikur mamaja nuk ka vdekur. Përkundrazi, pas varrimit, vdekja e saj do të jetë një çështje e mbyllur dhe çdo gjë do të marrë një karakter më zyrtar. I hipa autobusit të orës dy. Bënte shumë vapë.

Hëngra si zakonisht në restorant, te Seleta. Të gjithëve u vinte keq për mua dhe Çelesta më tha: Vetëm një nënë kemi.

Ata më shoqëruan deri te dera, kur u ngrita për të dalë. Isha si i trullosur, sepse m'u desh të ngjitesha tek Emanueli për t'i kërkuar borxh një kravatë të zezë dhe shiritin e zisë. Atij i kishte vdekur xhaxhai, para disa muajve.

Vrapova që të mos më linte autobusi. Me siguri, nga ngutja, vrapi, si dhe nga troshitjet e rrugës, erës së benzinës, përthyrjes së dritës në asfalt, diellit verbues që rrokullisej në qiell, më këputi gjumi. Kur u zgjova isha ngjeshur pas një ushtaraku, që më buzëqeshi dhe më pyeti nëse vija nga larg. I thashë "po" për të mos e zgjatur më tej.

Azili është dy kilometra nga fshati. Rrugën e bëra më këmbë. Doja të shihja sa më parë mamanë. Por portieri më tha se duhej të takoja në fillim drejtorin. Portierit nuk iu mbyll goja gjatë tërë kohës dhe, më pas, takova drejtorin: ai më priti në zyrën e tij. Ishte një plakush i shkurtër, me dekoratën Legjonit të nderit varur te jaka e xhaketës. Ai m'i nguli sytë që i shkëlqenin, pastaj më shtrëngoi dorën, duke ma mbajtur aq gjatë sa nuk dija si ta tërhiqja. Hapi një dosje dhe, duke i mbajtur sytë tek fletët e saj, më tha:

- Zonja Mërso hyri këtu para tre vjetësh. Ju ishit e vetmja mbështetje që kishte.

Mua m'u duk sikur po më qortonte për diçka dhe u përpoqa t'i shpjegoj. Por ai më ndërpreu:

- Biri im, nuk keni pse të përligjeni. E lexova dosjen e nënës suaj. Ju nuk ia plotësonit dot nevojat e saj. Asaj i duhej një njeri që t'i qëndronte mbi krye. Paga juaj është një pagë e thjeshtë. Dhe, për ta mbyllur këtë bisedë, këtu, ajo ishte më e lumtur. Unë thashë:

- Po, zoti drejtor.

Ai shtoi:

-Siç e dini, ajo gjeti këtu miq, moshatarë me të, me të cilët mund të ndante shqetësimet, që i përkasin një kohe tjetër. Ju jeni i ri dhe ajo do të mërzitej me ju.

Ishte e vërtetë. Mamaja, kur ishte në shtëpi, e kalonte tërë kohën duke më ndjekur me sy në heshtje. Ditët e para, kur shkoi në azil, qante shpesh. Por, pas disa muajve, ajo do të derdhte lot, po ta hiqnin nga azili. Dhe kjo ndodh gjithmonë për shkak të zakonit. Dhe pak për këtë e pak se ajo më merrte të dielën-pa llogaritur lodhjen për të shkuar tek autobusi, blerjen e biletës dhe dy orë rrugë - vitin e fundit pothuaj nuk shkova asnjëherë ta shihja. Drejtori vazhdoi të fliste, por unë gati nuk po e dëgjoja më. Pastaj ai më tha: Ma ha mendja se doni të shihni nënën

tuaj.

U çova pa folur asnjë fjalë dhe ai më priu drejt derës. Në korridor, më shpjegoi:

- E çuam në morgun tonë të vogël. Për të mos tronditur të tjerët. Sa herë që vdes ndonjë azilant, të tjerët, dy apo tre ditë, nuk janë në vete. Kjo e bën shërbimin të vështirë.

Alber Kamy-I huaji

I ramë përmes një oborri ku kishte shumë pleq, që bisedonin në grupe të vogla. Ata heshtnin kur kalonim pranë. Dhe sa i linim pas, bisedat ia nisnin përsëri. Ato ngjasonin me dërdëllitjet shurdhuese të papagajve. Drejtori më la te dera e një ndërtese

të vogël:

- Po u lë, zoti Mërso. Më keni gati për çdo gjë, në zyrën time. Në parim, varrimi është lënë për në orën dhjetë të mëngjesit. Menduam t'ju japim mundësinë të përgjoni për tërë natën të ndjerën. Kisha edhe një fjalë për t'ju thënë: nëna juaj u ka shprehur shpesh miqve të saj dëshirën për t'u varrosur sipas riteve fetare. Unë mora përsipër të bëj të pamundurën. Por doja t'iu vija në dijeni për këtë.

E falenderova. Mamaja, pa qenë ateiste, sa kishte qenë gjallë, nuk e kishte vrarë ndonjëherë mendjen për fenë. Hyra brenda. Ishte një sallë tërë dritë, e lyer me gëlqere dhe e mbuluar me xhama. Salla ishte plot me karrige dhe këmbaleca në formën e X. Në mes, dy prej tyre, mbanin një arkivol të mbuluar me kapak. Dukeshin vetëm vidat e shndritëshme, që nuk ishin shtrënguar deri në fund mbi dërrasat e veshura me rimeso arre. Pranë arkivolit, rrinte një infermiere arabe me një përparëse të bardhë dhe me një shall me ngjyra të ndezura në kokë. Portieri hyri atë çast nga prapa meje. Ai duhej të kishte vrapuar, sepse mezi belbëzoi:

- I vumë kapakun dhe më duhet ta zhvidhos tani që ta shihni.

Unë e ndala, kur po i afrohej arkivolit. Ai më tha:

- Nuk doni ta shihni?

Iu përgjigja:

- Jo.

Ai mbeti i shtangur dhe unë u angështova sepse e ndjeva se nuk duhej të kisha thënë atë që thashë. Ai më vështroi dhe, pas një çasti, më pyeti: - Përse? - por pa më qortuar, si të vihej në

dijeni.

I thashë:

- Nuk e di.

Atëherë, duke përdredhur mustaqet e bardha,

më tha, pa më vështruar:

- Të kuptoj shumë mirë.

Ai kishte sy të bukur, të kaltër të çelur dhe një çehre pak të kuqe. Më dha një karrige dhe për vete u ul pak prapa meje. Infermierja u çua dhe eci drejt daljes. Atë çast portieri më tha:

- Është me kancer.

Me që nuk po merrja vesh gjë, vështrova infermieren dhe pashë se nën sy kishte një fasho që i mbështillej rreth kokës. Në lartësinë e hundës, fashoja ishte e sheshtë. Në fytyrën e saj dukej vetëm bardhësia e fashos.

Sapo ajo u largua, portieri tha:

- Po ju lë vetëm.

Nuk e di ç'lëvizje bëra, por ai qëndroi, më këmbë prapa meje. Prania e tij prapa shpine po më bezdiste. Kthina ishte plot e përplot me dritën e

dy grerëza. Dhe ndjeva të më pushtonte gjumi. I bukur të fundit të mbasdites. Te qelqet gumëzhinin

thashë portierit:

- Keni kohë këtu?

Ai m'u përgjigj atypëraty:

- Pesë vjet - si ta kishte pritur prej kohësh

pyetjen time.

Më pas, nuk iu mbyll goja. Dukej që nuk i kishte shkuar kurrë në mendje se do ta mbyllte jetën tij si protier i azilit të Marengos. Ishte gjashtëdhjetë e katër vjeç dhe qe nga Parisi. Atë çast e ndërpreva:

-Ah, nuk jeni prej këtu? - Dhe u kujtova se para se të më çonte te drejtori më kishte folur për mamanë. Ai më kishte thënë se duhej varrosur shumë shpejt, sepse në rrafshinë bënte nxehtë, sidomos në atë vend. Atëherë më bëri të ditur se kishte jetuar në Paris dhe se e kishte të vështirë ta harronte.

-Në Paris, të vdekurin e përgjojnë tre, nganjëherë edhe katër ditë. Këtu, kjo është e pamundur, ju as që e merrni dot me mend sa nguten këtu për të mbaruar shpejt e shpejt varrimin. Njerëzit gati e ndjekin me vrap karrocën e varrimit.

Atëherë e shoqja i tha:

- Mbylle, pra gojën, këto nuk janë gjëra që i thuhen, zotërisë.

Plaku u skuq dhe kërkoi të falur. Unë ndërhyra për t'i dalë krah:

- Nuk ka gjë, nuk ka gjë. - Ajo që tregoi m'u duk e drejtë dhe interesante.

Ai me tregoi, në morgun e vogël, se në azil

kishte hyrë si nevojtar. Me që ndjehej ende në gjendje për të punuar, kishte kërkuar vendin e protierit. I vura në dukje se në fund të fundit ai ishte një azilant. Ai më tha jo. Mua më kishte bërë përshtypje mënyra që kishte për të thënë: "ata", "të tjerët" dhe, më rrallë, "pleqtë", duke e patur fjalën për disa azilantë që nuk ishin më të moshuar se ai. Por natyrisht, ai ishte ndryshe, ai ishte portier dhe, në një farë mase, kishte disa të drejta mbi ta.

Atë çast hyri infermierja. Mbrëmja kishte rënë përnjëherësh. Nata ishte dendësuar shumë shpejt mbi tavanin prej xhami. Portieri ktheu çelsin dhe mua më verboi shpërthimi i befasishëm i dritës. Ai më ftoi të shkonin të hanim darkë në mensë. Por nuk kisha uri. Atëherë më tha se do të më sillte një filxhan kafe me qumësht. Me qenë se më pëlqen shumë kafja me qumësht, pranova tërë qejf dhe ai u kthye pas pak me një tabaka në dorë. Piva kafen me qumësht dhe atëherë më kapi dëshira për të ndezur një cigare. Por ngurova sepse nuk e dija në mund ta pija para mamasë. Vrava mendjen dhe m'u duk se mund ta pija pa ndonjë shqetësim. I zgjata një cigare portierit dhe filluam të tymosnin të dy.

Pas një farë kohe, ai më tha:

- E dini, miqtë e zonjës, nënës suaj, do të vijnë ta përgjojnë edhe ata. Është zakon. Më duhet të dal për të kërkuar karrige dhe kafe të zezë.

I thashë nëse mund ta fikte një nga llambat. Shkëlqimi i dritës mbi muret e bardhë më lodhte. Ai më tha se nuk ishte e mundur. Instalimi ishte

bërë në mënyrë të tillë që o do t'i mbaje të gjitha ndezur ose do t'i fikje të gjitha. Nuk ia vura me veshin. Ai doli, u kthye, rregulloi karriget. Mbi njërën prej tyre, vuri rreth një ibriku kafeje disa filxhanë. Pastaj u ul përballë meje, në anën tjetër të mamasë. Infermierja kishte zënë vend në fund të arkivolit, me shpinën kthyer nga ne. Nuk shihja ç'bënte. Por nga lëvizja e krahëve, merrej me mend se punonte me shtiza. Bënte butë, kafja më kishte ngrohur dhe nga dera e hapur hynte aroma e natës dhe e luleve. Më duket se mora një sy gjumë.

U zgjova nga një përkitje. Nga që i kisha patur sytë mbyllur, kthina m'u duk edhe më verbuese nga bardhësia. Para meje nuk kishte asnjë hije dhe çdo objekt, çdo qoshe, të gjitha lakoret ravijëzoheshin me një pastërti vrasëse për sytë. Dhe pikërisht atë çast hynë miqtë e mamasë. Ata rrëshqitën në heshtje nën dritën verbuese. Gjithsej bëheshin nja dhjetë veta. U ulën me aq kujdes sa nuk kërciti asnjë karrige. I shihja si nuk kisha parë kurrë njeri dhe nuk më shpëtonte asnjë hollësi e fytyrës apo e veshjeve të tyre. Nuk ua dëgjoja zërin dhe e kisha të vështirë të besoja se ndodheshin aty, pranë meje. Pothuaj të gjitha gratë ishin me përparëse dhe kordoni që i shtrëngonte në mes, nxirrte më në pah barkun e tyre të fryrë. Nuk e kisha vënë asnjëherë re se deri në ç'pikë mund të kenë bark gratë e moshuara. Ndërsa burrat ishin pothuaj të gjithë shumë thatanikë dhe mbanin në dorë nga një shkop.Ajo që më bënte më shumë përshtypje në fytyrën e tyre, ishte se nuk u

shihja sytë, por vetëm një dritë pa shkëlqim, mes një rrjete rrudhash. Përgjuesit e nënës u ulën, pjesa më e madhe m'i nguli mua sytë, duke lëvizur pakapshëm buzët e ngrëna në gojën pa dhëmbë dhe duke tundur tërë angushtim kokën. Nuk e kuptova, u përshëndetën me mua apo ishte një lloj ngërçi. Por më shumë m'u duk se më përshëndetën. Vetëm atë çast vura re se të gjithë tundnin kokën të ulur përballë meje, më të mëngjër të portierit. Për një çast m'u duk sikur ata ndodheshin aty për të më gjykuar.

S'kaloi shumë dhe njëra nga gratë filloi të qajë. Ajo ishte në rreshtin e dytë, fshehur pas njërës prej shoqeve të saj, prandaj nuk e shihja mirë. Ajo qante duke lëshuar britma të shkurtëra, të rregullta: mua m'u duk sikur nuk do të ndalej kurrë. Të tjerët dukeshin sikur nuk e dëgjonin. Ata rrinin të mërzitur, të zymtë dhe të heshtur, duke i mbajtur sytë në një pikë: dikush vështronte arkivolin, dikush shkopin e tij ose diçka tjetër. Gruaja vazhdonte të qante. Mbeta shumë i habitur, sepse nuk e njihja. Sa do doja të mos e dëgjoja më. Megjithatë nuk guxoja t'ia thosha. Portieri u përkul drejt saj, i foli, por ajo tundi kokën, belbëzoi dhe vazhdoi të qante me të njëjtën rregullsi. Portieri erdhi pranë meje. Pas një heshtjeje të gjatë, më vuri në dijeni pa më vështruar:

- Ajo ishte shumë e lidhur me nënën tuaj. Ajo thotë se nëna juaj ishte mikja e saj e vetme dhe se tani ka mbetur pa njeri.

Kaloi ca kohë. Psherëtimat dhe ngashërimet e gruas u rralluan. Ajo rrufiste shpesh hundën. Më

në fund heshti. Nuk kisha më gjumë, por isha i lodhur dhe më dhembnin ijet. Nuk po e duroja më heshtjen e gjithë atyre njerëzve. Herë pas here dëgjoja një zhurmë të veçantë, që nuk e kuptoja ç'ishte. Në fund të fundit e mora me mend se dikush nga pleqtë thithte brenda gojës faqet dhe lëshonte ato kërcitje të çuditshme. Pleqtë as që e vinin re, kaq thelle ishin zhytur në mendime. Madje mua m'u duk sikur e vdekura, shtrirë në mes të tyre, nuk kishte asnjë rëndësi për ta. Por tani e di se ajo ishte një përshtypje e gabuar.

Të gjithë pimë kafen që na shërbeu portieri. Më pas, nuk e di ç'ndodhi. Nata kaloi. Më kujtohet që për një çast hapa sytë dhe pashë se pleqtë flinin të mbledhur shuk, me përjashtim të një të vetmi që, me mjekrën mbi shpinën e duarve të mbërthyera te koka e shkopit, më vështronte pa m'i ndarë sytë, sikur të priste zgjimin tim. Pastaj fjeta përsëri. U zgjova se po më dhimbnin përherë e më shumë ijet. Agullimi po rrëshqiste mbi tavanin e xhamtë. Pak më pas u zgjua një nga pleqtë, të cilin e mbyti kolla. Ai pështynte mbi një shami të madhe me katrorë dhe secila prej këlboqeve dukej sikur shkëpuste diçka nga brenda tij. Kolla e tij zgjoi pleqtë e tjerë dhe portieri tha se ata duhej të niseshin. Ata u çuan. Përgjimi i parehatshëm ua kishte bërë fytyrën të hirtë. Duke dalë, për habinë time të madhe, të gjithë më shtrënguan dorën - sikur ajo natë ku nuk kishim shkëmbyer asnjë fjalë kishte rritur afërsinë tonë.

Isha i lodhur. Portieri më mori në odën e tij

të vogël dhe të ngushtë, ku rregullova pak veten. Piva përsëri kafe me qumësht, që ishte shumë e mirë. Kur dola, kishte lindur plotësisht dita. Qielli kuqërronte mbi kodrat që ndanin Marengon nga deti. Dhe era që frynte sipër tyre sillte deri këtu një aromë kripe. Po gatitej një ditë e bukur. Kisha shumë kohë pa dalë nga qyteti dhe sa shumë do të kënaqesha sikur të dilja shetitje dhe sikur të mos ishte vdekja e mamasë.

Prita në oborr, nën një rrap. Thithja aromën e tokës së freskët dhe nuk kisha më gjumë. Mendja më shkoi te shokët e zyrës. Në atë orë ata ngriheshin për të shkuar në punë: për mua ajo mbetej gjithmonë ora më e vështirë. Po vrisja mendjen për këto gjëra, kur më shkëputi prej tyre një kambanë që binte brenda ndërtesës. Prapa dritareve u dëgjua një zhurmë e rrëmujshme, pastaj çdo gjë u fashit. Dielli ishte ngritur pak më shumë në qiell: ai filloi të ngrohë këmbët e mia. Portieri eci përmes oborrit dhe më tha se më kërkonte drejtori. Shkova në zyrën e tij. Ai më dha për të nënshkruar tërë ato letra. Pashë se ishte veshur me të zeza, me pantallona me vija. Mori telefonin në dorë dhe më pyeti:

-Nëpunësit e zyrës së varrimit kanë ardhur. Do t'u them të shkojnë dhe të mbyllin arkivolin. Para se të mbyllin arkivolin, doni të shihni nënën tuaj për herë të fundit?

I thashë jo. Ai urdhëroi në telefon duke ulur zërin:

- Fizhak, thuaju njerëzve të tu se mund të fillojnë.

dhe unë e falenderova. Ai u ul prapa tryezës së Më pas më tha se do të merrte pjesë në varrim punës dhe kryqëzoi këmbët e shkurtëra. Pastaj më paralajmëroi se në varrim do të ishim vetëm ai, unë dhe infermierja e shërbimit. Ishte bërë rregull që azilantët të mos merrnin pjesë në varrime. Ai i linte

vetëm të përgjonin të vdekurin.

- Kjo do të thotë të jesh sa më i njerëzishëm, - vuri në dukje, por në rastin e dhënë i kishte dhënë lejë të ndiqte varganin një miku të vjetër të mamasë: Tomas Perezit. - këtu, drejtori qeshi. Ai më tha:- E kuptoni dhe vetë, është një ndjenjë foshnjarake. Por ai dhe nëna juaj nuk ndaheshin kurrë. Në azil, bënin shaka me ta, Perezit i thoshin :"Kjo është e fejuara juaj." Ai vinte buzën në gaz. Atyre u vinte mirë kur e dëgjonin. Dhe duhet thënë se vdekja e zonjës Mërso, e ka prekur thellë. Unë mendova se nuk kisha të drejtë ta ndaloja të merrte pjesë në varrim. Por me këshillën e mjekut, që na viziton, e ndalova të përgjonte dje të vdekurën.

Qëndruam pa folur për një kohë të gjatë. Drejtori u çua dhe vështroi nga dritarja e zyrës. Pastaj

tha:

- Ja dhe prifti i Marengos. Ka ardhur para kohe. - Ai më paralajmëroi se do të duheshin të paktën tre çerek ore më këmbë për të shkuar te kisha që ndodhej në fshat. Zbritëm në oborr. Prifti dhe dy fëmijë të korit, ndodheshin para morgut. Njëri prej fëmijëve mbante një temjanicë dhe prifti ulej drejt tij për të rregulluar gjatësinë e zinxhirit prej argjendi.

Alber Kamy - I huaji

Kur mbërritëm ne, prifti drejtoi trupin. Ai më thirri "biri im" dhe më tha disa fjalë. Pastaj hyri brenda në morg; e ndoqa pas.

Mua më ra menjëherë në sy se vidat e arkivolit ishin mbërthyer mirë dhe se në kthinë ndodheshin katër burra veshur me të zeza. Dëgjova në të njëjtën kohë drejtorin që më tha se karroca po priste te rruga dhe priftin që ua nisi lutjeve të tij. Duke filluar nga ai çast, çdo gjë rrodhi shpejt e shpejt. Burrat bënë për nga arkivoli me një çarçaf. Prifti, pasuesit e tij, drejtori dhe vetë unë dolëm nga morgu. Para derës ishte një zonjë që nuk e njihja:

- Zoti Mërso, - më paraqiti tek ajo drejtori.

Emrin e zonjës nuk e dëgjova por vetëm kuptova se ishte infermierja. Ajo mblodhi, pa vënë buzën në gaz, fytyrën e saj kockore dhe të gjatë. Pastaj u rreshtuam për të kaluar trupi. Ndoqëm pas hamejtë dhe dolëm nga azili. Karroca priste para derës, e lyer, e gjatë dhe e shndritëshme, si një mbajtëse pene. Në anë të saj qëndronte drejtuesi i proçesionit, një burrë trupvogël me veshje qesharake dhe një plak me një pamje të ngathët. E mora me mend se duhej të ishte zoti Perez. Kur nxorrën arkivolin nga morgu, hoqi nga koka kapelen e rrumbullakët, me anë të gjera, si takije prifti. Ai kishte veshur një kostum, pantallonat e të cilit rrinin puthitur pas këpucëve me qafa, një kravatë prej cohe me kokën shumë të vogël për këmishën e tij me jakë të madhe të bardhë. Buzët i dridheshin nën një hunde mbushur plot pika të zeza. Flokët e tij të bardhë e mjaft të hollë nuk i

mbulonin dot veshët, të cilët ngjanin me ca llapa të shëmtuara, ngjyra e kuqe gjak e të cilëve të bënte shumë përshtypje në atë fytyrë të venitur. Drejtuesi vuri secilin prej nesh në vendin që duhej të kishte në atë vargan të vogël. Prifti ecte përpara, pastaj karroca. Rreth saj, katër burrat. Prapa, drejtori, unë dhe vargani i vogël mbyllej nga infermierja dhe zoti Perez. Dielli sundonte mbarë qiellin. Ai filloi të rëndojë mbi tokë dhe zhegu po rritej me shpejtësi. Nuk e di përse kishim pritur aq gjatë para se të niseshim. Kisha vapë nën rrobat e mia të errta. Plaku i vockël e kishte hequr përsëri kapelen nga koka. U ktheva pak nga ai dhe e vështrova ndërsa drejtori po më fliste për të. Ai më tha se nëna ime dhe zoti Perez shkonin shetitje në mbrëmje deri në fshat, të shoqëruar nga një infermiere. Vështrova fushën që shtrihej rreth meje. Dhe atëherë, përmes atij rreshti me qiparisa që lartoheshin drejt qiellit majë kodrave, rrafshinës së kuqe dhe të gjelbër, shtëpive të rralla që shquheshin qartë, kuptova nënën. Në mbrëmje, ajo tablo duhej të ngjallte ndjenjën e prehjes dhe të trishtimit të heshtur. Sot, dielli përcëllues, drithëronte ajrin, duke e kthyer atë peizazh në një peizazh ndrydhës dhe aspak njerëzor.

U nisëm për udhë. Atë çast vura re se Perezi çalonte lehtë. Karroca po merrte pak nga pak shpejtësi dhe plaku po mbetej prapa. Edhe njëri nga burrat që rrethonin karrocën, mbeti pas dhe tani ecte krahas meje. U befasova nga shpejtësia me të cilën dielli ngjitej në qiell. Dhe pashë se rrafshina kishte

kohë që gumëzhinte nga kënga e insekteve dhe kërcitjet e barit. Djersa më kullonte faqeve. Me që nuk kisha kapelë, bëja fresk me shaminë time. Atëherë nëpunësi i zyrës së varrimeve më tha diçka që nuk e dëgjova. Ai fshiu, në të njëjtën kohë, kokën me një shami që e mbante në dorën e majtë, kurse me dorën e djathtë ngrinte anën e kasketes. I thashë: - Çfarë?

Ai përsëriti duke treguar qiellin: Të bie drejt e në kokë.

Unë i thashë:

- Ashtu është.

Pak më pas ai më pyeti: -Nëna jotë është ajo atje?

I thashë përsëri:

- Po.

- Ishte e vjetër?

U përgjigja:

- Një farë soji, - sepse nuk e dija me saktësi ç'moshë kishte. Më pas, ai e qepi gojën. Ktheva kokën dhe pashë plakun Perez, nja pesëdhjetë metra prapa nesh. Ai nxitonte duke tundur kapelën. Vështrova edhe drejtorin. Ai ecte tërë dinjitet, pa bërë asnjë lëvizje të kotë. Mbi ballin e tij shndrisnin disa pika djerse, të cilat i linte pa fshirë.

Mua m'u duk sikur vargani po ecte pak më shpejt. Rreth meje shtrihej e njëjta rrafshinë e mbytur nga dielli. Shkëlqimi i qiellit ishte i padurueshëm. Kaluam mbi një pjesë të rrugës të sapoarnuar. Dielli kishte shkrirë ziftin. Këmbët zhyteshin brenda

ziftit, duke lënë të hapur tulin e tij të shndritshëm. Mbi karrocën e varrimit, kapela prej lëkure karrocierit, dukej sikur ishte mbrujtur prej atij llumi të zi. Ndjehesha disi i humbur midis atij qielli të kaltër dhe të bardhë dhe njëtratshmërisë së atyre ngjyrave, të zezës ngjitëse të ziftit të shkrirë, të zezës së marrtë të rrobave dhe të zezës së shndritëshme të karrocës. Të gjitha këto së bashku me diellin, erën e lëkurës dhe të bajgave të kuajve, të llakut dhe të temjanit, të lodhjes së një nate pa gjumë, më mjegulluan vështrimin dhe mendimet. Ktheva edhe një herë tjetër kokën: Perezi m'u duk tepër larg, mbështjellë nga mjegulla që ngrinte lart nxehtësia, pastaj nuk e vura më re. E kërkova me sy dhe pashë se kishte lënë rrugën dhe kishte marrë përmes arave. Po ashtu pashë se rruga bënte një dredhë para meje. E kuptova se Perezi e njihte mirë vendin dhe po i binte për më shkurt që të na kapte. Ai u bashkua me ne te kthesa. Pastaj e humbëm përsëri. Ai i ra për shkurt tërë ato herë përmes arave. Për vete ndjeja gjakun të më rrihte tempthat.

Më pas gjithçka rrodhi me aq shumë ngutje, siguri dhe natyrshmëri, sa nuk mbaj mend asgjë. Vetëm një gjë më është ngulitur në mendje: në hyrje të fshatit më foli infermierja. Ajo kishte një zë të veçantë që nuk shkonte aspak me fytyrën e saj, një zë melodioz dhe drithërues. Ajo më tha:

Po ecëm ngadalë, do të na bjerë dielli në kokë. Por po ecëm shpejt, do bëhemi me djersë dhe do të marrim ndonjë të ftohur në kishë.

Alber Kamy - I huaji

Kishte të drejtë. Por nuk kishe nga t'ia mbaje. Nga ajo ditë ruaj edhe disa copëza kujtimesh: për shembull, fytyrën e Perezit kur u bashkua me ne për herë të fundit, pranë fshatit. Mbi faqe i çurgonin lotë nervozizmi dhe mundimi. Por, për shkak të rrudhave, ato nuk kullonin. Ato shkriheshin së bashku dhe formonin një llak uji mbi atë fytyrë të rrënuar. Pastaj vjen kujtimi i kishës dhe i banorëve të fshatit në trotuare, barbarozat e kuqe mbi varret e varrezës, të fiktët e Perezit (ai ra si një dordolec i thyer), dheu ngjyrë gjaku që rrokullisej mbi arkivolin e mamasë, mishi i bardhë i rrënjëve që përziheshin aty, pastaj përsëri njerëz, zëra, fshati, pritja para një kafeje, gërhitja e pandërprerë e motorit dhe gëzimi im kur autobuzi hyri mes dritave të Algjerit dhe kur mendova se do të shtrihesha dhe do të flija plot dymbëdhjetë orë.

II

Duke u zgjuar, kuptova përse pronari im rrudhi fytyrën i pakënaqur kur i kërkova dy ditë lejë: ai u thartua ashtu sepse sot është e shtunë. Kjo gjë më kishte dalë krejt nga mendja, por duke u çuar nga shtrati, më lindi papritmas ky mendim. Pronari im, krejt natyrshëm, ka menduar se do të më bëheshin, së bashku me të dielën, katër ditë pushim dhe kjo nuk kishte si ta kënaqte. Por nga njëra anë, nuk është për fajin tim që mamaja u varros dje dhe jo sot dhe nga ana tjetër, ne nuk punojmë as të shtunë dhe as të dielë. Megjithatë kjo nuk më pengon t'i jap plotësisht të drejtë pronarit tim.

Mezi u çova nga shtrati, sepse isha i rraskapitur nga dita e djeshme. Kur po rruhesha vrava mendjen se ku mund t'i shtyja orët dhe vendosa të shkoja të lahesha. I hipa tramvajit për të shkuar në kabinat e portit. Atje u zhyta te kanali dhe notova në det. Kishte shumë të rinj. Në ujë u përplasa me Mari Kardonën, një daktilografiste e vjetër e zyrës sime, të cilën e kisha lakmuar dikur. Por më duket se edhe ajo më kishte qejf. Maria u largua nga puna dhe që atëherë nuk ishim takuar më. E ndihmova të hipte në një mbiujëse dhe, ndërsa po e ngrija, i fshika gjinjët.

Unë isha ende në ujë kur ajo u shtri barkas në mbiujësen. Pastaj u kthye nga unë. Flokët i binin mbi sy dhe qeshte. U ngjita pranë saj në mbiujëse. Bënte mot i bukur dhe, si me shaka, hodha kokën dhe e vendosa mbi barkun e saj. Ajo nuk tha asnjë fjalë dhe unë nuk lëviza nga vendi. Para syve kisha tërë qiellin dhe ai ishte i kaltër dhe i praruar. Nën zverk, ndjeja barkun e Marisë të rrihte ngadalë. Qëndruam gjatë në mbiujëse, gjysmë të përgjumur. Kur dielli u bë më i fortë, ajo u hodh në ujë dhe unë e ndoqa pas. E kapa, i hodha dorën rreth belit dhe notuam së bashku. Ajo qeshte vazhdimisht. Te moli, ndërsa po thaheshim, ajo më tha:

- Jam më zeshkane se ti.

E pyeta në donte të vinte në kinema atë mbrëmje. Ajo qeshi përsëri dhe më tha se kishte dëshirë të shihte një film me Fernandelin. Kur u veshëm, mbeti e habitur kur më pa me kravatë të zezë. Më pyeti mos po mbaja zi. I thashë se më kishte vdekur mamaja. Me që donte të dinte se kur kishte ndodhur, iu përgjigja:

- Dje.

Ajo u tërhoq pak prapa, por nuk tha as edhe një fjalë të vetme. Pata dëshirë t'i thosha se nuk kisha asnjë faj për vdekjen e nënës, por u përmbajta kur mendova se kështu i kisha thënë pronarit tim. Por tashmë nuk kishte asnjë kuptim. Njeriu është gjithmonë pak fajtor për diçka.

Në mbrëmje, Maria i kishte harruar të gjitha. Filmi kishte skena që të shkrinin së qeshuri, ashtu

si kishte dhe skena të kota. Maria e kishte këmbën ngjitur pas këmbës sime. Ia perkedhela gjinjtë. Aty nga fundi i seancës e putha, por jo ashtu si doja. Pas filmit, erdhi në shtëpinë time. Kur u zgjova, Maria ishte larguar. Më kishte thënë që në mbrëmje se duhej të shkonte te tezja e saj. Mendova menjëherë se ishte e dielë dhe u mërzita: nuk e dua të dielën. U ktheva përsëri në shtrat, kërkova te jastëku aromën e kripës që kishin lënë aty flokët e Marisë dhe fjeta deri në orën dhjetë. Pastaj piva cigare, pa lëvizur nga shtrati, deri në mesditë. Nuk doja të haja si zakonisht drekë te Çeleste sepse, me siguri, do të më mbysnin me pyetje dhe unë nuk kisha qejf të përgjigjesha. Skuqa vezë dhe i hëngra thatë, sepse më ishte mbaruar buka dhe nuk doja të zbrisja për të blerë.

Pas drekës, më filloi mërzia dhe, nga që nuk dija si ta largoja, nisa të vërtitem nëpër apartament. Kur mamaja jetonte këtu ai ishte një apartament i rehatshëm. Tani më duket është shumë i madh për mua, prandaj m'u desh ta mbart në dhomën time tryezën e sallës së ngrënies. Tani jetoj vetëm në këtë dhomë, midis karrigeve prej kashte të bëra pak gropë, dollapit, pasqyra e të cilit është zverdhur, tryezës së tualetit dhe shtratit prej bakri. Pjesa tjetër është lënë pas dore. Pak më vonë, për të mos qëndruar duarkryq, mora një gazetë të vjetër dhe e lexova. Preva një reklamë të kripërave Krushen dhe e ngjita në një fletore të vjetër, ku vë gjërat që më zbavitin nëpër gazeta. Lava duart dhe, për t'i dhënë fund, dola në

ballkon.

Dhoma ime bie mbi rrugën kryesore të rrethinës. Mbasditja ishte e bukur. Megjithatë, kalldrëmi ishte i lërosur dhe ata pak njerëz që kalonin, nxitonin. Në fillim ishin familjet që dilnin shetitje, dy djem të vegjël me kostum marinari, pantallona të shkurtëra mbi gjunjë, që e ndjenin veten ngushtë në rrobat e tyre të ngrira dhe një vajzë e vogël me një fjongo të madhe ngjyrë trëndafili dhe këpucë të zeza me qafë, që shkëlqenin nga boja. Prapa tyre, një nënë sa e gjerë aq edhe e gjatë, me fustan mëndafshi ngjyrë gështenje dhe babai, një burrë i vockël mjaft i brishtë, të cilin e njihja për fytyrë. Ai kishte një kapele kashte, një papijon dhe, në dorë, një bastun. Duke e parë me të shoqen, e kuptova përse mbahej në lagje për një burrë i hijshëm. Pak më pas kaluan të rinjtë e rrethinës, me flokët gjithë llak dhe kravatë të kuqe, xhaketën puthitur pas trupit, me xhepin e vogël të qëndisur dhe me këpucët me maja katrore. Ma mori mendja se po shkonin në kinemanë e qendrës. Prandaj dhe niseshin aq herët dhe nxitonin drejt tramvait duke qeshur me të madhe.

Pas tyre, rruga u bë pak nga pak e shkretë. Shfaqjet kishin nisur kudo. Në rrugë kishin mbetur vetëm dyqanxhinjtë dhe macet. Qielli ishte i kthjellët por pa shkëlqim mbi fikusat anës rrugës. Në trotuarin përballë, shitësi i cigareve, kishte nxjerrë karrigen, e kishte vënë para derës dhe e kishte shaluar duke mbështetur krahët mbi shpinën e saj. Tramvajet që pak më parë ishin plot e përplot, tani kalonin

pothuaj pa asnjë njeri brenda. Te kafeneja e vogël "Te Pjeroja", në krah të shitësit të cigareve, kamarieri fshinte tallashin në sallën e shkretë. Ishte me të vërtetë e dielë. Ktheva karrigen dhe e vura si shitësi i cigareve, sepse m'u duk më rehatshëm. Piva dy cigare, u futa brenda për të marrë një copë çokollatë dhe u ktheva ta haja te dritarja. Pak më pas, qielli u errësua dhe mua m'u duk sikur do të shpërthente ndonjë shtrëngatë vere. Megjithatë ai u çel pak nga pak. Por kalimi i reve kishte lënë mbi rrugë premtimin e një shiu të dështuar, duke e bërë atë edhe më të zymtë. Qëndrova gjatë në dritare duke vështruar qiellin.

Në orën pesë tramvajet mbërritën mes poteres. Ato sillnin nga stadiumi i periferisë grupet e tifozëve që rrinin varur te shkallaret dhe parmakët. Tramvajet e mëvonëshme sollën lojtarët, të cilët i njoha nga valixhet e vogla. Ata bërtisnin dhe këndonin sa u hanin mushkëritë se klubi i tyre nuk do ta njihte kurrë humbjen. Shumë prej tyre ma bënë me shenjë. Madje njëri më bërtiti:

I shqepëm në dru.

Dhe unë ia bëra: "Po" duke tundur kokën. Makinat vërshuan, duke filluar nga ai çast.

Dita u thye edhe pak. Mbi çatitë qielli u bë i kuqerremtë dhe, me të rënë mbrëmja, rrugët u gjallëruan. Njerëzit që kishin dalë shetitje po kthehesin në shtëpi. Mes të tjerëve dallova burrin e hijshëm. Fëmijët qanin ose e kishin lëshuar veten t'i tërhiqnin zvarrë. Kinematë e lagjes derdhën

menjëherë në rrugë një valë shikuesish. Mes tyre, të rinjtë bënin disa gjeste më të vendosura se zakonisht dhe e mora me mend se kishin parë ndonjë film me aventura. Ata që kishin qenë në kinematë e qytetit, arritën pak më vonë. Ata dukeshin më hijerëndë, vazhdonin të qeshnin, por herë pas here, dukeshin të lodhur dhe ëndërrimtarë. Qëndruan në rrugë, duke ecejakur në trotuarin përballë. Vajzat e reja të lagjes, me flokët lëshur mbi supe, ecnin duke mbajtur për krahu. Djemtë filluan t'u prisnin rrugën dhe bënin shaka me të cilat ato qeshnin, duke kthyer kokën. Shumë prej tyre, të cilat i njihja, ma bënë me shenjë.

Dritat e rrugës u ndezën përnjëherësh dhe i zbehën yjet e parë që vezullonin natën. Ndjeva të më lodheshin sytë duke vështruar trotuaret, kalimtarët dhe dritat. Llambat shndrisnin kalldrëmin e lagur dhe tramvajet, në intervale të rregullta, hidhnin pasqyrimet e tyre mbi flokët e shndritshëm, mbi një buzëqeshje apo mbi një byzylyk argjendi. Lagjia u zbras si pa u ndierë, së bashku me tramvajet e rralluara dhe natën tashmë të errët mbi drurët dhe llambat, sa macja e parë përshkoi ngadalë rrugën përsëri të shkretë. Atëherë mendova se duhej të haja darkë. Më dhimbte pak qafa, nga që kisha qëndruar gjatë mbështetur mbi shpinën e karriges. Zbrita për të blerë bukë dhe makarona, gatova dhe hëngra më këmbë. Doja të pija një cigare në dritare, por ajri ishte freskuar dhe pata pak ftohtë. Mbylla dritaret dhe duke u kthyer pashë në pasqyrë një pjesë të tryezës

ku llamba ime me alkool rrinte në fqinjësi me copra buke. Ja, mendova, të dielën e kalova si e kalova, mamanë e varrosa, do të rifilloj punën dhe, në fund të fundit, asgjë nuk ka ndryshuar.

III

Sot pata shumë punë në zyrë. Pronari u tregua i përzemërt. Ai më pyeti në isha shumë i lodhur dhe donte të dinte edhe ç'moshë kishte mamaja. Unë thashë "rreth të gjashtëdhjetave", për të mos gabuar, ai u duk i lehtësuar dhe i vuri pikë asaj çështjeje.

Mbi tryezën time kishte një pirg me fatura, të cilat duhej t'i kontrolloja një për një. Lava duart, para se të dilja nga zyra, për të ngrënë drekë. Në mesditë, ky çast, më pëlqen shumë. Në mbrëmje më jep më pak kënaqësi, sepse peshqiri rrotullues është i gjithi i qullur: ai ka shërbyer tërë ditën për të gjithë. Ia vura një herë në dukje këtë gjë paronarit tim. Ai m'u përgjigj se ishte për të ardhur keq, por megjithatë ishte diçka pa rëndësi. Dola pak më vonë, më dymbëdhjetë e gjysëm, së bashku me Emanuelin, që merret me shpërndarjen. Zyra sheh nga deti dhe humbën tërë atë kohë duke vështruar anijet e mallrave në portin e përvëluar nga dielli. Atë çast po vinte mes një potere zinxhirësh dhe shpërthimesh një kamion. Emanueli më pyeti "I kërcejmë përsipër?" dhe unë ia krisa vrapit. Kamioni na kaloi dhe ne u lëshuam në ndjekje të tij. U mbyta në zhurmë dhe pluhur. Nuk shihja më asgjë dhe ndjeja vetëm vrullin e çrregullt

të vrapimit, mes çikrikëve dhe makinave, direkëve që vallëzonin në horizont dhe anijeve, pranë të cilave kalonim çdo ditë. U kapa i pari pas spondit dhe u hodha brenda në karroceri. Pastaj ndihmova Emanuelin të ulej. Mezi merrnim frymë, kamioni hidhej përpjetë mbi kalldrëmin me gunga të skelës, mes pluhurit dhe diellit. Emanuelit iu zu fryma nga të qeshurit.

Te Çeleste arritëm të mbytur në djersë. Ai ishte përherë në vendin e vet, me barkun e tij të madh, përparësen dhe mustaqet e bardha. Ai më pyeti "nëse mbahesha ndopak". I thashë po dhe se kisha uri. Hëngra shumë shpejt dhe piva kafe. Pastaj u ktheva në shtëpi, fjeta pak sepse kisha pirë shumë verë dhe, duke u zgjuar, pata dëshirë të ndizja një cigare. Ishte vonë dhe vrapova për të kapur tramvajin. Punova tërë mbasditen. Në zyrë bënte shumë nxehtë dhe në mbrëmje, duke dalë, isha i lumtur që po kthehesha duke ecur ngadalë përgjatë skelës. Qielli mori një ngjyrë të gjelbër, vetë ndjehesha i kënaqur. Megjithatë, u ktheva drejt e në shtëpi sepse doja të përgatitja patate të zjera.

Duke u ngjitur, në shkallën e errët, u përplasa me plakun Salamano, fqinjin tim. Ai ishte me qenin e vet. Kanë tetë vjet që nuk ndahen asnjëherë. Spanjeli ka një sëmundje lëkure, zgjeben më duket, që ia ka rrëzuar pothuaj të gjitha qimet dhe e ka mbuluar me pulla tërë kore të errëta. Plaku Salamano jeton vetëm me të në një dhomë të vogël dhe tani i ngjan qenit të tij. Ai ka kore të kuqerremta në fytyrë dhe qime të

verdha dhe të rralla. Qeni ka marrë nga i zoti një lloj qëndrimi të kërrusur, turirin para dhe qafën të nderë. Ata duket sikur janë nga e njëjta racë e megjithatë e urrejnë njëri-tjetrin. Dy herë në ditë, në orën njëm- bëdhjetë dhe në orën gjashtë, plaku nxjerr shetitje qenin. Ata kanë ndjekur, pa e ndryshuar asnjëherë për tetë vjet rresht, të njëjtën rrugë. Ata mund t'i shohësh përgjatë rrugës së Lionit, qeni duke tërhequr njeriun deri sa plaku Salamano pengohet. Atëherë ai rreh qenin dhe e shan. Qeni hiqet rrëshqanë nga tërbimi dhe e lë veten ta zvarrisin. Kur ndodh kështu, i mbetet plakut Salamano ta tërheqë. Kur qeni har- ron, ai tërheq përsëri të zotin dhe nga kjo ha përsëri dru dhe të shara. Atëherë, qëndrojnë të dy në trotuar dhe vështrojnë njëri-tjetrin, qeni me lemeri, njeriu me urrejtje. Kjo përsëritet çdo ditë. Kur qeni do të urinojë, plaku nuk i lë kohë të mbarojë por e tërheq dhe spanjeli mbjell pas vetes një tragë pikash të vogla. Edhe nëse rastësisht qeni e bën në dhomë, përsëri do të rrihet. Dhe kjo ka tetë vjet që vazhdon. Çeleste thotë gjithmonë "Ja dhe fatzinjtë", por në fund të fundit, askush nuk e vret mendjen për këtë. Kur e takova te shkalla, Salamanoja ishte duke e qor- tuar qenin. Ai i thoshte: " Maskara! Coftinë!", kurse qeni kujiste. I thashë: "Mirëmbrëma", por plaku vazhdonte lumin e sharjeve. Atëherë e pyeta se ç'faj kishte bërë qeni. Nuk m'u përgjigj. Vetëm shante: "Maskarai! Cofetina!" E mora me mend se ishte përkulur mbi qenin duke u marë me qaforen e tij. I fola më fort. Atëherë m'u përgjigj, pa u kthyer nga

unë, me një lloj tërbimi: "Është ngulur këtu dhe nuk do të luajë nga vendi". Pastaj u nis duke tërhequr kafshën, që rrëshqiste mbi katër këmbët dhe rënkonte.

Pikërisht atë çast u kthye fqinji im i dytë. Në lagje flitet se është kodosh dhe jeton me paratë që u merr femrave. Kur e pyesin se ç'zanat ka, përgjigjet se është "magazinier". Pothuaj të gjithë nuk duan ta shohin me sy. Por mua më flet shpesh dhe, nganjëherë, vjen tek unë, sepse kam durim për ta dëgjuar. Mua më duket se ato që thotë janë interesante. Përveç kësaj, nuk kam asnjë arsye përse të mos i flas. Ai quhet Rajmond Sintes, është mjaft i shkurtër, me shpatulla të gjera dhe hundë boksieri. Ai vishet gjithmonë tërë shije. Edhe ai më tha, duke e patur fjalën për Salamanon dhe qenin e tij: "Fatzinjtë!" pastaj më pyeti nëse më vinte ndot prej atyre të dyve dhe unë iu përgjigja se nuk më vinte aspak ndot.

Ngjitëm së bashku shkallën dhe, kur do ndaheshim, më tha:

- Kam sallam me gjak dhe verë në shtëpi. Dëshironi të hamë darkë së bashku?...

Mendova se kjo do të më shpëtonte nga gatimi, prandaj pranova pa e zgjatur. Edhe ai ka vetëm një dhomë me një kuzhinë pa dritare. Mbi shtratin e tij ka një engjëll prej allçije të bardhë me ngjyrë trëndafili, fotografi kampionësh dhe dy apo tre fotografi revistash me femra lakuriq. Dhoma është e qelbur dhe shtrati i parregulluar. Ai ndezi në fillim

llambën me vajguri, pastaj nxorri nga xhepi një fasho me një pastërti dyshuese dhe mbështolli dorën e djathtë. E pyeta ç'i kishte ngjarë. Më tha se ishte rrahur me një tip që kërkonte si e si të kruhej me të. - E dini, zoti Merso, - më tha, - nuk jam i keq, por kur ma jep majë kokës, nuk e përmbaj dot veten. Ai tipi më tha: "Zbrit nga tramvaji po ta mbajti". I thashë: "Ik, o çuno, dhe mos e merr rëmbyer." Ai më tha se nuk isha burrë. Atëherë zbrita dhe i thashë: "Dëgjo, mos e zgjat më, se kam për të të vdekur në dru." Ai m'u përgjigj: "Ti të më vdesësh mua?" Atëherë nuk durova dot dhe i dhashë një me të djathtën. Ai u rrëzua për tokë. Por si ishte për tokë më goditi me këmbë. Atëherë i dhashë një goditje me gju dhe dy flakërima të forta. Fytyra iu bë tërë gjak. E pyeta në donte më. Ai më tha: "Po."

Sintesi rregullonte fashon, ndërsa vazhdonte të fliste. Unë rrija ulur në shtrat. Ai më tha:

- Ja më thuaj, kam gjë faj? Ai u kruajt vetë. Ishte e vërtetë dhe unë i thashë se nuk kishte asnjë faj. Atëherë më tha se donte një mendje lidhur me atë çështje pikërisht nga unë, sepse unë isha burrë, e njihja jetën, se mund ta ndihmoja dhe pas kësaj do të bëheshim miq. Nuk fola dhe ai më pyeti përsëri në doja të isha mik me të. I thashë se për mua ishte njëlloj: ai mbeti i kënaqur nga kjo përgjigje. Nxorri sallamin me gjak, e skuqi në tigan, vuri dy gota, pjata, takëmet e ngrënies dhe dy shishe verë. Të gjitha këto veprime i kreu në heshtje. Pastaj zumë vend për të ngrënë. Ai filloi të më tregojë historinë

e tij. Në fillim sikur kishte një farë ngurrimi. Kam njohur një zonjë... ose për t'i rënë shkurt, ajo është dashnoria ime.

Burri me të cilin ishte rrahur qe vëllai i asaj gruaje. Ai më tha se e kishte mbajtur të dashurën në pëllëmbë të dorës. Nuk i thashë asnjë fjalë e, megjithatë, shtoi menjëherë se e dinte ç'flitej për të në lagje, por ai e kishte ndërgjegjen të kulluar dhe se punonte me të vërtetë si magazinier.

- Që të kthehemi tek historia ime, - më tha, - Vura re se aty kishte hile.

Dukej që ai i jepte të dashurës aq sa i duheshin për të jetuar. Ai i paguante vetë edhe dhomën dhe i jepte njëzet franga për të jetuar.

- Treqind franga për dhomën, gjashtëqind për ushqimin, herë pas here nga një palë çorape, të gjitha bënin njëmijë franga. Dhe zonja e rëndë nuk punonte. Por ajo qahej se i jepja pak, se nuk i mjaftonin paratë e mia. Megjithatë i thosha: "Përse nuk punon gjysmë dite? Do të më lehtësoje shumë nga tërë këto gjëra të vogla. Këtë muaj të bleva kostum, të kam dhënë njëzet franga në ditë, të kam paguar qiranë, kurse ti, ti pi kafe mbasdite me mikeshat e tua. Ti i qiras ato me kafe dhe sheqer. Unë, unë të jap para. Jam treguar shumë i mirë me ty, kurse t'i sillesh shumë keq me mua."" Ajo nuk punonte, ankohej gjithmonë dhe ndodhi kështu që vura re se aty luhej një hile."

Atëherë më tregoi se kishte gjetur në çantën e saj një biletë llotarie dhe se ajo nuk kishte mundur t'ia shpjegonte si e kishte blerë. Pak më vonë kishte

gjetur tek ajo një "dëftesë pagese" nga një dyqan pengjesh që provonte se ajo kishte lënë peng dy byzylykë. Deri atë çast, ai nuk dinte asgjë për ekzistencën e byzylykëve.

- E pashë mirë e bukur se ma kishte me hile. Atëherë, e lashë. Por në fillim, i dhashë një dru të mirë, që ta mbante mend. Dhe pastaj ia përplasa të gjitha në fytyrë. I thashë se, si kurvë e vërtetë, bënte një jetë, ku rrafsha mos u vrafsha. "I ke sytë në ballë apo jo? E sheh se të gjithë janë xhelozë për lumturinë që të fal. Tani nuk e di, por më vonë ke për ta kuptuar ç'jetë të mirë ke bërë me mua."

Ai e kishte rrahur aq keqas, sa e kishte bërë tërë gjak. Më përpara nuk e rrihte.

- E rrihja, por si të thuash, ëmbël. Ajo bërtiste pak. Kurse atë ditë e kisha me tërë mend. Por edhe aq sa e rraha, përsëri them se duhej t'i kisha dhënë një dru edhe më të mirë që ta mbante mend për tërë jetën.

Dhe pastaj më sqaroi se pikërisht për këtë kishte nevojë për një këshillë. Pushoi së foluri për të rregulluar fitilin e llambës që lëshonte tym.

Unë vazhdoja ta dëgjoja me vëmendje. Kisha pirë afër një litër verë dhe kisha shumë nxehtë te tempthat. Piva cigaret e Rajmondit, sepse i mbarova të miat. Në rrugë kalonin tramvajat e fundit duke mbartur me vete zhurmat e fashitura të rrethinës. Rajmondi vazhdoi të fliste. Ajo që e mërziste ishte se "ende ndjente diçka për pallimin e saj". Por ai donte ta ndëshkonte.Në fillim kishte menduar ta

çonte në hotel dhe të thërriste "policinë" për të bërë skandal dhe për ta futur emrin e saj në listë si prostitutë. Më pas u ishte drejtuar miqve të rrethit të vet. Por atyre nuk u pillte mendja për asgjë. Dhe si më vuri në dukje Rajmondi, është e kotë t'u kërkosh mendje njerëzve të rrethit tënd. Ua kishte thënë edhe atyre këtë gjë dhe atëherë ata i kishin propozuar që "t'i vinte një njollë që ta kishte për tërë jetën e jetës". Por ai nuk donte këtë. Do ta mendonte. Por më përpara donte të më pyeste për diçka. Por para se të më pyeste dëshironte të dinte se ç'mendoja për tërë atë histori. Iu përgjigja se nuk mendoja asgjë, por ishte interesante. Ai më pyeti nëse mendoja se kishte hile nga ana e saj dhe unë iu përgjigja se nga ana e saj kishte hile. A mendoja se duhej ndëshkuar dhe ç'do të bëja po të isha në vendin e tij. I thashë se nuk dihet asnjëherë si do të veprosh po të jesh në vendin e tjetrit, por e kuptoja se donte ta ndëshkonte. Piva përsëri pak verë. Ai ndezi një cigare dhe më zbuloi ç'kishte ndërmend të bënte. Ai donte t'i shkruante një letër "ku edhe t'i fuste disa thumba të mirë, por në të njëjtën kohë t'i thoshte edhe gjëra që ta bënin të ndjehej keq." Më pas, kur të kthehej, do të flinte me të dhe pikërisht në çastin kur do të mbaronte punë" do ta pështynte në fytyrë dhe do ta flakte përjashta. Mua m'u duk se me atë mënyrë e ndëshkonte ashtu si duhej. Por Rajmondi më tha se nuk e ndjente veten të aftë të shkruante letrën dhe kishte menduar për ta shkruar unë. Me që nuk e hapa gojën, më pyeti nëse mërzitesha sikur ta shkruaja

menjëherë dhe unë iu përgjigja që nuk mërzitesha. Atëherë u çua pasi piu një gotë verë. Shtyu pjatat dhe atë pak sallam të ftohtë, që kishim lënë pa ngrënë. Fshiu me kujdes mushamanë e tryezës. Mori nga një sirtar i tryezës së natës një fletë letër me katrore, një zarf të verdhë, një mbajtëse penash prej druri të kuq dhe një shishe katrore me bojë shkrimi ngjyrë manushaqe. Kur më tha emrin, pashë se ishte një arabe. E mbarova letrën. E shkrojta pak si kuturu, por u përpoqa të kënaqja Rajmondin, sepse nuk kisha asnjë arsye përse të mos e kënaqja. Pastaj ia lexova letrën me zë të lartë. Ai më dëgjoi duke pirë cigare dhe duke tundur kokën, pastaj më kërkoi t'ia rilexoja. Mbeti më se i kënaqur. Ai më tha:

- Isha i sigurtë se si e njeh ti jetën nuk e njeh askush. - Në fillim nuk e vura re se më fliste me ti. Më bëri përshtypje vetëm kur më tha: - Tani je shoku im i vërtetë. - E përsëriti këtë dy herë dhe unë thashë: "Po". Nuk më bëhej vonë të isha shok i tij, kurse ai dukej se kishte me të vërtetë nevojë për të patur një shok të vërtetë. Mbylli letrën në zarf dhe mbaruam verën që kishte mbetur. Pastaj qëndruam një çast pa folur duke pirë cigare. Përjashta ishte qetësuar çdo gjë, dëgjuam rrëshqitjen e një makine që po kalonte në rrugë. Thashë:

U bë vonë.

Edhe Rajmondi mendonte se ishte bërë vonë. Ai vuri në dukje se koha kalonte shpejt dhe, në një kuptim, kjo ishte e vërtetë. Kisha gjumë, por e kisha të vështirë të çohesha. Duhej të dukesha i dërrmuar

sepse Rajmondi më tha se nuk duhej lëshuar vetja. Në fillim nuk e kuptova. Atëherë më shpjegoi se kishte marrë vesh për vdekjen e mamasë, por ajo ishte diçka që do të ndodhte në mos sot nesër. Edhe vetë isha i po atij mendimi.

U çova, Rajmondi më shtrëngoi dorën shumë fort dhe më tha se burrat kuptohen gjithmonë mes tyre. Duke dalë nga apartamenti i tij, mbylla derën dhe qëndrova për një çast në errësirë, te sheshpushimi i shkallës. Shtëpia ishte e qetë dhe nga thellësitë e kafazit të shkallës ngjitej një afshi zymtë dhe i lagësht. Dëgjoja vetëm goditjet e gjakut tim që më gumëzhinte te veshët. Por në dhomën e plakut Salamano, qeni rënkoi mbytazi.

IV

Tërë javën punova mirë, Rajmondi erdhi dhe më tha se e kishte nisur letrën. Shkova dy herë në kinema me Emanuelin, që nuk kupton gjithmonë ç'ndodh në ekran. Atëherë duhej t'ia shpjegosh. Dje qe e shtunë dhe Maria erdhi, siç e kishim bërë me fjalë. Ajo më joshi menjëherë. Dukej shumë e bukur me fustanim me vija të kuqe dhe të bardha dhe me sandalet prej lëkure. Ai nxirrte në pah gjinjtë e saj të fortë. Maria ishte nxirë dhe kishte një fytyrë shumë të freskët. I hipëm autobusit dhe shkuam disa kilometra larg Algjerit, në një ranishte që shtrihej midis shkëmbinjve dhe të rrethuar me kallamishte nga ana e tokës. Dielli i orës katër nuk ishte shumë i nxehtë, por uji qe i vakët dhe ai rrokullisej tërë përtaci drejt bregut me valë të gjata dhe të ulëta. Maria më mësoi një lojë. Duhej, duke notuar, të pije ujë në majë të valëve, të mblidhje në gojë tërë shkumën, pastaj të shtriheshe në shpinë dhe ta hidhje drejt qiellit. Ajo formonte një dantellë shkumore që zhdukej në ajër ose më binte në fytyrë si një shi i ngrohtë. Por pas një farë kohe, goja më përvëlonte nga hidhësira e kripës. Atëherë Maria erdhi pranë meje dhe u ngjit në ujë pas trupit tim. Ajo ngjeshi gojën e saj pas gojës

mia dhe ne u sime. Gjuha e saj freskoi buzët e rrokullisëm për një çast mes dallgëve.

Maria më shihte me sytë që i vezullonin, kur u veshëm në ranishte. E putha. Duke filluar nga ai çast, nuk e hapëm më gojën. E mbajta shtrënguar pas vetes dhe nxituam të gjenim një autobus, për t'u kthyer sa më parë në shtëpinë time dhe për t'u hedhur në shtrat. Kisha lënë dritaren hapur dhe ishte mirë të ndjeje natën të rridhte mbi trupat tanë të zeshkët.

Maria qëndroi tek unë atë mëngjes dhe i thashë të hanim bashkë. Zbrita për të blerë mish. Duke u ngjitur, dëgjova një zë gruaje në dhomën e Rajmondit. Pak më pas, plaku Salamano shau rëndë qenin, dëgjuam një zhurmë këpucësh dhe kthetrash në shkallare dhe pastaj : "Maskara, cofëtinë", ata dolën në rrugë. I tregova Marisë historinë e plakut dhe ajo qeshi. Kishte veshur pizhamet e mia dhe kishte përveshur mëngët. Kur qeshi, më kapi përsëri dëshira për të. Një çast më pas, më pyeti nëse e doja. Iu përgjigja se kjo nuk kishte asnjë kuptim, por më dukej se nuk e doja. Ajo u trishtua. Por duke përgatitur mëngjesin dhe, kot fare, qeshi përsëri në mënyrë të tillë sa e putha. Pikërisht atëherë plasi te Rajmondi grindja.

Në fillim u dëgjua një zë i mprehtë gruaje dhe pastaj Rajmondi që thoshte:

Më mashtrove, më mashtrove. Do të të mësoj unë tani se ç'do të thotë të më mashtrosh mua. Disa zhurma të shurdhëta dhe gruaja ulëriu, kaq tmerrshëm, sa shkalla u mbush menjëherë me njerëz.

Edhe ne, Maria dhe unë, dolëm te shkalla. Gruaja vazhdonte të ulërinte, kurse Rajmondi nuk i rreshte goditjet. Maria më tha se ishte e tmerrshme, por unë nuk iu përgjigja. Ajo më kërkoi të shkoja në polici, por unë i thashë se nuk e doja policinë. Megjithatë erdhi një polic së bashku me qiraxhiun e katit të dytë që është hidraulik. Ai trokiti në derë dhe nga brenda nuk u dëgjua më as edhe një zhurmë. Polici trokiti më fort dhe pas pak gruaja qau dhe Rajmondi hapi derën. Ai kishte një cigare në gojë dhe një pamje të zbarët. Gruaja u vërsul drejt policit dhe i tha se Rajmondi e kishte goditur.

- Si e ke emrin? - tha polici.

Rajmondi u përgjigj.

-Hiqe cigaren nga goja kur flet me mua, - tha polici.

Rajmondi nguroi, më vështroi mua dhe thithi cigaren. Atë çast polici e goditi, me sa i hante krahu, në fytyrë. Cigarja fluturoi disa metra më tej. Rajmondit i lëshuan sytë xixa, për një çast nuk tha asgjë dhe pastaj pyeti me një zë të përvuajtur, nëse mund të ngrinte nga toka bishtin e cigares. Polici i tha se mund ta merrte dhe shtoi:

- Herën tjetër, do të dish të sillesh sepse tani e more vesh se një polic nuk është një palaço. Gjatë kësaj kohe vajza qante dhe përsëriste vazhdimisht:

- Ai më dendi në dru. Ai është kodosh. - Zoti polic, - pyeti atëherë Rajmondi, - a e lejon ligji t'i thuash një burri kodosh?

Por polici e urdhëroi "ta qepte gojën". Atëherë Rajmondi u kthye nga vajza dhe i tha:

- Prit, prit, vogëlushe, kemi për t'u takuar përsëri bashkë.

Polici i tha ta mbyllte grykën, se vajza duhej të largohej dhe se ai duhej të mos lëvizte nga dhoma duke pritur ta thërrisnin në komisariat. Ai shtoi që Rajmondit duhej t'i vinte turp që ishte i dehur deri në atë pikë sa dridhej i gjithi. Atë çast Rajmondi i shpjegoi:

- Nuk jam i dehur, zoti polic. Vetëm se jam këtu, para jush dhe nuk di përse dridhem.

Ai mbylli derën dhe të gjithë u shpërndanë. Maria dhe unë mbaruam së përgatitur mëngjesin. Por ajo nuk kishte uri, unë i hëngra pothuaj të gjitha. Ajo u largua në orën një të ditës dhe unë mora një sy gjumë.

Rreth orës tre trokitën në derë. Hyri Rajmondi. Unë qëndrova shtrirë. Ai u ul buzë shtratit. Qëndroi një çast pa folur dhe unë e pyeta si kishte ndodhur. Ai më tregoi se kishte bërë ç'kishte dashur, por ajo i kishte dhënë një shuplakë dhe atëherë ai e kishte rrahur. Pjesën tjetër, e kisha parë vetë. I thashë se tani ajo ishte ndëshkuar dhe ai duhej të qe i kënaqur. Këtë mendim kishte edhe vetë dhe vuri në dukje se çfarëdo të bënte polici, nuk do të ndryshonte asgjë në goditjet që kishte ngrënë ajo. Ai shtoi se i njihte mirë policët dhe dinte si të sillej me ta. Atëherë më pyeti se mos kisha pritur që ai t'i përgjigjej shuplakës së policit. Iu përgjigja se nuk prisja gjë

prej gjëje dhe se veç kësaj, nuk i doja policët. Rajmondi u duk shumë i kënaqur. Më pyeti në doja të dilja me të. U çova dhe fillova të krihem. Ai më tha se i shërbeja si dëshmitar. Nuk e çaja aspak kokën, nuk e dija ç'duhej të thosha. Sipas Rajmondit, mjaftonte të deklaroja se vajza e mashtronte. Pranova t'i shërbej si dëshmitar.

Dolëm dhe Rajmondi më dha një gotë konjak. Pastaj donte të bënim një lojë bilardo dhe unë humba, pikërisht atëherë kur e kisha lojën në dorë. Më pas donte të shkonim në bordel, por i thashë jo sepse nuk më pëlqente. Atëherë u kthyem ngadalë dhe ai më tha sa i kënaqur ndjehej që e kishte ndëshkuar të dashurën e tij. Ai po tregohej shumë i sjellshëm me mua dhe mendova se e kishim kaluar mirë mbrëmjen.

Nga larg, pashë te pragu i derës plakun Salamano që dukej i shqetësuar. Kur u afruam, pashë se nuk e kishte qenin. Ai vështronte nga të katër anët, rrotullohej rreth vetes, përpiqej të çante mespërmes errësirën e korridorit, murmuriste fjalë pa lidhje dhe fillonte dhe kontrollonte rrugën me sytë e tij të vegjël e të skuqur. Kur Rajmondi e pyeti ç'kishte, nuk u përgjigj menjëherë. Unë e dëgjova të murmuriste mbytazi: "Maskarai, cofetina" dhe vazhdoi të vërtitet përreth. E pyeta ku ishte qeni. M'u përgjigj përnjëherësh se kishte ikur. Dhe pastaj, atypëraty, u zbraz i tëri:

Si gjithmonë e çova te Fusha e Stërvitjes. Rreth barakave të panairit kishte shumë njerëz.

Alber Kamy- I huaji

Ndalova për të parë "Mbretin e arratisjes". Kur doja të largohesha, ai nuk ishte më atje. Sigurisht, po bëhet kohë që dua t'i blej një qafore më të ngushtë. Por nuk ma kishte prerë kurrë mendja se ajo cofetinë do të largohej në atë mënyrë.

Atëherë Rajmondi i shpjegoi se qeni mund të ishte ngatërruar dhe se do të kthehej. Ai i përmendi tërë ato shembuj qensh që kishin bërë me dhjetra kilometra për të gjetur të zotin. Por, pavarësisht nga ato tregime, plaku u duk edhe më i shqetësuar.

Kanë për të ma marrë. E kuptoni apo jo? Vetëm në e ka gjetur njeri dhe e ka çuar në shtëpi. Por kjo është e pamundur, ai u shtie krrupën të gjithëve me zgjeben e tij. Me siguri kanë për ta kapur policët.

Atëherë i thashë të shkonte te vendi ku mbaheshin qentë e braktisur, veçse duhej të paguante një gjobë. Ai më pyeti në ishte e lartë gjoba. Nuk e dija. Atëherë ai u nxeh:

- Të jap para për atë cofëtinë. Ah, nuk ka ngodhur ende! - Dhe filloi të këputë të shara.

Rajmondi qeshi dhe hyri në shtëpi. E ndoqa pas dhe u ndamë te sheshpushimi i katit. S'kaloi shumë dhe dëgjova hapat e plakut dhe trokitjen e tij në derën time. Kur e hapa, ai qëndroi një çast te pragu dhe më tha:

- Më falni, më falni.

E ftova të hynte brenda, por nuk donte. Vështronte majën e këpucëve dhe duart e tij tërë kore i dridheshin. Ai më pyeti, pa e ngritur kokën:

- Si thoni, zoti Merso, nuk kanë për të ma marrë. Do të ma kthejnë. Ndryshe si do t'ia bëj pa të?

I thashë se qentë mbaheshin tre ditë, që të zotët të kishin kohë t'i kërkonin, por pas këtij afati bënin me qentë ç'të donin. Më vështroi në heshtje. Pastaj më tha:

Natën e mirë.

Mbylli derën e tij dhe e dëgjova të ecejakte. Shtrati i tij kërciti. Dhe nga zhurma e çuditshme dhe e shkurtër që përshkoi murin ndarës, kuptova se po qante. As vetë nuk e di përse më shkoi mendja te mamaja. Por nesër më duhej të ngrihesha herët. Nuk kisha uri dhe u shtriva pa ngrënë darkë.

V

Rajmondi më telefonoi në zyrë. Ai më tha se njëri nga miqtë e tij (të cilit i kishte folur për mua) më ftonte ta kalonim ditën e dielë te shtëpiza e tij, pranë Alegjerit. Iu përgjigja se do të shkoja me shumë dëshirë, por i kisha premtuar një mikeshës sime ta kaloja ditën me të. Rajmondi ma ktheu menjëherë se edhe ajo ishte e ftuar. Gruaja e mikut të tij do të qe shumë e kënaqur duke mos qenë vetëm mes një tufe burrash.

Doja ta mbyllja menjëherë telefonin sepse e dija që pronarit nuk i pëlqente kur na telefonin të njohurit. Por Rajmondi më tha të mos e mbyllja, se ftesën mund të ma bënte edhe në mbrëmje, por tani donte të më njoftonte për diçka. Atë e kishte ndjekur gjatë tërë ditës një grup arabësh, midis të cilëve ndodhej vëllai i dashnores së tij të vjetër.

- Po e pe pranë shtëpisë sonte kur të kthehesh nga puna, më lajmëro.

I thashë se këtë do ta bëja edhe pa ma thënë ai. Pak më pas më thirri pronari dhe unë u mërzita sepse mendova se do të më thoshte të bisedoja më pak në telefon dhe të punoja më shumë. Por nuk ishte aspak kështu. Ai më tha se donte të më fliste për një

projekt që e kishte ende të turbullt. Ai vetëm dëshironte të dinte mendimin tim për këtë çështje. Ai kishte ndërmend të ngrinte një zyrë në Paris që do t'i trajtonte punët në vend dhe drejtpërsëdrejti me shoqëritë e mëdha dhe donte të dinte nëse isha gati ta merrja përsipër atë punë. Ajo do të më krijonte mundësinë të jetoja në Paris, si dhe të udhëtoja një pjesë të vitit.

- Jeni i ri dhe më duket se është një jetë që duhet t'ju pëlqejë.

I thashë po, por thellë-thellë ishte diçka që nuk më bënte shumë përshtypje. Ai më pyeti atëherë nëse nuk isha i interesuar për një ndryshim të jetës. Iu përgjigja se sado të përpiqemi jetën nuk e ndryshon dot. Mua më pëlqente jeta ime këtu, në Algjer. Ai rrudhi fytyrën, më tha se përgjigjet e mia ishin gjithmonë të tërthorta, se nuk kisha asnjë ambicie dhe se mungesa e saj ishte shkatërruese për një njeri që merrej me tregti. Atëherë u ktheva në zyrë dhe u ula të punoj. Do të më kishte pëlqyer të mos e mërzisja pronarin, por nuk shihja asnjë arsye për të ndryshuar jetën time. Po ta mendoje mirë e mirë, nuk isha fatkeq. Kur isha student, kisha shumë ambicje. Por kur m'u desh të braktisja studimet, e kuptova shumë shpejt se e gjitha ajo nuk kishte asnjë

rëndësi.

Në mbrëmje erdhi Maria dhe më pyeti nëse kisha ndërmend të martohesha me të. I thashë se për mua ishte njëlloj dhe se, po të donte ajo, mund edhe të martoheshim. Atëherë donte të dinte nëse e doja.

Iu përgjigja si i kisha thënë edhe një herë më përpara, se kjo nuk kishte asnjë kuptim, por që pa dyshim nuk e doja.
Po atëherë përse martoheni me mua? – tha ajo.
I shpjegova se kjo nuk kishte asnjë rëndësi dhe nëse ajo dëshironte, mund të martoheshim. Veç të tjerash ishte ajo që e kërkonte dhe unë mjaftohesha duke thënë po. Atëherë Maria vuri në dukje se martesa ishte një çështje serioze. Iu përgjigja: "Jo." Ajo qëndroi për një çast e heshtur, duke më vështruar folur. Ajo vetëm donte të dinte nëse do të pranoja të njëjtin propozim të bërë nga një femër tjetër, me të cilën do të isha lidhur në të njëjtën mënyrë. Thashë: "Natyrisht." Atëherë ajo pyeti veten nëse më donte, por unë nuk kisha si ta dija këtë gjë. Pas një çasti tjetër heshtjeje, ajo murmuriti se isha njeri i çuditshëm, se ajo më donte pa dyshim për këtë, por që ndoshta një ditë, për të njëjtat arsye që më donte, do të ndjente për mua neveri. Me që po heshtja, duke mos patur ç'të shtoja, më kapi për krahu duke buzëqeshur dhe më tha se donte të martohej me mua. Iu përgjigja se do të martoheshin kur të donte ajo. Atëherë i fola për propozimin e pronarit dhe Maria më tha se do të donte të njihte Parisin. I thashë se kisha jetuar aty një farë kohë dhe ajo më pyeti si ishte Parisi. I thashë:

- I pistë. Aty ka pëllumba dhe oborre të errët. Njerëzit e kanë lëkurën të bardhë.

Pastaj ecëm përmes qytetit, nëpër rrugët e tij

të gjera. Femrat ishin të bukura dhe pyeta Marine nëse e vinte re sa të bukura ishin. Ajo më tha po dhe se më kuptonte fare mirë. Për një çast nuk e hapëm më gojën. Megjithatë doja që ajo të rrinte me mua, prandaj i thashë se mund të darkonim së bashku te Çeleste. Ajo kishte shumë dëshirë të darkonte me mua, por kishte shumë punë për të bërë. Ishim pranë shtëpisë sime dhe unë i thashë mirupafshim. Ajo më vështroi në sy:

- Nuk do të dish ç'kam për të bërë?

Doja shumë, por me që nuk mendova për këtë, u zemërua me mua. Atëherë, duke më parë të shushatur, qeshi përsëri dhe u hodh drejt meje me tërë trupin për të më zgjatur buzët e saj.

Darkën e hëngra te Çeleste. Kisha filluar të haja kur hyri një grua e shkurtër, e çuditshme, që më pyeti nëse mund të ulej në tryezën time. Natyrisht, që mund të ulej. Lëvizjet e saj ishin të prera, kurse sytë i shkëlqenin në një fytyrë të vogël, të rrumbullakët si një mollë. Hoqi jelekun, u ul dhe i hodhi listës së gjellëve një vështrim të ethshëm. I thirri Çelestes dhe porositi menjëherë të gjitha gjellët me një zë sa të saktë aq dhe të ngutur. Duke pritur sallatërat, hapi çantën, nxorri një copë letër katrore dhe një laps, bëri që më parë llogarinë, pastaj nxorri nga një xhep i vogël, duke futur edhe bakshishin, shumën e saktë që e vuri para vetes. Atë çast i sollën sallatën, që e përlau me shpejtësi. Duke pritur t'i sillnin gjellën, nxorri përsëri nga çanta një laps në ngjyrë të kaltër dhe një revistë që kishte programet

radiofonike të javës. Ajo i nënvizoi me shumë kujdes një nga një pothuaj të gjitha emisionet. Me që revista kishte tërë ato faqe, ajo e vazhdoi këtë punë me përpikmërinë më të madhe gjatë tërë darkës. Unë kisha mbaruar, kur ajo vazhdonte të nënvizonte ende me të njëjtin zell. Pastaj u çua, veshi jelekun me të njëjtat lëvizje të sakta prej automati dhe u largua. Me që nuk kisha ç'të bëja dola edhe unë dhe e ndoqa për një çast. Ajo ecte me një shpejtësi dhe me një siguri të pabesueshme anës trotuarit, duke ndjekur rrugën e saj pa u shmangur dhe pa u kthyer. E humba nga sytë dhe u ktheva nga rruga. Mendova se ajo ishte një femër e habitshme, por e harrova shumë shpejt.

Te pragu i derës sime, gjeta plakun Salamano. E detyrova të hynte brenda dhe ai më tha se qeni ishte zhdukur, sepse nuk ishte te vendi ku mbaheshin qentë e humbur. Ata që punonin atje i kishin thënë se ndoshta qenin e kishte shtypur ndonjë makinë. Atëherë ai kishte pyetur nëse mund ta dinin në komisariatet e policisë, e kishin shtypur apo jo qenin e tij. I ishin përgjigjur se ngjarje të tilla të parëndësishme ndodhnin çdo ditë dhe askush nuk e çante kokën për to. I thashë plakut Salamano se mund të merrte qen tjetër, por ai m'u përgjigj tërë urtësi se ishte mësuar me atë qen.

Unë isha ulur këmbëkryq mbi shtratin tim, kurse Salamanoja ishte ulur në një karrige përpara tryezës. Ai i mbante duart mbi gjunjë dhe nuk e kishte hequr kapelen e vjetër prej plisi. Ai i përtypte në gojën e tij pa dhëmbë copëzat e fjalive që i lëshonte

nën mustaqet e zverdhura. Po më mërziste, por nuk kisha as punë dhe as gjumë. Për të mos mbetur gojëkyçur, e pyeta për qenin e tij. Ai më tha se e kishte marrë pas vdekjes së të shoqes. Ai ishte martuar shumë vonë. Kur ishte i ri, kishte patur dëshirë të luante në teatër: në regjiment luante nëpër skeçe nga jeta ushtarake. Në fund kishte filluar punë në hekurudhë dhe nuk i vinte aspak keq për këtë, sepse tani kishte një pension të vogël. Ai nuk kishte qenë i lumtur me gruan, por në tërësi ishte mësur me të. Kur ajo vdiq, ishte ndjerë shumë i vetmuar. Atëherë kishte kërkuar një qen te një shok i punishtes dhe kishte marrë qenin më të vogël. Në fillim e kishte ushqyer me biberon, por meqënëse një qen jeton më pak se njeriu, ata u plakën të dy në të njëjtën kohë. - Ai kishte një karakter të keq, - më tha Salamano. - Herë pas here të tregonte dhëmbët. Megjithatë ishte një qen i mirë.

I thashë se ishte nga një racë e mirë dhe Salamano u shkri nga kënaqësia.

- Po ju nuk e keni njohur para se ta zinte sëmundja. Gjënë më të bukur kishte qimet.

Salamanoja, që kur iu sëmur qeni, e lyente me pomadë çdo mbërmje dhe çdo mëngjes. Por, sipas tij, sëmundja e vërtetë e qenit, ishte plakja dhe plakja nuk shërohet.

Atë çast gogësita dhe plaku më tha se do të largohej. I thashë se mund të qëndronte dhe se isha i mërzitur për atë që i kishte ndodhur qenit të tij: ai më falenderoi. Ai më tha se mamaja ime e donte

shumë qenin e tij. Duke folur për të, ai e quante "nëna juaj e shkretë". Ai e merrte me mend sa fatkeq ndjehesha nga vdekja e mamasë, por unë nuk iu përgjigja. Atëherë më tha, shumë shpejt dhe me një pamje të angështuar se e dinte që në lagje më kishin gjykuar keq sepse kisha çuar në azil nënën, por ai më njihte dhe e dinte sa shumë e doja mamanë. Iu përgjigja, ende nuk e di përse, se nuk kisha dëgjuar deri atë çast të më gjykonin keq për atë veprim, azili m'u duk diçka e natyrshme, për deri sa nuk kisha aq para sa të paguaja ndonjë grua për të qëndruar me mamanë.

- Veç kësaj, shtova, - po bëhej tërë ajo kohë që ajo nuk kishte ç'të më thoshte më dhe se mërzitej vetëm.

- Po, - më tha Salamano, - në azil, të paktën, ke shokë. - Pastaj më kërkoi të falur dhe u çua për të ikur. Donte të flinte. Jeta e tij kishte ndryshuar tani dhe ai nuk e dinte ç'të bënte. Për herë të parë që kur e kisha njohur, më zgjati si fshehurazi dorën dhe unë ndjeva leskërat e lëkurës së tij. Më buzëqeshi lehtë dhe para se të dilte më tha:

Shpresoj se sonte natën nuk do të lehin qentë. Më duket gjithmonë sikur është qeni im...

VI

Të dielën u zgjova me zor dhe Marisë iu desh të më bënte zë dhe të më shkundëte nga supet. Nuk hëngrëm mëngjes sepse donim të laheshim herët. U ndjeva krejt bosh dhe më dhimbte pak koka. Cigarja kishte një shije të hidhur. Maria u tall me mua, duke thënë se kisha "një fytyrë të pikëlluar si të shkoja në varrim". Ajo kishte veshur një fustan prej pëlhure të bardhë dhe kishte lëshuar flokët. I thashë se ishte e bukur, ajo qeshi nga kënaqësia.

Duke zbritur, trokitëm te dera e Rajmondit. Na u përgjigj se po zbriste. Në rrugë, për shkak të lodhjes sime si dhe nga që nuk kishim hapur grilat në mëngjes, dita, tashmë tërë diell, më goditi si një flakërimë shuplake. Maria kërcente nga gëzimi dhe nuk pushonte së thënë se moti ishte i bukur. U ndjeva më mirë dhe pashë se kisha uri. Ia thashë Marisë e cila më tregoi çantën prej mushmaje, ku kishte futur rrobat tona të banjos dhe një peshqir. Nuk pritëm sepse dëgjuam Rajmondin të mbyllte derën. Kishte veshur një palë pantallona të kaltra dhe një këmishë të bardhë me mëngë të shkurtra. Por kishte vënë një kapelë kashte, që e bëri Marinë të qeshte dhe parakrahët e tij ishin shumë të bardhë nën qimet e

zeza. Ndjeva një farë krupe nga kjo. Ai fishkëllente duke zbritur shkallën dhe dukej shumë i kënaqur.

Ai më tha:

-Përshëndetje, plako, - dhe e thirri Marinë

"zonjushë".

Një natë më parë shkuam në komisariat dhe dëshmova se vajza e kishte "mashtruar" Rajmondin. Ata vetëm e paralajmëruan Rajmondin. Pohimin tim nuk e besuan. Para derës, folëm me Rajmondin, pastaj vendosëm të merrnim autobusin. Plazhi nuk është shumë larg, por donim të shkonim sa më shpejt. Rajmondi mendonte se miku i tij do të kënaqej kur të na shihte të mbërrinim herët. Po bëheshim gati të niseshin kur Rajmondi, më goditi me bërryl dhe ma bëri me shenjë të vështroja përballë. Pashë një grup arabësh të mbështetur te vitrina e dyqanit të cigareve. Ata na vështronin në heshtje, por në mënyrën e tyre, as më shumë e as më pak si të ishim gurë apo drurë të tharë. Rajmondi më tha se i dyti nga e majta ishte ai tipi me të cilin kishte të bënte. Ai dukej i shqetësuar. Megjithatë shtoi se tashmë ajo ishte një histori e mbyllur. Maria nuk kuptonte ç'flisnim dhe pyeti se ç'kishim ashtu. I thashë se arabët që kishim përballë kishin inat me Rajmondin. Ajo donte të niseshim menjëherë. Rajmondi nxorri gjoksin para dhe qeshi duke thënë se duhej të nxitonim.

Ecëm drejt stacionit të autobuzit që ishte pak më tej dhe Rajmondi më tha se arabët nuk po na ndiqnin. Ktheva kokën. Ata nuk kishin luajtur nga vendi dhe vështronin me mospërfillje andej nga ishim

larguar. Hipëm në autobus. Rajmondi, që dukej tërësisht i lehtësuar, nuk pushonte së shakatuari për Marinë. E ndjeva se i pëlqente, por ajo nuk i përgjigjej. Vetëm e vështronte herë pas here duke qeshur.

Zbritën në rrethinën e Algjerit. Plazhi nuk ishte larg nga stacioni i autobusit. Por duhej kapërcyer një pllajë e vogël që ngrihej mbi det dhe që të çonte drejt plazhit. Ai ishte i mbuluar me gurë të verdhemë dhe me asfodele --lulet e të cilave dukeshin krejt të bardha në sfondin e kaltërsisë së dendur të qiellit. Maria po zbavitej duke goditur me çantën prej mushamaje petalet, që përhapeshin në të katër anët. Ecëm mes një rreshti vilash të vogla me gardhe të gjelbëra apo të bardha, disa të zhytura së bashku me verandat nën marinat,të tjerat të zhveshura në mes të gurëve. Para se të arrinim buzë pllajës, pamë detin të fashitur dhe pak më tej një kep të madh, që dremiste në ujin e kthjellët. Një zhurmë e lehtë motori u ngrit lart në ajrin e qetë. Një barkë e vogël peshkimi çante, larg, shumë larg, detin vezullues. Maria këputi disa shpatore që kishin çelur mes shkëmbinjve. Nga shpati që zbriste drejt bregut pamë se në det po laheshin disa njerëz.

Miku i Rajmondit banonte në një shtëpizë prej druri në skaj të plazhit. Shtëpiza e vogël ishte mbështetur pas shkëmbinjëve dhe shtyllat që mbanin pjesën e përparme ishin të zhytura në ujë. Rajmoni na njohu me mikun e tij që quhej Mason. Ai ishte trupmadh, me shpatulla të gjera, kurse e shoqja, ishte

një grua e shkurtër rrumbullake dhe e sjellshme, që fliste me një theks parizian. Ai na tha të rrinim si të kishim qejf dhe se kishte skuqur peshqit që j kishte kapur po atë mëngjes. I thashë se shtëpia e tij më dukej shumë e bukur. Ai më tha se vinte aty për të kaluar të shtunën, të dielën dhe gjithë ditët e pushimit. "Kuptohet, me gruan", shtoi. Atë çast e shoqja po qeshte me Marinë. Ndoshta për herë të parë mendova me të vërtetë se do të martohesha.

Masoni donte të shkonim të laheshim, por Rajmondi dhe e shoqja nuk donin të vinin.

Zbritëm të tre dhe Maria u hodh menjëherë në ujë. Masoni dhe unë, nuk u ngutëm. Ai fliste ngadalë dhe vura re se e kishte zakon të plotësonte gjithçka që shtronte me një "madje do të shtoja", edhe kur, në fund të fundit, nuk i shtonte asgjë kuptimit të fjalisë së tij. Lidhur me Marinë, më tha: "Ajo është e mrekullueshme, madje do të shtoja, s'ka ku të vejë më e bukur." Pastaj nuk ia vura më veshin zakonit të tij, sepse po ndjeja që dielli po më bënte mirë. Rëra filloi të digjte nën këmbët tona. E vonova edhe pak dëshirën për t'u futur në ujë, por nuk durova më dhe i thashë Masonit: "Futemi?". U zhyta. Ai u fut në ujë ngadalë dhe u zhyt kur nuk i çiknin më këmbët. Ai notonte pashë dhe shumë keq, sa e lashë pas për t'u bashkuar me Marinë. Uji ishte i ftohtë dhe unë isha i kënaqur që notoja. Unë dhe Maria u larguam shumë me not dhe të dy e ndjenim sa mirë kuptoheshim në lëvizjet tona dhe sa të kënaqur ishim që ndodheshim së bashku.

Notuam larg, pastaj u shtrimë në shpinë dhe në fytyrën time të kthyer drejt qiellit, dielli thau pikat fundit që më rridhnin në gojë. Pamë Masonin që doli në breg për t'u shtrirë në diell. Nga larg, dukej shumë i madh. Maria kishte dëshirë të notonim së bashku. Dola prapa saj për ta kapur për beli dhe ajo çante para me forcën e krahëve, ndërsa unë e ndihmoja duke përplasur këmbët. Atë mëngjes çamë gjatë ujin dhe dëgjuam llokoçitjen e tij deri kur u ndjeva i lodhur. Atëherë lëshova Marien dhe u ktheva duke notuar me pashë të mëdha dhe duke u mbushur me frymë thellë dhe rregullisht. Në plazh u shtriva barkas pranë Masonit dhe vura fytyrën në rërë. I thashë Masonit se "ishte mirë" dhe ai ishte i po atij mendimi. Maria erdhi pak më pas. U ktheva ta vështroja si vinte drejt meje. Ajo shndriste e gjitha nga uji i kripur dhe flokët i kishte hedhur prapa. Ajo u shtri ngjitur pas meje dhe nxehtësia e trupit të saj dhe ajo e diellit, më vunë në gjumë.

Maria më tundi dhe më tha se Masoni kishte shkuar në shtëpi dhe se do të hanim drekë. U çova menjëherë, sepse kisha uri, por Maria më tha se nuk e kisha puthur që në mëngjes. Ishte e vërtetë, madje edhe vetë ma kishte ënda ta puthja.

- Futemi në ujë, - më tha ajo.

Vrapuam dhe u shtrimë në dallgët e para të vogla. Maria u ngjit pas meje. Ndjeva këmbët e saj të mbërtheheshin rreth këmbëve të mia dhe e dëshirova pambarimisht.

Kur u kthyem në breg, Masoni na bëri zë nga

shkalla e shtëpizës së tij. I thashë se më griu uria dhe ai i tha menjëherë së shoqes se i pëlqeja. Buka ishte e mirë, unë e përlava pjesën time të peshkut. Më pas na shtruan mish dhe patate të fërguara. Të gjithë hanim pa folur. Masoni pinte vazhdimisht verë dhe ma mbushte edhe mua pa pushim gotën. Pas kafes e ndjeva kokën pak të rëndë dhe piva tërë ato cigare. Masoni, Rajmondi dhe unë e bëmë me fjalë ta kalonim bashkë muajin gusht në plazh, me shpenzime të përbashkëta. Maria na tha papritmas: - E' dini sa është ora? Njëmbëdhjetë e

gjysëm.

U habitëm të gjithë, por Masoni tha se kishte ngrënë shumë herët dhe ishte e natyrshme që ora e drekës, të jetë ora kur të merr uria. Nuk e di përse Maria qeshi me këto fjalë. M'u duk se kishte pirë pak si tepër. Atëherë Masoni më pyeti nëse kisha dëshirë të shetisja me të në plazh.

- Gruaja ime shtrihet gjithmonë për të marrë një sy gjumë pas drekës. Për vete, nuk më pëlqen aspak të shtrihem për të fjetur në këtë orë. Më duhet të ec. I them gjithmonë se ecja të bën mirë për shëndetin. Por, në fund të fundit, është e drejta e saj të bëjë atë që i pëlqen.

Maria tha se do të rrinte me zonjën Mason për ta ndihmuar të lante enët. Pariziania e vogël tha se për këtë duheshin nxjerrë jashtë burrat. Dolëm të tre. Dielli binte pothuaj pingul mbi rërë dhe shkëlqimi i tij mbi det ishte i padurueshëm. Në plazh nuk kishte mbetur më këmbë njeriu. Në vilat që

ngriheshin përreth pllajës duke sunduar detin, dëgjoheshin zhurmat e pjatave dhe takëmeve të ngrënies. Nxehtësia që lëshonin gurët që mbulonin tokën të merrte frymën. Në fillim Rajmondi dhe Masoni folën për gjëra dhe për njerëz që nuk i njihja. Aty mora vesh se njiheshin prej shumë kohësh dhe se dikur kishin jetuar së bashku. Ecëm drejt ujit dhe vazhduam përgjatë detit. Nganjëherë, ndonjë dallgë më e gjatë se të tjerat vinte dhe na lagte këpucët prej pëlhure të trashë. Nuk mendoja për asgjë sepse isha gjysëm i përgjumur nga dielli që më binte në majë

të kokës.

Atë çast, Rajmondi i tha Masonit diçka që nuk e dëgjova mirë. Por në të njëjtën kohë syri më kapi, në fund fare të plazhit dhe shumë larg nesh, dy arabë me rroba të kaltra pune që po vinin në drejtimin tonë. Vështrova Rajmondin dhe ai më tha:

- Është ai.

Vazhduam të ecim. Masoni pyeti se si kishin mundur të na ndiqnin deri aty. Unë mendova se ata na kishin parë të hipnim në autobus me një çantë plazhi, por nuk thashë asnjë fjalë.

Arabët përparonin ngadalë dhe tashmë ishin afruar më shumë. Ne nuk e ndryshuam qëndrimin tonë, por Rajmondi tha:

- Po të përleshemi, ti, Mason, merru me të dytin. Me tipin tim po merrem vetë. Ti, Merso, po erdhi ndonjë tjetër, ai është për ty."

Unë thashë: "Po" dhe Masoni futi duart në xhepa. Rëra e mbingrohur më dukej tani e kuqe. Ne

bënim para drejt arabëve me një hap të barabartë Largësia midis nesh po zvogëlohej pak nga pak. Kur qemë vetëm disa hapa larg njëri-tjetrit, arabët u ndalën. Masoni dhe unë ngadalësuam hapat tona. Rajmondi eci drejt tipit të tij. Nuk e dëgjova mirë çfarë i tha, por tjetri u përkul sikur do t'i binte me kokë. Atëherë Rajmondi e goditi dhe thirri menjëherë Masonin. Masoni shkoi tek ai që i kishin caktuar dhe e goditi me sa forcë që kishte. Arabi ra në ujë, me fytyrën pas rërës dhe qëndroi disa sekonda kështu, rreth kokës së tij ngriheshin dhe çaheshin flluska. Gjatë kësaj kohe edhe Rajmondi goditi dhe tjetri e kishte fytyrën tërë gjak. Rajmondi u kthye nga unë dhe tha:

- Ke për ta parë ç'do t'i punoj.

Unë i bërtita:

- Kujdes se ka thika!

Por qe vonë, Rajmondi e kishte krahun të plagosur dhe gojën të çarë. Masoni bëri një të hovur para. Por arabi tjetër u çua dhe u ngul prapa atij që ishte i armatosur. Ne nuk guxuam të lëvizim. Ata u tërhoqën ngadalë prapa, pa na i ndarë sytë dhe duke na mbajtur larg me thikë. Kur e panë se ishin mjaft larg, ua therën këmbëve shumë shpejt, ndërsa ne qëndronim të mbërthyer nën diell dhe Rajmondi mbante shtrënguar krahun që pikonte gjak.

Masoni tha menjëherë se aty ishte një doktor që i kalonte të dielat në pllajë. Rajmondi tha të shkonim pa u vonuar. Sa herë që fliste, gjaku i plagës bënte flluska në gojën e tij. E mbajtëm dhe u kthyem

në shtëpizë me shpejtësinë më të madhe. Atje, Rajmondi tha se plagët ishin sipërfaqësore dhe se mund të shkonte te doktori. Ai u nis me Masonin, kurse unë qëndrova me gratë për t'iu shpjeguar ç'kishte ndodhur. Zonja Mason qante dhe Maria ishte shumë e zbehtë. Unë u mërzita duke u shpjeguar. Pastaj heshta dhe piva një cigare duke vështruar detin.

Rajmondi u kthye me Masonin rreth orës një e gjysëm. Ai e kishte krahun të fashuar dhe në cep të buzës kishte vënë leukoplast. Doktori i kishte thënë se nuk kishte asgjë, por Rajmondi kishte një pamje shumë të zymtë. Masoni u përpoq ta bënte të qeshte. Por ai e kishte qepur gojën. Kur tha se do zbriste në plazh, e pyeta ku do të shkonte. Masoni dhe unë thamë se do shkonim për ta shoqëruar. Atëherë u tërbua nga inati dhe na shau. Masoni tha se duhej ta linim të qetë. Megjithatë unë e ndoqa pas.

Ecëm gjatë në plazh. Dielli përvëlonte pamëshirshëm. Ai copëtohej në rërë dhe mbi sipërfaqen e detit. Mua m'u duk se Rajmondi e 'dinte ku po shkonte, por ndoshta edhe gaboja. Arritëm, në fund të plazhit, në një burim që rridhte në rërë, prapa një shkëmbi të madh. Atje, gjetëm dy arabët tanë. Ata ishin shtrirë në kominoshet e tyre tërë yndyrë. Dukeshin krejt të qetë dhe pothuaj të kënaqur. Vajtja jonë nuk ndryshoi asgjë. Ai që kishte goditur Rajmondin e vështroi pa folur. Tjetri i frynte një kallami dhe përsëriste pa rreshtur, duke na vështruar me cep të syrit, tre notat që lëshonte vegla

e tij. Përreth kishte vetëm diell dhe qetësi, dëgjohej vetëm gurgullima e burimit dhe tre notat. Rajmondi futi dorën në xhepin ku mbante revolverin, por tjetri nuk luajti nga vendi dhe të dy vazhduan të vështroheshin në sy. Unë pashë se ai që i binte fyellit i kishte duart dhe këmbët shumë të hapura. Rajmondi më pyeti, pa ia ndarë sytë kundërshtarit të tij: "T'ia kërcas?" Unë mendova se po t'i thosha jo do të merrte flakë dhe me siguri do të qëllonte. Vetëm i thashë: "Ai nuk të ka folur ende. Kot të qëllosh në këtë mënyrë." Mes heshtjes dhe të nxehtit u dëgjua përsëri zhurma e lehtë e ujit dhe e fyellit. Pastaj Rajmondi tha: "Atëherë do të shkoj ta fyej dhe kur të më përgjigjet, do t'ia zbraz." Iu përgjigja: "Mirë, por po nuk nxorri thikën, nuk mund të qëllosh." Rajmondi filloi të nevrikosej. Arabi tjetër vazhdonte t'i binte fyellit dhe të dy vëzhgonin çdo lëvizje të Rajmondit. - Jo, i thashë Rajmondit. - Po të duash kapu me të si burri me burrin dhe ma jep mua revolverin. Po ndërhyri tjetri, ose po nxorri thikën, do ta qëlloj.

-Kur Rajmondi më dha revolverin, dielli shkëlqeu mbi çelikun e tij. Ne nuk lëvizëm përsëri nga vendi, sikur çdo gjë ishte mbyllur rreth nesh. Ne dhe arabët vështroheshim drejt e në sy. Çdo gjë ngriu - dhe deti, dhe rëra, dhe dielli, dhe fyelli dhe uji. Atë çast mendova: duhet apo nuk duhet të qëlloj. Por befas, arabët u tërhoqën dhe rrëshqitën prapa shkëmbit. Atëherë Rajmondi dhe unë u kthyem nga kishim ardhur. Ai dukej më mirë dhe tha se ndoshta

ishte koha për t'i hipur autobusit të kthimit. E shoqërova deri te shtëpiza dhe, ndërsa ai po ngjitëte shkallën prej druri, qëndrova para shkallares së parë, me kokën që më ushtonte nga dielli, i ligështuar para përpjekjes që duhej bërë për të ngjitur katin prej druri dhe për t'ia nisur përsëri bisedës me gratë. Por dielli digjte aq shumë, sa ishte e vështirë të rrije pa lëvizur nën shiun e zjarrtë e verbues që binte nga qielli. A nuk ishte njëlloj, si të rrije aty apo të niseshe? U ktheva nga plazhi dhe fillova të ec.

Kudo ishte i njëjti shpërthim i kuq. Në rërë, deti gulçonte me frymëmarrjen e shpejtë dhe të mbytur të dallgëve të tij të vogla. Ecja ngadalë drejt shkëmbinjve dhe ndjeja të më çahej balli nën diell. E gjithë ajo nxehtësi rëndonte mbi mua dhe më pengonte ecjen para. Dhe sa herë ndjeja frymën e saj të nxehtë mbi fytyrën time, shtrëngoja dhëmbët, mblidhja grushtet në xhepat e pantallonave, tendosesha i gjithi për të mposhtur diellin dhe dehjen e turbullt që derdhte mbi mua. Nofullat e mia tkureshin nga çdo teh drite që shpërthente nga rëra, nga ndonjë guaskë e zbardhur apo nga ndonjë copë qelqi. Eca gjatë.

Shihja nga larg grumbullin e vogël dhe të errët të shkëmbinjve, të rrethuar nga një ylber rrezesh dielli dhe pluhuri ujor. Mendova për burimin e freskët prapa shkëmbit. Kisha dëshirë të dëgjoja gurgullimën e tij, kisha dëshirë t'i arratisesha diellit, t'i arratisesha çdo mundimi, çdo loti gruaje dhe të

prehesha më në fund në hije. Por kur u afrova më shumë, pashë se tipi i Rajmondit ishte kthyer. Ai ishte vetëm. Ai po pushonte shtrirë në shpinë, me duart nën zverk, ballin nën hijen e shkëmbit, tërë trupin në diell. Kominoshet e kaltra lëshonin avull. Mbeta disi i befasuar. Për mua ajo ishte një histori e mbaruar dhe kisha shkuar aty pa menduar për të.

Sapo më pa, u çua mbi bërryla dhe futi dorën në xhep. Unë, natyrisht, shtrëngova revolverin e Rajmondit. Atëherë ai filloi të tërhiqet prapa, por pa e hequr dorën nga xhepi. Isha mjaft larg tij, rreth dhjetë metra. Ai i mbante qepallat gjysmë të mbyllura, por shihja herë pas here sytë e tij. Ajo që më kërcente më së shpeshti para syve të mi, në ajrin e përvëluar, qe fytyra e tij. Zhurma e dallgëve ishte bërë edhe më e zvargur, edhe më e qetë se në mesditë. Megjithatë aty shtrihej i njëjti diell, e njëjta dritë, mbi të njëjtën rërë. Po bëheshin dy orë që dita kishte ngelur në vend, dy orë që ajo kishte hedhur spirancën në një oqean metali të valuar. Në horizont kaloi një anije e vogël dhe njollën e errët e pashë vetëm me bisht të syrit, sepse nuk ia ndaja për asnjë çast vështrimin arabit.

Mendova se mjaftonte të bëja vetëm një gjysmë rrotullimi dhe gjithçka merrte fund. Por prapa meje shtrihej një plazh i tërë që përcëllohej nga dielli. Hodha disa hapa drejt burimit. Arabi nuk lëvizi. Sidoqoftë ishte ende mjaft larg. Ndoshta për shkak të hijeve që i binin në fytyrë, dukej sikur qeshte. Prita.

Alber Kamy-1 huaji

Faqet po më digjeshin nga dielli dhe ndjeva pikat e djersës të mblidheshin në vetullat e mia. Ishte i njëjti diell si ditën kur kisha varrosur mamanë dhe, si atëherë, balli më dhimbte dhe tërë damarët e tij rrihnin së bashku nën lëkurë. Hodha një hap para, për shkak të asaj djegie që nuk mund ta duroja më. E dija se ishte marrëzi, se nuk do të shpëtoja dot dielli duke u zhvendosur një hap. Por unë bëra nga një hap, një hap të vetëm para. Arabi, këtë herë, pa u çuar, nxorri thikën dhe ma tregoi në diell. Drita rrëshqiti mbi çelikun e saj dhe mua m'u duk sikur më goditi në ballë një teh i gjatë dhe i mprehtë. Në të njëjtin çast, djersa e grumbulluar te vetullat kulloi menjëherë mbi qerpikët dhe i mbuloi ato me një vello të vakët dhe të dendur. Sytë m'u verbuan prapa asaj perdeje lotësh dhe kripe. Tashmë ndjeja vetëm cimbalet e diellit mbi ballin tim dhe, turbull, diku para, përballë meje, tehun vezullues të thikës. Ai më dogji qerpikët dhe grreu sytë që më dhimbnin. Atëherë u lëkund çdo gjë. Deti lëshoi frymën e tij të rëndë dhe përvëluese. Mua m'u duk sikur qielli u ça në tërë shtrirjen e tij për të lëshuar një shi zjarri. E gjithë qenia ime u nder dhe unë shtrëngova dorën mbi revolver. Këmbëza lëvizi ngadalë, preka barkun e lëmuar të qytës dhe pikërisht këtu, mes zhurmës sa të thatë aq edhe shurdhuese të së shtënës, filloi gjithçka. Unë shkunda pikat e djersës dhe diellin. Unë kisha shkatërruar barazpeshën e ditës, heshtjen e jashtëzakonëshme të plazhit ku kisha qenë i lumtur. Atëherë qëllova edhe katër herë mbi një trup pa jetë u plumbat nguleshin pa u vene re.Dhe dukej sikur me ato kater te shtena te shkurterta trokita ne dere e fatkeqesis.

87

Pjesa e dytë

I

Menjëherë pas arrestimit, u mora shumë herë në pyetje. Por në to ishte fjala vetëm për të përcaktuar identitetin tim, prandaj dhe nuk vazhdonin gjatë. Herën e parë në komisariat, u duk sikur askush nuk çante kokën për çështjen time. Përkundrazi, tetë ditë më pas, hetuesi, më vështroi me kureshtje. Sa për t'ia nisur, ai vetëm më pyeti për emrin dhe adresën time, për profesionin, datën dhe vendlindjen time. Pastaj deshi të dinte nëse ia kisha vënë gishtin ndonjë avokati. I thashë se nuk ia kisha vënë gishtin ndonjë avokati dhe e pyeta, sa për ta ditur, se a ishte e domosdoshme të kishe një të tillë.

- Përse pyesni? - u habit ai.

Iu përgjigja se çështja ime më dukej shumë e thjeshtë. Ai qeshi duke thënë:

- Ky është mendimi juaj, por, ligji është ligj. Në qoftë se nuk e gjeni vetë avokatin, do ta caktojmë ne.

Mua m'u duk shumë e volitshme që drejtësia të merrej vetë me këto hollësira. Ia shpreha këtë mendim edhe hetuesit. Ai ma miratoi mendimin tim dhe e mbylli bisedën duke thënë se ligji i kishte

kopsitur mirë të gjitha gjërat.

Në fillim nuk u solla dhe aq seriozisht me hetuesin. Ai më priti në një kthinë të veshur me perde. Në tryezën e tij të punës kishte vetëm një llambë që ndriçonte kolltukun ku më uli, ndërsa për vete mbeti në hije. Kisha lexuar një përshkrim të ngjashëm nëpër libra dhe e gjitha m'u duk si një lojë. Pas bisedës sonë, përkundrazi, e vështrova me vëmendje dhe pashë tek ai një njeri me tipare të holla, me sy të kaltër, trupmadh, me mustaqe të gjata të thinjura dhe flokë të dendur pothuaj të bardhë. Ai m'u duk shumë i arsyeshëm, me gjithë ngërçet nervore, që i shtrembëronin gojën. Duke dalë, isha gati duke i zgjatur dorën, por e mblodha veten në kohë dhe u kujtova se kisha vrarë një njeri.

Të nesërmen erdhi për të më takuar në burg një avokat. Ai ishte trupvogël dhe rrumbullak, mjaft i ri, me flokë të shtruara me shumë kujdes. Pavarësisht se bënte vapë (unë isha me këmishë me mëngët e përveshura), ai kishte veshur një kostum të errët, jakën e kishte të kollarisur dhe kravatën të çuditshme me vija të trasha të zeza dhe të bardha. Avokati la mbi shtratin tim çantën që mbante nën krah, m'u paraqit dhe më tha se e kishte studjuar dosjen time. Çështja ime ishte shumë e ndërlikuar, por ai nuk dyshonte te suksesi, veçse me një kusht: unë duhej të tregohesha i çiltër me të. E falenderova dhe ai më tha: sonë.

- Dhe tani le të hyjmë në thelb të çështjes

U ul mbi shtratin tim dhe më shpjegoi se kishte marrë të dhëna mbi jetën time. Kishte mësuar se nëna më kishte vdekur para pak kohësh në azil. Kishin pyetur edhe në Marengo. Nga hetimi kishin marrë vesh se "kisha dhënë prova pandjeshmërie" ditën e varrimit të mamasë.

- Edhe vetë e kuptoni, që ndjehem ngushtë t'ju pyes për këtë, - tha avokati. - Por është me shumë rëndësi. Ai do të jetë një argument i fortë për akuzën, në qoftë se nuk do të di si të përgjigjem.

Ai donte që ta ndihmoja. Ai më pyeti nëse ndjeja dhimbje atë ditë. Kjo pyetje më habiti shumë, sepse për vete do të ndjehesha shumë ngushtë po të pyesja për gjëra të tilla. Megjithatë iu përgjigja se e kisha humbur disi zakonin për t'u zhytur në shpirtin tim dhe se e kisha të vështirë t'i përgjigjesha pyetjes së tij. Pa dyshim që e doja shumë mamanë, por kjo nuk thoshte asgjë. Të gjitha qeniet me mend e kishin dëshiruar pak a shumë vdekjen e atyre që donin. Këtu, avokati më ndërpreu dhe m'u duk shumë i tronditur. Ai më detyroi t'i jepja fjalën se nuk do ta shprehja atë mendim as në gjyq dhe as para prokurorit. Megjithatë i shpjegova se kisha një natyrë të tillë që nevojat e mia fizike trazonin shpesh ndjenjat e mia. Ditën kur varrosa mamanë, isha shumë i lodhur dhe kisha gjumë. Aq sa nuk po e kuptoja ç'po ndodhte. Ajo që mund të them me siguri, është se nuk do të kisha dashur që mamaja të vdiste. Por avokati im nuk dukej i kënaqur. Ai më tha: - Kaq është pak.

Pastaj u zhyt në mendime. Ai më pyeti nëse mund të thuhej se atë ditë i kisha mposhtur ndjenjat e mia të natyrshme. I thashë:

- Jo, do të gënjeja, po të thosha këtë.

Ai më vështroi disi çuditshëm, sikur i ngjallja një farë neverie. Ai më tha tërë ligësi se sidoqoftë drejtori dhe personeli i azilit do të dëgjoheshin si dëshmitarë dhe se dëshmitë e tyre mund ktheheshin shumë keq kundër meje. I vura në dukje se ajo histori nuk kishte asnjë lidhje me çështjen time, por ai m'u përgjigj, se dukej qartë që nuk kisha patur kurrë punë me drejtësinë. Ai u largua i zemëruar. Do të doja ta mbaja, t'i shpjegoja se do isha i lumtur sikur të fitoja simpatinë e tij, jo që të më mbronte më mirë në gjyq, por, nëse mund ta them, i shtyrë nga një ndjenjë e natyrshme njerëzore. Ajo që më shqetësonte më shumë ishte se e shihja që mërzitej nga unë. Ai nuk më kuptonte dhe për këtë nxehej. Kisha dëshirë t'i pohoja se isha si të gjithë, tërësisht si të gjithë. Por, në thelb, e tëra kjo nuk kishte ndonjë dobi të madhe dhe unë hoqa dorë prej saj nga përtimi.

Nuk kaloi shumë dhe më çuan përsëri para hetuesit. Ishte ora dy e mbasditës dhe zyrën e tij e kishte mbytur një dritë e zbutur nga një perde prej tyli. Bënte shumë vapë. Hetuesi më uli dhe, me shumë mirësjellje, më tha se avokati im, për "rrethana të paparashikuara" nuk mundi të vinte. Unë kisha të drejtë të mos përgjigjesha dhe të prisja që të ndodhej i pranishëm edhe avokati. I thashë se mund

të përgjigjesha edhe pa qenë i pranishëm avokati. Ai shkeli me gisht një buton mbi tryezë. Një sekretar i ri gjyqi erdhi dhe zuri vend pothuaj pas shpinës sime.

Unë dhe hetuesi zumë vend mirë në kolltukët tanë. Marrja në pyetje filloi. Në fillim më tha se mua më përshkruajnë sikur kam një natyrë të heshtur dhe të mbyllur dhe ai donte të dinte, nëse ishte apo jo kështu. U përgjigja:

- Kjo ndodh nga që asnjëherë nuk kam ndonjë gjë të madhe për të thënë. Dhe me që është kështu, nuk flas.

Ai qeshi si herën e parë, e pranoi se ishte një arsye shumë e fortë dhe shtoi:

- Por, nga ana tjetër, kjo nuk ka asnjë rëndësi. -Heshti, m'i mbërtheu sytë dhe drejtoi përnjëherësh trupin për të më thënë shpejt e shpejt: - Ajo që më intreson mua, jeni ju.

Nuk e kuptova mirë se ç'kuptonte me këtë, prandaj nuk fola.

- Ka gjëra, - shtoi hetuesi, - që nuk i kap dot në gjestin tuaj. Jam i sigurtë se do të më ndihmoni për t'i kuptuar.

I thashë se gjithçka ishte shumë e thjeshtë. Ai më shtyu t'i përshkruaja hollësisht si e kisha kaluar atë ditë. I përshkrova atë që tashmë ia kisha treguar: Rajmondi, plazhi, banja, grindja, përsëri plazhi, burimi i vogël, dielli dhe pesë të shtënat e revolverit. Ai thoshte pas çdo fjalie: "Mirë, mirë." Kur mbërrita te trupi i shtrirë, ai miratoi duke thënë: "Mirë." Mua

më mjaftoi të përsërisja kështu të njëjtën histori dhe po më dukej sikur nuk kisha folur asnjëherë aq shumë.

Ai u çua, pas mbretërimit të një heshtjeje, dhe më tha se donte të më ndihmonte, se i interesoja dhe se me ndihmën e Zotit, do të bënte diçka për mua. Por më përpara, donte të më bënte përsëri disa pyetje. Dhe më pyeti, pa bërë dredha, nëse e doja mamanë. Thashë: "Po, si të gjithë", dhe sekretari, që deri atëherë kishte shtypur rregullisht në makinën e shkrimit, duhej të kishte ngatërruar gërmat, sepse u hutua dhe u detyrua të kthehej pas. Atëherë, pa ndonjë logjikë të dukshme, hetuesi më pyeti në kisha qëlluar pesë herë rrjesht me revolver. U mendova dhe saktësova se në fillim kisha qëlluar një herë të vetme dhe, pas disa sekondash, katër të shtënat e tjera.

- Përse pritët midis së shtënës së parë dhe së shtënës së dytë? - pyeti atëherë hetuesi.

Unë pashë edhe një herë tjetër plazhin e kuq dhe ndjeva mbi ballë përvëlimin e diellit. Por këtë herë, nuk u përgjigja. Hetuesi u duk i acaruar, gjatë tërë heshtjes që pasoi. U ul, futi gishtat mes flokëve, vuri bërrylat mbi tryezë dhe u përkul pak drejt meje me një pamje të habitshme:

- Përse, përse qëlluat mbi një trup të shtrirë për tokë?

Edhe këtë herë nuk u përgjigja. Hetuesi kaloi dorën mbi ballë dhe përsëriti pyetjen me një zë disi të dridhur:

- Përse? Duhet të ma thoni. Përse?

Unë vazhdova të hesht. Ai u ngrit befas, eci me hapa të mëdhenj drejt njërit skaj të zyrës dhe hapinjë sirtar në një skedar. Nxorri prej andej një kryq prej argjendi, që e tundi duke ardhur drejt meje. Dhe me një zë të ndryshuar, pothuaj dridhëronjës,

bërtiti:

-A e njihni këtë?

Thashë:

- Po, natyrisht që e njoh.

Atëherë ai më tha shumë shpejt, përfshirë nga pasioni se besonte te Zoti, se qe i bindur që asnjë njeri nuk ishte aq fajtor sa Zoti të mos e falte, por për këtë duhej që njeriu nëpërmjet pendimit të kthehej në fëmijë, shpirti i të cilit është i zbrazët dhe i gatshëm të presë çdo gjë. Ai ishte përkulur me tërë trupin mbi tryezë dhe tundëte kryqin e tij pothuaj mbi mua. Me thënë të vërtetën, nuk e ndoqa ashtu si duhej arsyetimin e tij, në rradhë të parë sepse kisha vapë dhe se në kabinetin e tij kishte miza të mëdha që uleshin në fytyrën time, por edhe sepse ai më shtinte pak frikën. Në të njëjtën kohë e pranoja se ajo frikë ishte qesharake sepse kriminel nuk ishte ai por unë. Megjithatë ai vazhdoi të fliste. Pak nga pak fillova të kuptoj se sipas mendimit të tij në rrëfimin tim kishte vetëm një pikë të errët dhe kjo pikë e errët ishte fakti që kisha pritur për të qëlluar për të dytën herë. Ndërsa gjithë të tjerat i kuptonte, këtë nuk e kuptonte.

Po matesha t'i thosha se e kishte gabim që ngulmonte në atë rrethanë: ajo nuk kishte ndonjë

rëndësi të madhe. Por ma preu fjalën dhe, duke drejtuar trupin, i bëri thirrje për herë të fundit vetëdijes sime, duke më pyetur nëse besoja te Zoti. I thashë se nuk besoja. U ul i zemëruar. Ai më tha se ishte e pamundur, se të gjithë njerëzit besonin te Zoti, edhe ata që i kishin kthyer shpinën fytyrës së tij. Për këtë ishte më se i bindur dhe, sikur të dyshonte ndonjëherë për këtë, jeta e tij nuk do të kishte kuptim.

- Doni ju, -këlthiti, - që jeta ime të mos ketë kuptim?

I thashë se për mendimin tim, kjo nuk më takonte mua. Ai më zgjati mu përpara syve Krishtin e kryqëzuar dhe bërtiti në mënyrë të paarsyeshme: - Unë jam i krishterë. Unë i lutem që të të falë gabimet. Si mund të mos besosh se ai ka vuajtur për ty?

Vura re se më fliste me ti, por tani më kishte ardhur në majë të hundës. Vapa bëhej përherë e më e madhe. Si gjithmonë, kur kam dëshirë të çlirohem nga dikush që nuk e dëgjoj dot, fillova vetëm të miratoj. Për habinë time, ai ngadhnjeu:

- E sheh, e sheh, - thoshte. - Tani që beson, do t'i mbështetësh të gjitha shpresat tek Zoti?

I thashë edhe një herë tjetër që nuk do t'i mbështesja shpresat te Zoti. Ai u shemb në kolltuk.

Dukej shumë i dërrmuar. Qëndroi një çast i heshtur, ndërsa makina e shkrimit që nuk kishte rreshtur së ndjekur dialogun, po zgjatej ende në

fjalitë e fundit. Më pas, më vështroi me vëmendje

dhe pak i mërzitur. Murmuriti:

- Nuk kam parë kurrë një shpirt më të ngurtë se shpirti yt. Kriminelët që kanë ardhur para meje kanë qarë gjithmonë para kësaj fytyre të dhimbjes.

Doja t'i përgjigjesha se ata qanin sepse ishin kriminelë, por mendova se edhe vetë isha si ata. Megjithatë nuk mund të pajtohesha me këtë mendim. Atëherë hetuesi u çua, si të më tregonte se marrja në pyetje kishte mbaruar. Ai vetëm më pyeti me të njëjtën pamje disi të lodhur nëse ndjeja keqardhje për veprimin tim. U mendova dhe thashë se më shumë se një keqardhje të vërtetë, ndjeja një lloj mërzie. Pata përshtypjen se ai nuk më kuptonte. Por atë ditë gjërat nuk shkuan më tej.

Më pas më çuan shpesh tek hetuesi. Veçse çdo herë që shkoja tek ai, isha i shoqëruar nga avokati. Ata kufizoheshin vetëm në saktësimin e disa pikave të deklarimeve të mia të mëparshme. Ose hetuesi diskutonte me avokatin pikat e akuzës. Por në të vërtetë, në ato çaste, nuk u morën kurrë me mua. Sidoqoftë, pak nga pak, toni i marrjeve në pyetje ndryshoi. Dukej sikur hetuesi nuk interesohej më për mua dhe se e kishte mbyllur në një farë mënyre çështjen time. Ai nuk më foli më për Zotin dhe nuk e pashë kurrë në gjendjen e eksituar të ditës së parë. Bisedat tona u bënë më të përzemrëta. Marrjet në pyetje përfundonin me disa pyetje dhe pak bisedë me avokatin tim. Çështja ime ndiqte rrugën e saj, sipas vetë shprehjes së hetuesit. Po ashtu, nganjëherë, kur biseda ishte për tema të përgjithshme, më përzienin

edhe mua aty. Në ato çaste, askush nuk ishte i lig me mua. Çdo gjë qe e natyrshme, e rregulluar shumë mirë, loja vazhdonte në mënyrë aq të përmbajtur, sa më krijohej përshtypja qesharake se "bëja pjesë në familjen e tyre". Dhe në fund të njëmbëdhjetë muajve

që vazhdoi hetimi, mund të them me plot gojë se habitem që u jam gëzuar përherë vetëm atyre çasteve të rralla kur hetuesi më shoqëronte deri te dera e kabinetit të tij dhe duke më rënë lehtë në sup, më thoshte me një pamje të përzemërt:

- Për sot mbaruam, zoti Antikrisht. Dhe pastaj më dorëzonin te xhandarët.

II

Ka gjëra për të cilat nuk kam dashur kurrë të flas. Kur hyra në burg, pas disa ditësh kuptova se nuk do të më pëlqente të flisja për këtë pjesë të jetës sime. Më vonë, nuk gjeta ndonjë shkak të rëndësishëm për këtë neveri. Ditët e para, në thelb, nuk isha me të vërtetë në burg: prisja turbull ndonjë ngjarje të re. Çdo gjë filloi vetëm pas vizitës së parë dhe të vetme të Marisë. Nga dita kur mora letrën e saj (ajo më shkruante se nuk e lejonin më të vinte për të më takuar sepse nuk ishte gruaja ime), nga ajo ditë, ndjeva se në qeli isha në shtëpinë time dhe se jeta ime ndalej aty. Ditën e arrestimit tim, më mbyllën në fillim në një dhomë ku kishte shumë të burgosur, pjesa më e madhe arabë. Ata qeshën sapo më panë. Pastaj më pyetën se ç'kisha bërë. U thashë se kisha vrarë një arab dhe ata nuk e hapën më gojën. Por pas pak ra mbrëmja. Ata më shpjeguan si duhej rregulluar rrogozi ku do të shtrihesha. Duke mbledhur rrotull njërin fund, mund të bëje një jastëk të gjatë. Tartabiqët shetitën tërë natën mbi fytyrën time. Disa ditë pas më veçuan në një qeli ku flija mbi një pjesë të ngritur prej druri ngjitur pas murit. Kisha një govatë

dhe një legen hekuri. Burgu ndodhej në majë të qytetit dhe nga një dritare e vogël, mundja të shihja detin. Një herë, kur u ngjita i kapur pas hekurave të dritares dhe i tregova fytyrën diellit, hyri një rojtar burgu dhe më tha se kisha një vizitë. Mendova se do të ishte Maria. Dhe ishte pikërisht ajo.

Për të shkuar te salla e takimeve, eca nëpër një korridor të gjatë, pastaj nëpër një shkallë, për të përfunduar në një korridor tjetër. Hyra në një sallë shumë të madhe të ndriçuar nga një dritare e gjerë. Salla ishte ndarë në tre pjesë nga dy kangjella të mëdha që e prisnin për së gjati. Midis dy kangjellave ndodhej një hapësirë nga tetë në dhjetë metra që ndante vizitorët nga të burgosurit. Pashë Marinë përballë meje me fustanin e saj me vija dhe fytyrën e nxirë nga dielli. Nga ana ime ndodheshin nja dhjetë të burgosur, pjesa më e madhe arabë. Maria ishte rrethuar nga maure dhe ndodhej midis dy vizitoreve: një plake të vockël me buzët shtrënguar, veshur me të zeza dhe një gruaje të trashë pa shami në kokë, që fliste me sa i hante gryka, duke lëvizur kokë e këmbë. Vizitorët dhe të burgosurit ishin të shtrënguar të bërtisnin shumë fort, për shkak të largësisë midis hekurave. Kur hyra unë, zhurma e zërave përplasej pas mureve të mëdha dhe të zhveshura të sallës, drita e fortë që rridhte nga qielli mbi qelqet dhe shpërthente në sallë, më shkaktuan një lloj trullosjeje. Qelia ime ishte më e qetë dhe më e errët. M'u deshën disa sekonda për t'u përshtatur. Megjithatë, arrita të shquaj pastër çdo fytyrë, që kisha para. Pashë një

rojtar që rrinte ulur në skaj të korridorit midis dy kangjellave prej hekuri. Pjesa më e madhe e të burgosurve arabë si dhe familjarët e tyre ishin ulur galiç ballë për ballë. Ata nuk bërtisnin. Me gjithë gurgulenë, arrinin të merreshin vesh duke folur me zë të ulët. Murmurima e tyre e mbytur, që fillonte sa më ulët, formonte një lloj shtrese të pandërprerë për bisedat që kryqëzoheshin përmbi kokat e tyre. Të gjithë këtë e vërejta shumë shpejt duke bërë para drejt Marisë. Ajo më buzëqeshte me sa forcë që kishte, ngjitur pas hekurave. Mua m'u duk shumë e bukur, por nuk dita si t'ia thosha.

- Hë? - më tha me zë të lartë.

- Ja, siç më sheh.

- Je mirë, i ke të gjitha që të duhen? - I kam, të gjitha.

Heshtëm dhe Maria vazhdonte të buzëqeshte. Gruaja e shëndoshë ulërinte drejt fqinjit tim, pa dyshim i shoqi, një tip turpmadh e flokëverdhë me një vështrim të çiltër. Ishte vazhdimi i një bisede tashmë të filluar.

- Zhana nuk donte ta merrte, - bërtiti gruaja me sa i hante në kokë.

- Po, po, - thoshte burri.

- I thashë se sapo të dalësh do ta marrësh përsëri në shtëpi, por ajo nuk donte ta merrte.

Maria bërtiti nga ana e vet se Rajmondi më dërgonte të fala dhe unë thashë: "Faleminderit". Zëri im u mbulua nga fqinji im që pyeti "në ishte mirë". Gruaja e tij qeshi duke thënë se "ai nuk kishte qenë

kurrë më mirë se kaq". Fqinji që kisha në të majtë, një djalë me duar të holla, nuk fliste. Pashë se ai ishte përballë plakës së vockël dhe që të dy po e përpinin njëri-tjetrin me sy. Por nuk pata kohë t'i vëzhgoja më gjatë sepse Maria më bërtiti se nuk duhej të humbisja shpresën. I thashë: "Po". Në të njëjtën kohë nuk ia ndaja sytë dhe kisha dëshirë t'ia shtrëngoja supet përmbi fustan. Kisha dëshirë për atë pëlhurë të hollë dhe nuk e dija shumë mirë se ç'duhej shpresuar përveç saj. Pa dyshim edhe Maria këtë donte të thoshte, sepse qeshte vazhdimisht. Unë shihja vetëm shkëlqimin e dhëmbëve të saj dhe rrudhat e vogla të syve të saj. Ajo bërtiti përsëri:

- Do të dalësh dhe do të martohemi!

Iu përgjigja:

- Kështu mendon?, - por këtë e thashë vetëm pse duhej thënë diçka. Atëherë ajo tha shumë shpejt dhe përherë me zë shumë të lartë se po, unë do të falesha dhe do të laheshim përsëri bashkë. Por gruaja tjetër ulërinte nga ana e saj dhe thoshte se kishte lënë një shportë te sekretaria e burgut. Ajo numëroi çdo gjë që kishte futur aty. Ai duhej ta verifikonte, se kushtonin shtrenjt. Fqinji tjetër dhe nëna e tij vështronin vazhdimisht njëri-tjetrin. Murmurima e arabëve vazhdonte mbi kokat tona. Jashtë drita u duk sikur po mbufatej pas dritares së gjerë. Nuk po ndjehesha mirë dhe do të doja të largohesha. Zhurma më shkaktonte dhimbje. Por nga ana tjetër, doja të përfitoja nga prania e Marisë. Nuk e di sa kohë kaloi. Maria më fliste për punën e saj dhe qeshte

pa pushim. Murmurimat, thirrjet, bisedat kryqëzo- heshin me njëra-tjetrën. I vetmi ishull heshtjeje ishte ngjitur me mua tek ai djalë i ri dhe tek ajo plakë e vockël që e përpinin njëri-tjetrin me sy. Filluan të marrin një nga një arabët. Pothuaj të gjithë heshtën, sapo doli i pari. Plaka e vockël iu afrua hekurave dhe, në të njëjtin çast, njëri nga rojtarët ia bëri me shenjë djalit të saj. Ai tha: "Mirupafshim, mama" dhe ajo futi dorën midis hekurave dhe e tundi ngadalë dhe gjatë.

Ajo u largua ndërsa po hynte një burrë dhe zinte vendin e saj, duke mbajtur në dorë kapelën. Futën një të burgosur dhe ata nisën të flasin tërë gjallëri, por me gjysmë zëri, sepse salla ishte bërë e heshtur. Erdhën dhe morën fqinjin që kisha në të djathtë dhe gruaja e tij tha pa e ulur zërin si të mos e kishte vënë re se nuk ishte më nevoja të bërtisje: - Kujdesu për veten dhe hap sytë!

Pasta më erdhi mua rradha. Maria ma bëri me shenjë se më puthte. U ktheva nga ajo para se të largohesha. Ajo rrinte palëvizur, me fytyrën ngjeshur pas hekurave, me të njëjtën buzëqeshje të shqyer dhe të tkurrur.

Ajo më shkrojti pak më pas. Dhe që nga ky çast filluan gjërat për të cilat nuk kam dashur kurrë të flas. Sidoqoftë nuk duhet zmadhuar asgjë dhe këtë e jetova më lehtë se të tjerat. Megjithatë, në fillim të burgimit, ajo që ishte më e vështirë për t'u përballuar, qe se kisha mendime prej njeriu të lirë. Për shembull, më pushtonte dëshira për të qenë në

një plazh dhe të zbrisja drejt detit. Të përfytyroja zhurmën e dallgëve të para nën këmbët e mia, hyrjen e trupit në ujë dhe çlirimin që gjeja aty, por papritmas ndjeja sa ngushtë isha brenda mureve të burgut tim. Kjo vazhdoi disa muaj. Më pas, kisha vetëm mendime prej të burgosuri. Prisja shetitjen e përditshme që e bëja në oborr ose vizitën e avokatit tim. Përshtatesha shumë mirë me pjesën tjetër të kohës. Atëherë kam menduar shpesh se sikur të më detyronin të jetoja në një trung të tharë peme, pa asnjë punë tjetër veçse të shihja ngjyrën e qiellit mbi kokën time, do të isha mësuar pak nga pak edhe me këtë. Do të prisja kalimin e zogjve ose takimin e reve si prisja këtu kravatat e çuditshme të avokatit tim dhe si, në botën e mëparshme, mezi prisja sa të vinte e shtuna për të pushtuar mes krahëve trupin e Marisë. Mirëpo, duke vrarë mirë mendjen, nuk ndodhesha në një dru të tharë. Aty kishte më fatkeqë se unë. Veç të tjerash mamaja ma përsëriste shpesh se njeriu në fund të fundit mësohet me të gjitha.

Nga ana tjetër, zakonisht nuk shkoja shumë larg në gjykimet e mia. Muajt e parë qenë të vështirë. Por pikërisht më ndihmoi përpjekja që bëra për t'i kapërcyer. Për shembull, më sfiliste dëshira për një femër. Ishte e natyrshme, isha i ri. Asnjëherë nuk mendova për Marinë. Por mendoja vetëm për një femër, për femrat, për të gjitha ato që kisha shtënë në dorë, për rrethanat ku dhe kur isha afruar me to, sa qelia ime mbushej plot me fytyrat e tyre me dëshirat e mia. Nga njëra anë, kjo më prishte

barazpeshën shpirtërore, por nga ana tjetër, më ndihmonte të vrisja kohën. Kisha arritur të fitoja simpatinë e kryerojtarit që shoqëronte në orën e ngrënieve shpërndarësin e ushqimeve. Ai më foli i pari për femrat. Ai më tha se kjo ishte gjëja e parë për të cilën ankoheshin të tjerët. I thashë se isha si ata dhe se ai trajtim më dukej i padrejtë.

- Por, - tha ai, - pikërisht për këtë ju rrasin në burg.

- Si për këtë?

- Po, pra, gratë janë liria. Juve ju heqin lirinë. Nuk kisha menduar kurrë për këtë. E miratova: - Është e vërtetë,- i thashë, - ndryshe ç'kuptim do të kishte ndëshkimi?

- Po, ju i kuptoni gjërat. Të tjerët jo. Por arrijnë të lehtësohen vetë.

Dhe rojtari u largua pas këtyre fjalëve.

Edhe mungesa e cigareve më torturoi. Kur hyra në burg, më morën rripin, lidhëzat e këpucëve, kravatën dhe çdo gjë që kisha në xhepa, në mënyrë të veçantë cigaret. Me të më futur në qeli, kërkova të m'i kthenin. Por më thanë se ishte e ndaluar. Ditët e para qenë shumë të vështira. Ndoshta kjo më dërrmoi më tepër. Thithja copëra druri që i shkulja nga shtrati im. Vërtitesha tërë ditën e ditës nëpër qeli dhe kisha një neveri të përherëshme. Nuk e kuptoja përse më privonin nga kjo kënaqësi që nuk i bënte keq njeriu. Më vonë e kuptova se edhe kjo ishte pjesë e ndëshkimit. Por në atë çast isha mësuar të mos pija duhan dhe ai ndëshkim nuk ishte më për mua.

Alber Kamy-I huaji

Me përjashtim të këtyre mërzive, nuk isha dhe shumë fatkeq. E rëndësishme ishte, e them përsëri, ishte si të vrisje kohën. Nga çasti kur mësova të kujtoj, arrita të mos mërzitem më. Nganjëherë i vihesha kujtimit të dhomës sime dhe përfytyroja sikur nisesha nga një cep i saj për t'u kthyer përsëri duke u përpjekur të gjeja me mendje se ç'ndodhej në rrugën time. Në fillim, e bëja shpejt. Por sa herë që rinisja, rruga bëhej edhe më e gjatë. Sepse kujtoja të gjitha gjërat që ndodheshin aty dhe çdo gjë e përfytyroja me të gjitha hollësitë: ngjyrën dhe materialin, madje edhe një larzim, një plasaritje të vogël ose edhe ndonjë cifel të hequr nga trupi i tyre. Në të njëjtën kohë përpiqesha të mos e humbja fillin e inventarit tim, duke mos harruar asnjë send. Në krye të disa javëve, mund të kaloja orë të tëra, vetëm duke përshkruar çdo gjë që ndodhej në dhomën time. Kështu, sa më shumë që vrisja mendjen, aq më tepër gjëra të pavlerësuara dhe të harruara, nxirrja nga kujtesa ime. Atëherë kuptova se një njeri që jeton qoftë edhe një ditë në botë, mund të jetojë pa vështirësi njëqind vjet në një burg. Ai do të kishte aq kujtime sa të mos mërzitej. Në një kuptim, kjo qe një përparësi.

Pastaj vinte gjumi. Në fillim, flija keq natën dhe ditën nuk mbyllja dot sy. Pak nga pak, netët e mia u bënë më të mira dhe munda të flija edhe ditën. Mund të them se, muajt e fundit, flija nga gjashtëmbëdhjetë në tetëmbëdhjetë orë në ditë. Kështu që më mbeteshin gjashtë orë për të vrarë me ngrëniet, kryerjen e nevojave natyrore, kujtimet e mia

dhe historinë e një çeku.

Midis dyshekut me kashtë dhe dërrasës së shtratit, kisha gjetur, një copë të vjetër gazete, pothuaj të ngjitur me cohën e zverdhur dhe të tejdukshme. Ajo fliste për një ngjarje të habitshme, së cilës i mungonte fillimi, por që merrej me mend se kishte ndodhur në Çekosllovaki. Një njeri ishte nisur nga një fshat çek për të bërë pasuri. Ai u kthye, pas njëzet e pesë vjetësh, i pasur, me grua dhe një fëmijë. Nëna dhe motra e tij kishin në fshatin e lindjes një hotel. Për t'i befasuar, ai la gruan dhe fëmijën e tij në një hotel tjetër, kishte shkuar tek nëna që nuk e kishte njohur. Atij iu shkrep të bënte shaka dhe zuri një dhomë. Tregoi sa para kishte. Natën, nëna dhe motra e tij e vranë duke e goditur me çekan për ta vjedhur dhe trupin e tij e hodhën në lumë. Në mëngjes, erdhi në hotel e shoqja, që pa ditur asgjë nga ajo që kishte ndodhur, tregoi se kush ishte udhëtari. Nëna vari veten. Motra u hodh në pus. Duhet ta kem lexuar këtë histori me mijëra herë. Nga njëra anë ajo ishte e pabesueshme. Nga ana tjetër ishte e natyrshme. Sidoqoftë mua më dukej se udhëtari e meritonte në një farë mase atë që pësoi, sepse asnjëherë nuk duhet të luash teatër me të tjerët.

Kështu, së bashku me orët e gjumit, kujtimet, leximin e të vetmes copëz gazete, ndërrimin e dritës dhe të hijes, kalonte dhe koha. Kisha lexuar se në burg arrin të humbësh nocionin e kohës. Por kjo nuk kishte shumë kuptim për mua. Nuk kisha kuptuar deri në ç'pikë ditët mund të jenë sa të gjata aq edhe të

shkurtra. Dita zgjatet e zgjatet dhe nuk e vë re si shkrihet me ditën tjetër. Ato humbin emrin e tyre. Fjalët dje apo nesër ishin të vetmet që ruanin një kuptim për mua.

Kur rojtari më tha një ditë se kisha pesë muaj që ndodhesha aty, e besova, por nuk e kuptova. Për mua, ishte vazhdimisht e njëjta ditë që përhapej në qelinë time dhe e njëjta njollë që ndiqja. Atë ditë. pas largimit të rojtarit, u vështrova në gavetën prej hekuri. M'u duk sikur fytyra qëndronte serioze, ndërsa përpiqesha t'i buzëqeshja. E shkunda para vetes. Buzëqesha, kurse ajo nuk e ndryshoi pamjen e saj të ashpër dhe të trishtuar. Dita po mbaronte dhe ishte çasti për të cilin nuk dua të flas, çasti pa emër, ku zhurmat e mbrëmjes ngrihen lart nga të gjitha katet e burgut në një vargan heshtjeje. Iu afrova dritares dhe, në dritën e fundit, sodita edhe një herë fytyrën time. E përse ishte e habitshme që ajo vazhdonte të mbetej serioze, kur edhe vetë isha i tillë? Por në të njëjtën kohë dhe për herë të parë prej muajsh, dëgjova qartë tingullin e zërit tim. Unë njoha tek ai zërin që kumbonte prej shumë ditësh në veshët e mi dhe kuptova se gjatë tërë asaj kohe kisha folur me veten. Atëherë më erdhi në mendje ajo që tha infermierja në varrimin e mamasë. Jo, nuk kishte asnjë rrugëdalje dhe askush nuk mund ta përfytyrojë se ç'janë mbrëmjet në burg.

III

Mund të them me plot gojë se vera e parë u zëvendësua shumë shpejt nga vera e dytë. E dija se me fillimin e ditëve të nxehta, do të ndodhte diçka e re për mua. Çështja ime ishte caktuar për sesionin e fundit të gjykatës dhe sesioni i fundit përfundonte së bashku me muajin qershor. Shqyrtimi i saj filloi në kulmin e vapës, kur dielli shndriste në qiellin e verës. Avokati më siguroi se gjyqi nuk kishte për të vazhduar më shumë se dy apo tre ditë.

- Gjyqi do të bëhet shpejt e shpejt, - kishte shtuar ai, - sepse çështja juaj nuk është më e rëndësishmja e këtij sesioni. Menjëherë pas saj do të mbahet gjyqi i një atvrasësi.

Në orën shtatë e gjysëm të mëngjesit, erdhën dhe më morën me makinën e burgut, për të më çuar në gjykatë. Dy xhandarë më futën në një kthinë të vogël, që mbante erë myk. Pritëm të ulur njëri pranë tjetrit pranë një derë, prapa së cilës dëgjoheshin zëra, thirrje, kërcitje karrigesh dhe një rrëmujë që më shtiu në mendje festat e lagjes kur, pas koncertit, rregullonim sallën që të fillonim kërcimin. Xhandarët më thanë se duhej të prisnin trupin gjykues dhe njëri prej tyre më zgjati një cigare, të cilën nuk e mora.

Pas pak më pyeti:

- Të duket e tmerrshme?

Iu përgjigja që jo. Madje, në një kuptim, po më dukej interesant të shihje një proçes gjyqësor. Nuk kisha parë kurrë në jetën time një gjyq.

-Ashtu është, - tha xhandari i dytë, - por pastaj fillon dhe të lodh.

S'kaloi shumë kohë dhe në kthinë ushtoi një zile e vogël. Atëherë më hoqën prangat dhe më ulën në bankën e të akuzuarve. Salla ishte mbushur plot e përplot. Me gjithë perdet e ulura, dielli futej përsëri brenda dhe ajri ishte aq mbytës, sa mezi mbusheshe me frymë. Dritaret i kishin lënë të mbyllura. U ula dhe xhandarët më vunë në mes. Atë çast pashë para meje një varg fytyrash. Të gjitha më vështronin mua: atëherë e kuptova se ishin anëtarët trupit gjykues. Por nuk them dot se dalloheshin nga njëri-tjetri. Mua më dukej sikur ndodhesha në ndenjësen e një tramvaji dhe të gjithë udhëtarët e panjohur përgjonin të porsambërriturin, për t'i gjetur ndonjë cen qesharak. E dija se ky ishte një mendim i marrë, për deri sa këtu nuk kërkonin të gjenin ndonjë cen për të qeshur, por krimin. Megjithatë ndryshimi nuk është dhe aq i madh, por ja që ky mendim m'u shfaq atë çast.

Isha pak i shushatur nga tërë ata njerëz në atë sallë të mbyllur. Vështrova përsëri sallën e gjyqit dhe nuk dallova asnjë fytyrë. Tani e di fare mirë se në fillim nuk e kuptova se të gjithëve nuk u durohej sa të më shihnin. M'u desh të mblidhja veten për të kuptuar se shkaku i gjithë asaj rrëmuje isha unë.

-Sa shumë njerëz që kanë ardhur! - i thashë xhandarit. Ai më tha se tërë ata njerëz kishin ardhur për shkak të gazetave dhe më tregoi një grup njerëzish që qëndronin pranë një tryeze, nën tribunën e trupit gjykues. Pastaj përsëriti:
Ja ku i ke dhe gazetarët.
E pyeta:

- Cilët?
Dhe ai përsëriti:
-Gazetarët.

Ai njihte njërin prej tyre, të cilin e pa atë çast dhe që po vinte drejt nesh. Ishte një burrë i moshuar, simpatik, me një fytyrë pak ngërdheshëse. Ai i shtrëngoi dorën xhandarit me shumë përzemërsi. Atë çast vura re se të gjithë takoheshin me njëri-tjetrin, i bënin zë njëri-tjetrit dhe bisedonin, si në një klub ku ndjehesh mirë të takosh njerëz të rrethit tënd. Dhe ndoshta nga kjo m'u krijua përshtypja e çuditshme sikur isha i tepërt, sikur isha aty një mik i paftuar. Megjithatë, gazetari m'u drejtua duke buzëqeshur. Ai më tha se shpresonte që gjithçka të shkonte mirë për mua. E falenderova dhe ai shtoi:

- E dini, e frymë pak çështjen tuaj. Vera, është një stinë shterpë për gazetat. Vetëm historia juaj dhe ajo e atvrasësit, ia vlejnë diçka.

Më pas më tregoi, në grupin nga sapo ishte larguar, një burrë të shkurtër që i ngjante një nuselaleje të dhjamosur, me syze shumë të mëdha me rreth të zi. Ishte i dërguari i posaçëm i një gazete të Parisit:

-Ç'është e vërteta nuk erdhi për ju. Por me që është ngarkuar të shkruajë për gjyqin e atvrasësit, i kërkuan të nisë në të njëjtën kohë edhe ndonjë shkrim për çështjen tuaj.

M'u desh ta falenderoja përsëri. Por mendova se ishte qesharake. Më përshëndeti përzemërsisht dhe u ndamë. Pritëm edhe disa minuta.

Erdhi avokati im, veshur me togë, rrethuar nga shumë kolegë të tjerë. Ai eci drejt gazetarëve, shtrëngoi duar. Bënë shaka, qeshën dhe dukeshin të gjithë në qejf, deri kur në sallë ushtoi zilja. Të gjithë zunë vendet e tyre. Avokati im erdhi drejt meje, më shtrëngoi dorën dhe më këshilloi t'u përgjigjem shkurt pyetjeve që do të më bëheshin, të mos thosha asgjë i pari dhe për të tjerat të mbështetesha tek ai.

Dëgjova, në të majtë, zhurmën e një karrigeje që u tërhoq pas dhe pashë një burrë të gjatë dhe të hollë, me mantel të kuq, me një palë syze të modës së vjetër që kapeshin te hunda, të ulej duke palosur petkun e tij. Ishte prokurori. Një ftues lajmëroi hyrjen e trupit gjykues. Në të njëjtin çast, filluan të gumëzhijnë dy ventilatorë të mëdhenj. Tre gjykatës, dy me të zeza,i treti me të kuqe, hynë me dosje në duar dhe ecën shumë shpejt drejt tribunës që sundonte sallën. Njeriu me petk të kuq u ul në kolltukun e mesit, vuri kapelën para vetes, fshiu kafkën e vogël tullace me një shami dhe e deklaroi gjyqin të hapur.

Tashmë të gjithë gazetarët mbanin gati në dorë stilografët e tyre. Megjithatë të gjithë kishin

një pamje moskokëçarëse dhe disi finoke. Por njëri prej tyre, shumë më i ri, veshur me një këmishe fanellate të hirtë me një kravatë të kaltër, kishte lënë stilografin para vetes dhe më vështronte mua. Në fytyrën e tij disi të parregullt shihja vetëm dy sy, shumë të çelur, që më shqyrtonin me vëmendje, me një shprehje të paqartë. Ndoshta për këtë dhe ndoshta nga që nuk i njihja zakonet e atij mjedisi, nuk e kuptova shumë mirë gjithçka që ndodhi më pas, hedhjen short të gjyqtarëve, pyetjet që kryetari i bëri avokatit, prokurorit dhe anëtarëve të trupit gjykues (çdo herë, të gjitha kokat e anëtarëve ktheheshin në të njëjtën kohë nga kryetari i gjyqit), leximin e shpejtë të akt-akuzës, ku më ranë në vesh emra vendesh dhe njerëzish dhe pyetjet e tjera që iu bënë avokatit tim.

Kryetari tha se do të kalohej në thirrjen e dëshmitarëve. Ftuesi lexoi emrat që tërhoqën vëmendjen time. Nga gjiri i atij publiku, që pak më parë nuk kishte asnjë fytyrë të njohur, pashë të çoheshin një nga një, për t'u zhdukur te një derë anësore, drejtori dhe portieri i azilit, plaku Tomas Perez, Rajmondi, Masoni, Salamanoja, Maria. Ajo më bëri një shenjë të ankthshme. U habita përsëri që nuk i kisha parë më herët, kur në thirrjen e emrit të tij, i fundit, u çua Çeleste. Pranë tij njoha gruan e shkurtër dhe të mirë të restorantit, me jelekun dhe pamjen e saj të saktë dhe të vendosur. Ajo po më përpinte me sy. Por nuk pata kohë të mendohem, sepse kryetari mori fjalën. Ai tha se do fillonte proçesi dhe se e

shihte të kotë të këshillonte publikun të ishte i qetë. Sipas tij, ai ndodhej aty për të drejtuar me paanësi rrahjen e një çështjeje, që do ta shqyrtonte objektivitet. Vendimi i dhënë nga trupi gjykues do të merrej nën frymën e drejtësisë dhe, për çdo rast, qoftë edhe për ngjarjen më të vogël të papëlqyeshme, do të urdhëronte zbrazjen e sallës.

Nxehtësia rritej dhe shihja në sallë pjesëmarrësit të bënin fresk me gazeta. Kjo shkaktonte një zhurmë të vogël, të vazhdueshme, letre të zhubrosur. Kryetari bëri shenjë dhe ftuesi çoi tre freskore kashte, të cilat gjykatësit i vunë menjëherë në përdorim.

Marrja ime në pyetje filloi menjëherë. Kryetari më pyeti me qetësi madje, m'u duk mua, edhe me një nuancë përzemërsie. Më detyruan të them përsëri kush isha dhe me gjithë acarimin tim, mendova se në fund të fundit ajo ishte një kërkesë krejt e natyrshme, mbasi do të qe shumë e rëndë të gjykosh një njeri për një tjetër. Pastaj kryetari filloi tregimin e asaj që kisha kryer, duke m'u drejtuar mua në çdo tre fjali për të më pyetur: "Kështu ishte?". Dhe unë i përgjigjesha çdo herë: "Po, zoti kryetar", si më kishte mësuar avokati im. Kjo zgjati sepse kryetari u mëshonte shumë imtësirave në tregimin e tij. Gjatë tërë kësaj kohe, gazetarët shkruanin. Unë ndjeja vështrimet që më hidhte më i riu midis tyre dhe të asaj gruaje-automate trupvogël. Ndenjësja e tramvajit ishte kthyer e gjitha drejt kryetarit. Ai u kollit, shfletoi dosjen e tij dhe u kthye nga unë duke

bërë fresk.

Ai më tha se tani do të bënte disa pyetje që në dukje, nuk kishin lidhje me çështjen time, por që ndoshta nuk ishin edhe aq të huaja për të, mbasi në një farë mënyre e preknin nga shumë afër. E kuptova se do të fliste përsëri për mamanë dhe ndjeva menjëherë sa shumë më mërziste kjo gjë. Ai më pyeti përse e kisha futur mamanë në azil. U përgjigja sepse nuk kisha para që të paguaja dikë ta ruante dhe të kujdesej për të. Ai më pyeti a e pata të rëndë ndarjen me të dhe unë u përgjigja se as mamaja dhe as unë nuk prisnim më asgjë nga njëri-tjetri dhe nga askush tjetër dhe se ishim mësuar që të dy me jetët tona të reja. Atëherë kryetari tha se nuk donte të ngulmonte në këtë pikë dhe pyeti prokurorin nëse kishte për të më bërë ndonjë pyetje tjetër.

Prokurori më ktheu për gjysëm shpinën dhe, pa më vështruar, tha me lejën e kryetarit, se do të donte të dinte nëse isha kthyer drejt burimit vetëm fare me synimin për të vrarë arabin.

- Jo, - thashë unë.

- Atëherë përse ishe i armatosur dhe përse u ktheve pikërisht drejt atij vendi?

I thashë se ishte diçka krejt rastësore. Dhe prokurori tha me një ton të lig:

Kaq kisha tani për tani.

Më pas gjithçka qe disi e turbullt, të paktën për mua. Por pas disa bisedimesh kokë më kokë me kryetarin, ky i fundit e deklaroi seancën të mbyllur dhe ajo do të niste mbasdite me dëgjimin e dëshmitarëve.

Unë nuk pata kohë të mendoja. Më morën menjëherë, më hipën në makinë dhe më çuan në burg ku hëngra drekë. Kur kishte kaluar shumë pak kohë, aq sa ta kuptoja se isha i lodhur, erdhën dhe më morën përsëri; çdo gjë nisi nga e para dhe unë u ndodha në të njëjtën sallë, para të nëjtave fytyra. Vetëm nxehtësia ishte bërë më e fortë dhe si me magji, secili prej anëtarëve të gjyqit, prokurori, avokati dhe disa gazetarë ishin pajisur gjithashtu me freskore prej kashte. Gazetari i ri dhe gruaja e vogël ishin përherë në vendet e tyre. Por ata nuk bënin fresk dhe përsëri më vështronin pa thënë gjë.

Fshiva djersën që më mbulonte ballin dhe u vetëdijësova disi për vendin dhe për vetveten, vetëm kur dëgjova të thirrej drejtori i azilit. Atë e pyetën nëse ankohej mamaja për mua dhe ai tha se po, por shtoi se azilantët e kishin zakon të ankoheshin për njerëzit e tyre të afërt. Kryetari i tha të saktësonte nëse ajo më qortonte që e kisha futur në azil dhe drejtori tha përsëri po. Por këtë herë nuk shtoi asnjë fjalë. Një pyetjeje tjetër, iu përgjigj se kishte mbetur i befasuar nga qetësia ime ditën e varrimit. E pyetën se ç'kuptonte me fjalë "qetësi". Drejtori vështroi atëherë majën e këpucëve dhe tha se nuk kisha dashur të shihja mamanë, nuk kisha qarë as edhe një herë të vetme dhe se isha nisur menjëherë pas varrimit, pa qëndruar as edhe një çast mbi varrin e saj. Atij i kishte bërë përshtypje edhe diçka tjetër: një nga nëpunësit e zyrës së varrimeve i kishte thënë se unë nuk e dija moshën e mamasë. Heshtja sundoi

për një çast dhe kryetari e pyeti nëse po fliste me të vërtetë për mua. Me që drejtori nuk e kuptoi pyetjen, i tha: "Kështu është ligji." Pastaj, kur kryetari iu drejtua prokurorit nëse kishte ndonjë pyetje për dëshmitarin, ky i fundit bërtiti: "Oh, jo, edhe kaq sa dëgjuam mjafton". Ai bërtiti me kaq zjarr dhe më hodhi një vështrim kaq triumfues sa, për herë të parë që prej shumë vitesh, më pushtoi dëshira e marrë për të qarë, sepse e ndjeva sa shumë më urrenin të gjithë ata që ndodheshin aty.

Pasi pyeti anëtarët dhe avokatin tim në kishin pyetje për të më bërë, kryetari dëgjoi portierin. Për të ashtu si për gjithë të tjerët, u përsërit i njëjti ceremonial. Portieri, duke hyrë në sallë, më vështroi pastaj i largoi menjëherë sytë nga unë. Ai iu përgjigj pyetjeve që i bënë. Ai tha se nuk doja të shihja mamanë, se kisha pirë cigare, se kisha fjetur dhe se kisha pirë kafe me qumësht. Atëherë ndjeva se kjo zemëroi gjithë sallën dhe, për herë të parë, kuptova se isha fajtor. Portierin e detyruan të përsëriste historinë e kafes me sheqer dhe atë të cigares. Prokurori më vështroi me një shkrepëtimë ironie në sy. Atë çast, avokati im pyeti portierin, nëse kishte pirë edhe ai cigare bashkë me mua. Por prokurori u çua tërë vrull kundër kësaj pyetjeje: "Kush është krimineli këtu? A janë të lejueshme metodat që synojnë të përbaltin dëshmitë, që edhe pas kësaj mbeten dërrmuese?" Pavarësisht nga kjo, kryetari i kërkoi portierit t'i përgjigjet pyetjes së avokatit. Plaku tha i hutuar:

-E di që kam bërë gabim, por nuk guxoja

t'ia ktheja zotërisë cigaren që më zgjati. Në fund kryetari më pyeti mua, dëshiroja të shtoja ndonjëgje

-Asgjë, - iu përgjigja, - vetëm që dëshmitari ka të drejtë. Është e vërtetë që cigaren ia dhashë unë. Portieri më vështroi pak i habitur dhe më një lloj mirënjohjeje. Ai nguroi, pastaj tha se kishte qenë ai që më kishte dhënë kafe me qumësht. Avokati im triumfoi bujshëm dhe deklaroi që trupi gjykues ta vlerësonte atë dëshmi.

Por prokurori ushtoi mbi kokat tona dhe tha:

- Po, trupi gjykues do ta vlerësojë atë dëshmi. Dhe do të arrijë në përfundimin se një i huaj mund të propozonte për kafe, por një bir duhet të mos e pranonte para kufomës të asaj që e kishte sjellë në jetë.

Portjeri u ul në stolin e tij.

Kur erdhi rradha e Tomas Perezit, atë u desh ta mbante për krahu deri te vendi i dëshmitarit, një ftues gjyqi. Perezi tha se mbi të gjitha kishte njohur nënën time dhe se më kishte parë vetëm një herë, ditën e varrimit. Atë e pyetën se ç'kisha bërë atë ditë dhe ai u përgjigj:

- Ju e kuptoni, unë kisha shumë dhimbje për vete. Kështu që nuk pashë asgjë. Ishte vuajtja që më pengonte të shihja. Sepse për mua ajo ishte një vuajtje shumë e madhe. Madje, mua më ra të fikët. Kështu që nuk arrita të shoh zotërinë." Prokurori e pyeti nëse, të paktën, më kishte parë të qaja. Perezi u përgjigj që jo. Atëherë prokurori tha nga ana e vet:

- Zotërinjtë e trupit gjykues do ta vlerësojnë

edhe këtë dëshmi.

Por avokati im u zemërua. Ai e pyeti Perezin,

me një ton që m'u duk i tepruar, "nëse më kishte parë që nuk qaja". Perezi tha: "Jo." Publiku qeshi. Dhe avokati im, duke përthyer njërën mëngë, tha me një ton të prerë:

- Ja fytyra e këtij proçesi. Çdo gjë është e vërtetë dhe asgjë nuk është e vërtetë.

Prokurori u ngrys në fytyrë dhe u ra me majën e mprehtë të një lapsi vulave të dosjeve të tij.

Pas pesë minutash ndërprerjeje gjatë të cilave avokati më tha se gjithçka po shkonte sa s'kishte ku të vente më mirë, dëgjuan Çelesten që ishte thirrur si dëshmitar i mbrojtjes dhe mbrojtja isha unë. Ai hidhte herë pas here vështrimin nga unë dhe rrotullonte në duar një kapele prej kashte. Ishte me kostumin e ri që e vishte për të ardhur me mua, të dielave, në garat e kuajve. Por më duket se nuk kishte mundur të vinte jakën sepse kishte vetëm një kopsë prej bakri për të mbajtur këmishën e mbyllur. Atë e pyetën në isha klienti i tij dhe ai tha: "Po, është klienti dhe miku im"; pyetjes se ç'mendonte për mua, iu përgjigj se isha njeri; pyetjes se ç'kuptonte me këtë, iu përgjigj se e dinin të gjithë ç'do të thoshte; pyetjes nëse kishte vënë re që isha njeri i mbyllur, ai vetëm pohoi se mua nuk më pëlqente të flisja për gjepura. Prokurori e pyeti se a e paguaja tryezën. Çeleste qeshi dhe tha:

- Kjo ka të bëjë vetëm me ne të dy. - E pyetën përsëri se ç'mendonte për krimin tim. Ai vuri duart

te hekurat dhe u duk se kishte përgatitur diçka. Dhe tha: - Për mua është një fatkeqësi. Të gjithë e dinë se ç'është një fatkeqësi. Para saj të gjithë jemi të pambrojtur. Eh, pra, për mua është një fatkeqësi. Ai donte të vazhdonte, por prokurori i tha mjaft dhe se e falenderonin. Atëherë Çeleste mbeti i hutuar. Por tha se donte të fliste përsëri. I kërkuan të fliste shkurt. Ai e përsëriti që krimi im ishte një fatkeqësi. Dhe kryetari i tha:

- Po, kuptohet. Por ne jemi këtu për të gjykuar fatkeqësitë e këtij lloji. Ju faleminderit.

Me që i tha të gjitha ato që i kishte mësuar jeta dhe vullneti i tij i mirë, u kthye nga unë. Mua m'u duk se sytë i shkëlqenin dhe se buzët i dridheshin. Ai dukej sikur më pyeste se ç'mund të bënte ende. Unë nuk thashë asgjë, nuk bëra asnjë gjest, por ishte hera e parë në jetën time që pata dëshirë të përqafoja një njeri. Kryetari i tha përsëri të ulej. Çeleste shkoi të zinte vend në sallë. Gjatë tërë dëgjimit të dëshmitarëve, qëndroi atje, pak i përkulur para, me bërrylat mbi gjunjë, duke dëgjuar çdo gjë që thuhej. Hyri Maria. Kishte vënë një kapelë dhe ishte ende e bukur. Por unë e doja më shumë me flokët e lëshuara. Nga vendi ku isha, shihja peshën e lehtë të gjinjve të saj dhe buzën e saj të poshtme që rrinte gjithmonë pak e fryrë. Dukej shumë nervoze. Atë e pyetën menjëherë se që kur më njihte. Ajo tha se më njihte që në kohën kur punonte te ne. Kryetari donte të dinte si i kishte marrëdhëniet me mua. Ajo tha se ishte mikja ime. Një pyetjeje tjetër iu përgjigj se ishte e

vërtetë që donte të martohej me mua. Prokurori që po shfletonte një dosje e pyeti papritmas se që kur datonte lidhja jonë. Ajo tregoi datën. Prokurori vuri në dukje me një pamje mospërfillëse se atij i dukej sikur ajo datë binte të nesërmen e vdekjes së mamasë. Pastaj tha me një farë ironie se nuk donte të këmbëngulte në hollësitë e një rrethane aq delikate, se e kuptonte mirë turpin e Marisë, por (këtu theksi i tij u bë më i ashpër) detyra e tij e urdhëronte të ngrihej mbi mirësjelljen. Ai e pyeti pra Marinë të përmblidhte ditën kur e kisha njohur. Maria nuk donte të fliste, por para këmbënguljes së prokurorit, tregoi si u lamë në det, si shkuam në kinema dhe si u kthyem pastaj në shtëpinë time. Prokurori tha se i nxitur nga ato që Maria kishte pohuar në hetusi, kishte parë programet e asaj date. Ai shtoi se vetë Maria do të thoshte ç'film shfaqej atë natë. Me një zë gati të shuar, ajo tregoi se ishte një film me Fernandelin. Kur ajo mbaroi në sallë mbretëroi një heshtje e thellë. Atëherë u çua prokurori, tepër hijerëndë dhe me një zë që mua m'u duk me të vërtetë i prekur, me gishtin zgjatur nga unë, tha ngadalë:

Zotërinj të trupit gjykues, të nesërmen e vdekjes së nënës së tij, ky njeri lahej në det në shoqërinë e një gruaje, u lidh me të dhe u gajas së qeshuri në një film komik. Nuk kam çfarë t'ju them më shumë. - Ai ul, përherë në heshtje. Por, papritmas, Maria shpërtheu në ngashërim, tha se nuk ishte ashtu, se e kishin detyruar me zor të thoshte të kundërtën e asaj që mendonte, se më njihte mirë dhe se nuk kisha

bërë asgjë të keqe. Por ftuesi, me shenjën që i bëri kryetari, e largoi atë dhe seanca vazhdoi.

Pas Marisë dëshmoi Masoni, të cilin mezi e dëgjuan. Ai deklaroi se isha një njëri i ndershëm "madje do të thosha një burrë shumë i mirë". Edhe plakun Salamano mezi e dëgjuan, kur kujtoi se më kishte ardhur keq për qenin e tij dhe kur iu përgjigj një pyetjeje mbi nënën time dhe mbi mua duke thënë se nuk kisha ç't'i thosha më mamasë dhe për këtë arsye e kisha çuar në azil.

-Duhet kuptuar, - thoshte Salamanoja, - duhet kuptuar.
Por askush nuk dukej të kuptonte. Edhe Salamanon e larguan.

Pastaj erdhi rradha e Rajmondit, që ishte dëshmitari i fundit. Rajmondi më bëri një shenjë të vogël dhe tha menjëherë se isha i pafajshëm. Por kryetari tha se nuk i kishin kërkuar të jepte vlerësime, por të dhëna. Atë e ftuan të priste pyetjet për t'u përgjigjur. Atij i thanë të saktësonte marrëdhëniet që kishte me viktimën. Rajmondi përfitoi nga kjo për të thënë se viktima e urrente që kur ai i kishte goditur me pëllëmbë të motrën. Kryetari e pyeti nëse viktima kishte arsye përse të më urrente. Rajmondi tha se prania ime në plazh ishte vetëm një rastësi. Atëherë prokurori e pyeti se si shpjegohej që letra që ishte në zanafillë të dramës ishte shkruar nga unë.

Rajmondi u përgjigj se edhe kjo ishte thjesht një rastësi. Prokurori ia ktheu se rastësia kishte kryer shumë krime në vetëdijën e historisë. Ai donte të

dinte mos vallë rastësisht nuk kisha ndërhyrë kur Rajmondi kishte goditur me pëllëmbë të dashurën e tij, mos vallë rastësisht kisha shërbyer si dëshmitar në komisariat, mos vallë, përsëri, rastësisht deklaratat e mia gjatë dëshmisë ishin bërë vetëm për të mos prishur qejf. Për ta mbyllur, prokurori pyeti Rajmondin se me çfarë jetonte dhe kur ky i fundit u përgjigj: "Magazinier", iu drejtua trupit gjykues, se dihej nga të gjithë se dëshmitari ushtronte profesionin e kodoshit. Unë isha bashkëfajtor dhe mik me të. Trupi gjykues kishte të bënte me një dramë të ndyrë, nga më të fëlliqurat, që rëndohej edhe më shumë se në të ishte përzjerë një përbindësh në marrëdhëniet morale. Rajmondi donte të mbrohej dhe avokati im kundërshtoi, por të dyve u thanë të linin prokurorin të mbaronte fjalën.

- Nuk kam shumë gjëra për të shtuar, - tha ai. - A ishte miku yt? - pyeti Rajmondin.

- Po, - u përgjigj Rajmondi, - ishte shoku im.

Atëherë prokurori më bëri të njëjtën pyetje edhe mua dhe unë vështrova Rajmondin që nuk i largoi sytë. U përgjigja:

- Po.

Atëherë prokurori u kthye nga trupi gjykues dhe tha:

- I njëjti njeri, i cili një ditë pas vdekjes së nënës, lëshohej në shthurjen më të turpshme, vret për arsye të kota, duke dashur të shlyente llogaritë me viktimën për një çështje të fëlliqur, të poshtër.

Pas këtyre fjalëve prokurori u ul. Por avokati im, që e kishte humbur durimin, bërtiti duke ngritur duart në mënyrë të tillë, sa mëngët, duke rënë, zbuluan palët e një këmishe të kollarisur:

Dua të di, klienti im akuzohet se ka varrosur

nënën e tij apo se ka vrarë një njeri?

Njerëzit në sallë qeshën. Por prokurori u çua përsëri, rregulloi togën dhe tha se duhet të kesh padjallëzinë e avokatit të nderuar për të mos parë se midis atyre dy fakteve kishte një lidhje të thellë, patetike, thelbësore.

- Po, - bërtiti me forcë, - unë e akuzoj këtë njeri se varrosi nënën e tij, duke patur një zemër krimineli.

Kjo deklaratë bëri shumë përshtypje te njerëzit e sallës. Avokati ngriti supet dhe fshiu djersën që i mbuloi ballin. Edhe vetë u ndjeva i lëkundur dhe kuptova se gjërat nuk po shkonin mirë për mua.

Seanca mbaroi. Duke dalë nga gjykata për të hipur në makinë, ndjeva për një çast të shkurtër aromën dhe ngjyrën e mbrëmjes së verës. Në errësirën e makinës së burgut, që ecte me shpejtësi, si nga honet e lodhjes, u shfaqën një nga një të gjitha zhurmat e afërta të një qyteti, që e doja dhe të një ore kur më ndodhte të ndjehesha i lumtur. Thirrjet e shitësve të gazetave në ajrin e nderë, zogjtë e fundit në kopshtin publik, britma e shitësve të sanduiçëve, rënkimi i tramvajave në kthesat e forta të qytetit dhe gjëmimi i mbytur që ushtonte diku në qiell, para se nata të lëkundej mbi port, më tregonin si

një të verbëri, rrugën e zakonshme, të cilën e njihja shumë kohë më parë se të futesha në burg. Po, ishte ora kur, shumë kohë më parë, ndjehesha i lumtur. Atëherë më priste një gjumë i lehtë dhe pa ëndrra. E megjithatë diçka kishte ndryshuar për deri sa do të prisja të nesërmen pa mbyllur sytë dhe tani po kthehesha në qelinë time të vetmuar. Sikur rrugët e njohura që shtriheshin në qiejt e verës mund të të çonin sa në makthet e burgut aq edhe në gjumin e pafajshëm.

IV

Gjithmonë është interesante, edhe kur je në bankë të të akuzuarit, të dëgjosh të flitet për ty. Mund të them se në fjalën e tyre si prokurori ashtu edhe avokati folën shumë për mua dhe, ndoshta, më shumë për mua sesa për krimin tim. Por a ndryshonte shumë akuza e prokurorit nga mbrojtja e avokatit? Avokati ngrinte duart përpjetë dhe, duke më quajtur fajtor, këmbëngulte në rrethanat lehtësuese. Prokurori shtrinte duart drejt njerëzve që ishin në sallë dhe kërcënonte fajtorin, duke mos njohur asnjë rrethanë lehtësuese. Megjithatë një gjë më shqetësonte turbull. Dhe, pavarësisht se mund të dëmtoja veten, shpesh doja të ndërhyja, por avokati më thoshte: "Hesht, është për të mirën e çështjes tënde." Dhe ndodhi që çështjen time ta trajtonin pa mua. Gjithçka u rrokullis pa ndërhyrjen time. Fati im zgjidhej pa marrë mendimin tim. Kohë pas kohe më pushtonte dëshira t'i ndërprisja të gjithë dhe të thosha: "Po kush është këtu i akuzuari? Të jesh i akuzuar nuk do të thotë se je një njeri që nuk ke asnjë vlerë. Dua të them edhe vetë fjalën time." Por duke vrarë mendjen, e shihja se nuk kisha ç'të thosha. Përveç kësaj, duhet ta pranoj se interesi që ngjallin fjalimet gjyqësore,

nuk zgjat shumë kohë. Për shembull, fjala e prokurorit më lodhi shumë shpejt. Ato që më bënë më shumë përshtypje apo zgjuan interesin tim, janë vetëm copëza, gjeste apo tirada të shkëputura nga e tëra.

Thelbi i akuzës së tij, nëse e kuptova mirë, ishte se e kisha paramenduar krimin tim. Të paktën, këtë u përpoq ta vërtetonte. Si thoshte dhe vetë ai: - Unë do t'ua vërtetoj këtë, zotërinj, me anën e provave të dyfishta. Në rradhë të parë përmes qartësisë verbuese të të dhënave dhe në rradhë të dytë nëpërmjet qartësisë së turbullt që më jep psikologjia e këtij shpirti kriminal.

Ai bëri një përmbledhje të fakteve duke filluar nga vdekja e mamasë. Përmendi pandjeshmërinë time dhe se nuk dija ç'moshë kishte mamaja ime, larjen në det të nesërmen e varrimit të saj, me një femër, kinemanë, Fernandelin dhe në fund kthimin te shtëpia ime së bashku me Marinë. Unë nuk e kuptova që në fillim se ishte fjala për të, sepse ai thoshte "dashnoria e tij", kur për mua ajo ishte Maria. Më pas kaloi te historia e Rajmondit. Vura re se mënyrës si i shihte ngjarjet nuk i mungonte qartësia. Ajo që thoshte ishte e mundur. Kisha shkruar letrën duke u marë vesh me Rajmondin për ta futur në kurth të dashurën e tij, ku e priste një zhdëpje në dru nga një njeri me "moral të dyshimtë". Unë i kisha ngacmuar në plazh kundërshtarët e Rajmondit. Ky i fundit u plagos. Unë i kërkova revolverin e tij. Isha kthyer vetëm për të vrarë arabin, ashtu siç e kisha bërë me mendje. Dhe kisha pritur. Dhe "për t'u siguruar se

puna ishte kryer mirë", kisha qëlluar përsëri katër herë mbi trupin e shtrirë për tokë - qetësisht, pa m'u dridhur dora dhe, si të thuash, të menduar mirë e bukur.

- Dhe ja, zotërinj, - tha prokurori, - unë parashtrova para jush fillin e ngjarjeve që e çuan këtë njeri të vrasë me ndërgjegje të plotë. Për këtë këmbëngul, - tha ai. - Sepse nuk bëhet fjalë për një vrasje të zakonshme, për një veprim të pamenduar mirë, që mund të përbënte një rrethanë lehtësuese. E dëgjuat edhe vetë, apo jo? Ai di të përgjigjet. Ai njeh vlerën e fjalëve. Dhe ne nuk mund të themi se veproi pa patur parasysh atë që po bënte.

Unë dëgjoja dhe kuptova se më mbanin për të zgjuar. Por nuk kuptoja mirë si cilësitë e një njeriu të zakonshëm të ktheheshin në prova të pakundërshtueshme kundër një fajtori. Të paktën, kjo më bëri shumë përshtypje dhe nuk e dëgjova më prokurorin deri në çastin kur më kapi veshi të thoshte:

-A shprehu ndonjëherë qoftë edhe keqardhjen më të vogël? Kurrë, zotërinj. Ky njeri, gjatë hetimit, nuk u duk asnjëherë i prekur për krimin e tij të neveritshëm. - Atë çast u kthye nga unë dhe më tregoi me gisht duke vazhduar të më dërrmojë, pa e kuptuar dhe aq mirë përse tregohej aq i pamëshirshëm me mua. Kuptohet, nuk mund të mos pranoj se kishte të drejtë. Nuk më vinte dhe aq keq për veprimin tim. Por më habiste tërë ajo egërsi e prokurorit. Do të doja të përpiqesha t'ia shpjegoja përzemërsisht, pothuaj miqësisht, se nuk isha penduar kurrë me të vërtetë për diçka. Mua gjithmonë më kishte

përthithur ajo që do të ndodhte sot apo nesër. Por natyrisht, në gjendjen ku më kishin vënë, nuk mund t'i flisja askujt me këtë ton. Nuk kisha të drejtë të shfaqja përzemërsi dhe dashamirësi. Dhe u përpoqa të dëgjoja përsëri sepse prokurori kishte nisur të fliste për shpirtin tim.

Ai thoshte se ishte përkulur mbi të dhe nuk kishte gjetur asgjë, zotërinj të trupit gjykues. Ai thoshte se në të vërtetë, nuk kisha aspak shpirt dhe asgjë njerëzore, se asnjë nga parimet morale që ruajnë zemrën e njerëzve nuk ishte i kuptueshëm për mua.

Pa dyshim, - shtoi ai, - nuk e qortojmë dot për këtë. Nuk ankohemi dot që atij i mungon ajo që nuk ka ditur ta fitojë deri më sot. Por kur është fjala për këtë trup gjykues, virtyti i keq i shpirtgjerësisë duhet të priret drejt virtytit më të vështirë, por më të lartë, atij të drejtësisë. Sidomos kur zbrazëtia e zemrës siç zbulohet te ky njeri bëhet një hon ku mund të gremiset shoqëria.

Dhe këtu filloi të flasë për sjelljen time ndaj mamasë. Ai përsëriti ato që kishte thënë në fillim. Por u zgjat më shumë sesa kur foli për krimin tim, madje foli aq gjatë sa, në fund, ndjeva vetëm vapën e atij mëngjesi. Të paktën, deri në çastin kur prokurori u ndal dhe, pas një çasti heshtjeje, ia nisi përsëri me një zë shumë të qetë dhe shumë depërtues:

-Zotërinj, po ky gjyq, do të gjykojë nesër një nga krimet më të tmerrme: vrasjen e babait.

Sipas tij, përfytyrimi ynë prapsej para atij

krimi mizor. Ai guxonte të shpresonte se drejtësia e njerëzve do të ndëshkonte pa iu dridhur dora. Por, nuk trembej ta thoshte, lemeria që i ngjallte ai krim nuk qëndronte më poshtë se lemeria që ndjente para pandjeshmërisë sime. Sipas tij, një njeri që vret moralisht nënën e tij e përjashtonte vetë veten nga shoqëria e njerëzve, njëlloj si ai që ngriti dorën vrastare mbi babanë, që i dha jetën. Në të gjitha rastet, i pari përgatiste veprimet e të dytit, ai në një farë mënyre i lajmëronte dhe i ligjësonte ato.

Për këtë jam i bindur, zotërinj, - shtoi ai duke ngritur zërin, - se mendimi im nuk do t'iu duket shumë i guximshëm, sikur të them se njeriu që është ulur në bankën e të akuzuarit është gjithashtu fajtor për vrasjen që ky trup gjykues do të gjykojë nesër. Ai duhet të marrë ndëshkimin që meriton. Prokurori, me të thënë këto fjalë, fshiu fytyrën që i shkëlqente nga djersa. Në fund tha se detyra e tij ishte e dhimbshme, por ai do ta kryente me vendosmëri. Ai deklaroi se unë nuk kisha të bëja aspak me një shoqëri, rregullat më thelbësore të së cilës nuk i njihja dhe se nuk mund të ngjallja asnjë mëshirë, nga që më ishin shuar të gjitha ndjenjat njerëzore. -Unë ju kërkoj kokën e këtij njeriu, - tha ai, - dhe këtë kërkesë ua bëj me zemër të lehtësuar. Sepse, nëse më ka ndodhur që gjatë karrierës sime të gjatë të kërkoj dënime me vdekje, kurrë më shumë se sot, nuk e kam ndjerë detyrën time të mundimshme të shpërblehet, të përforcohet, të ndriçohet nga vetëdija e një urdhri të prerë dhe të shenjtë dhe nga fytyra

e njeriut ku lexoj vetëm llahtari.

Kur Prokurori u ul, ra një heshtje mjaft e gjatë. Unë isha trullosur nga vapa dhe habia. Kryetari u kollit dhe me një zë shumë të ulët, më kërkoi nëse kisha për të shtuar ndonjë gjë. U çova dhe meqë kisha dëshirë të flisja, thashë, atë që më erdhi në fillim në mendje, se nuk kisha qëllim të vrisja arabin. Kryetari tha se ky ishte një pohim dhe se deri atëherë nuk po e kuptonte sistemin tim të mbrojtjes dhe se do të ishte i lumtur, para se të dëgjonte avokatin tim, të saktësoja shkaqet që kishin frymëzuar veprimin tim. Thashë shpejt e shpejt, duke ngatërruar pak fjalët dhe duke ndjerë se po bëhesha qesharak, se gjithçka ndodhi për shkak të diellit. Në sallë u dëgjuan të qeshura. Avokati im ngriti supet dhe, pas kësaj, ia dhanë menjëherë fjalën. Por ai tha se ishte vonë, se fjala e tij do të zinte disa orë, prandaj kërkonte që të fliste mbasdite. Trupi gjykues e mori parasysh kërkesën e tij.

Mbasdite, ventilatorët e mëdhenj përzjenin vazhdimisht ajrin e dendur të sallës dhe freskoret shumëngjyrëshe të trupit gjykues lëviznin të gjitha në të njëjtin drejtim. Fjala mbrojtëse e avokatit tim m'u duk sikur nuk do të mbaronte kurrë. Megjithatë, në një çast, mbajta vesh sepse po thoshte: "Se ishte e vërtetë që unë kisha vrarë." Pastaj vazhdoi me këtë ton, duke thënë "une" sa herë që fliste për mua. Shtanga nga habia. U përkula drejt një xhandari dhe e pyeta përse fliste në atë mënyrë avokati. Ai më tha ë heshtja dhe, pas pak, shtoi: "Kështu bëjnë të gjithë

avokatët." Për vete mendova se kjo më largonte përsëri nga çështja, më kthente në zero dhe, në një farë kuptimi, më zëvendësonte mua. M'u duk sikur tashmë isha shumë larg nga ajo sallë gjyqi. Veç të tjerash, avokati im m'u duk qesharak. Ai i kaloi shpejt e shpejt shkaqet që më çuan në kryerjen e vrasjes dhe pastaj filloi të flasë edhe ai për shpirtin tim. Por m'u duk më pak i talentuar se prokurori.

- Edhe unë u përkula mbi këtë shpirt, - tha ai, - por në kundërshtim me përfaqësuesin e nderuar të prokurorisë, gjeta diçka dhe mund të them se lexova tek ai si në një libër të hapur.

Ai kishte lexuar aty se isha një njeri i ndershëm, një punëtor i rregullt, i palodhur, besnik i shoqërisë që më kishte marrë në punë, i dashur nga të gjithë dhe zemërdhembshur për mjerimet e tjetrit. Për të, unë isha një bir model që e kisha mbajtur nënën aq gjatë sa kisha mundur. Në fund kisha shpresuar se një azil do t'i jepte gruas së moshuar rehatinë që mundësitë e mia nuk më lejonin t'ia siguroja.

- Habitem, zotërinj, shtoi ai, - që u bë tërë ajo zhurmë e madhe rreth azilit. Sepse në fund të fundit, nëse duhet provuar dobia dhe domethënin e lartë e këtyre institucioneve, mjafton të thuash se ato është vetë shteti që i mban.

Por ai nuk foli për varrimin dhe unë e ndjeva se kjo mungesë krijonte një zbrazëti në fjalën e tij mbrojtëse. Por për shkak të gjithë atyre fjalive të gjata, të gjithë atyre ditëve dhe atyre orëve të pambaruara, gjatë të cilave u fol për shpirtin tim, pata

përshtypjen se çdo gjë po bëhej si një ujë i pangjyrë ku më merreshin mendtë.

Në fund, më kujtohet se ndërsa avokati im fliste, nga rruga, duke përshkruar gjithë sallën, ushtoj deri tek unë boria e një shitësi akulloresh. Mua më kishin mbuluar kujtimet e një jete që nuk më përkiste më, por që më kishte falur gëzimet më të thjeshta por dhe më të paharrrueshmet: aromat e verës, lagjen që doja, ngjyrat e qiellit të mbrëmjes, të qeshurën dhe fustanin e Marisë. Gjithçka që po ndodhte në atë sallë m'u duk e pakuptimtë, po më merrte frymën dhe doja vetëm një gjë, t'i jepnin fund sa më parë atij gjyqi, të kthehesha në qelinë time dhe të flija. Mezi dëgjova avokatin tim të bërtiste, për të mbyllur fjalën e tij mbrojtëse, se trupi gjykues, sigurisht, nuk do të donte të çonte drejt vdekjes një punëtor të ndershëm, që e humbi toruan në një çast hutimi dhe kërkonte rrethana lehtësuese për një krim, për të cilin mbaja dhe do të mbaja për tërë jetën në shpinë, si ndëshkimin më të sigurtë, vrasjen e përjetëshme të ndërgjegjes. Trupi gjykues ndërpreu dëgjimin dhe avokati u ul me një pamje të rraskapitur. Kolegët shkuan drejt tij për t'i shtrënguar dorën. Dëgjova: "Shkëlqyeshëm, i dashur." Njëri prej tyre donte të më bënte edhe mua dëshmitar: "Apo jo?, më tha. Pohova me kokë, por pëlqimi im nuk ishte i çiltër, sepse isha shumë i lodhur.

Megjithatë, jashtë po thyhej dita dhe të nxehtit ishte më pak i fortë. Nga disa zhurma të rrugës që më kapi veshi, e mora me mend ëmbëlsinë e muzgut.

Të gjithë rrinim, prisnim. Dhe ajo që prisnim së bashku këtu lidhej vetëm me mua. Vështrova përsëri sallën. Çdo gjë ishte si kishte qenë ditën e parë. Hasa vështrimin e gazetarit me xhaketë të hirtë dhe të gruas automat. Kjo më bëri të mendoj se nuk kisha kërkuar me sy Marinë gjatë tërë proçesit. Nuk e kisha harruar, por kisha tërë ato gjëra që më shqetësonin. E pashë midis Çelestes dhe Rajmondit. Ajo më bëri një shenjë të vogël si të më thoshte: "Më në fund", dhe pashë fytyrën e saj pak të angështuar që buzëqeshte. Por zemrën e kisha të ngrirë dhe nuk munda t'i përgjigjesha buzëqeshjes së saj.

Trupi gjykues u kthye në sallë. Anëtarëve të trupit gjykues iu lexuan një varg pyetjesh. Dëgjova "fajtor për vrasje"... "paramendim"... "rrethana lehtësuese". Trupi gjykues doli përsëri dhe mua më çuan në kthinën e vogël ku kisha pritur ditën e parë. Erdhi dhe më takoi avokati: nuk i mbyllej goja dhe më foli me shumë besim dhe përzemërsi, si nuk më kishte folur kurrë. Ai mendonte se çdo gjë do të shkonte mirë dhe se do ta hidhja me disa vite burg ose punë të detyruar. Pyeta në kishte mundësi të anullonim vendimin, në qoftë se ky nuk ishte në favorin tonë. Ai u përgjigj që jo. Ai kishte ndjekur një taktikë të tillë që, duke mos bërë konkluzione, të mos acarohej me trupin gjykues. Pastaj më shpjegoi se një vendim mund të anullohej vetëm po të kishe arsye të plota për ta kërkuar atë. Kjo m'u duk më se e drejtë dhe isha në një mendje me të. Po ta shihje çështjen me gjakftohtësi, kjo ishte krejt e natyrshme.

Në të kundërtën do të ndesheshe kot me një mal me shkresurina të padobishme.

- Sidoqoftë, më tha avokati, - mund të bëjmë një kërkesë për falje. Por jam i bindur se rrugëzigjdhja do të jetë e favorshme.

Pritëm shumë gjatë, më duket, rreth treçerek ore. Më në fund ushtoi një zile. Avokati u largua prej meje duke më thënë:

- Kryetari i trupit gjykues do të lexojë përgjigjet. Juve do t'ju futin brenda vetëm për t'iu vënë në dijeni të vendimit.

Kërcitën dyer. Nëpër shkallë vraponin njerëz, nuk e dija ku: afër apo larg. Pastaj dëgjova një zë të mbytur të lexonte diçka në sallë. Kur zilja ushtoi përsëri, kur u hap dera e vendit të të pandehurit, drejt meje u ngrit heshtja e sallës, heshtja dhe ajo ndjesi e veçantë që pata, kur pashë se gazetari i ri largoi vështrimin, duke e hedhur diku, kuturu. Nuk vështrova nga ana e Marisë. Nuk pata kohë për këtë sepse kryetari më tha me një formë të çuditshme se do të më pritej koka në një shesh publik në emër të popullit francez. Dhe atëherë në të gjitha fytyrat lexova të njëjtën ndjenjë. Xhandarët u treguan shumë të butë me mua. Avokati vuri pëllëmbën mbi kyçin tim të dorës. Nuk mendova më për asgjë. Por kryetari më pyeti nëse kisha për të shtuar ndonjë gjë. U mendova. Thashë:"Jo." Dhe atëherë më morën.

Alber Kamy-I huaji

Ishte hera e tretë që nuk pranoja të prisja priftin. Nuk kam ç't'i them, nuk kam dëshirë të flas me të, bashkë do takoheshim shumë shpejt. Ajo që më interesonte në ato çaste ishte si t'i shpëtoja rrjedhjes mekanike të ngjarjeve, të mësoja nëse kishte ndonjë rrugëdalje nga e pashmangshmja. Më ndërruan qelinë. Nga qelia e tanishme, kur jam shtrirë, shoh qiellin, qiellin dhe vetëm atë. Të gjitha ditët kalojnë duke vështruar në fytyrën e tij thyerjen e ngjyrave, kur dita ia lë vendin natës. Shtrihem, vë kokën mbi duart dhe pres. Kushedi sa herë kam vrarë mendjen për të gjetur në ka shembuj kur të dënuarit me vdekje i kanë shpëtuar mekanizmit të pamëshirshëm, janë zhdukur para ekzekutimit, duke çarë kordonin e policëve. Dhe qortoja veten që nuk u kisha kushtuar vëmendje tregimeve për ekzekutimin e të dënuarve me vdekje. Njeriu duhet të interesohet gjithmonë për këto çështje. Nuk dihet kurrë ç'mund të të ndodhë. Si të gjithë edhe unë kisha lexuar kronika nëpër gazeta. Por me siguri që për to duhej të kishte vepra të veçanta, të cilat nuk i kisha lexuar. Ndoshta atje do të gjeja tregime për arratisjet. Të paktën do të mësoja se rrota ishte ndalur, se në

këtë paramendim të papërmbajtshëm, rastësia dhe fati kishin ndryshuar diçka, qoftë edhe vetëm një herë. Një herë! Në një kuptim, kaq do të më kishte mjaftuar. Zemra do të kryente pjesën tjetër. Gazetat shkruanin shpesh për borxhin e kriminelëve ndaj shoqërisë. Sipas tyre ai duhej paguar. Por kjo nuk i fliste përfytyrimit. Ajo që kishte rëndësi. ishte mundësia e arratisjes, një kapërcim nga riti i pamëshirshëm, një vrapim i çmendur që të jepte të gjitha mundësitë për të shpresuar. Natyrisht, shpresa qe vrasja në qoshe të ndonjë rruge, në kulmin e vrapit, nga ndonjë plumb i marrë fluturimthi. Por duke e shoshitur mbarë e prapë gjendjen time, asgjë nuk ma jepte këtë luks, mekanizmi i ndëshkimit nuk më lëshonte nga dhëmbët e tij.

Me gjithë dëshirën time, nuk e pranoja dot këtë të vërtetë lakuriqe. Sepse në fund të fundit, kishte një mospërputhje qesharake midis vendimit që e mbështeste atë dhe zhvillimit të qetë, nga çasti kur ky vendim u dha. Fakti që vendimi u lexua në orën njëzet në vend që të lexohej në orën shtatëmbëdhjetë, fakti që ai mund të ishte krejt tjetër, fakti se ishte marrë nga njerëz të një rangu të caktuar, që e përzjenë atë me një nocion krejt të papërcaktuar si nocioni populli francez (ose gjerman, ose kinez), për mendimi tim, të gjitha këto i hiqnin në një masë të madhe seriozitetin e domosdoshëm atij vendimi. Megjithatë, isha i detyruar ta pranoja se nga sekonda kur u mor, pasojat e tij bëheshin aq të sigurta, aq serioze, sa prania e murit pas të cilit ngjishesha i

gjithi.Në ato çaste m'u kujtua shpesh historia që me tregonte mamaja lidhur me babanë. Unë nuk e kisha njohur babanë. Gjtihçka që njihja me saktësi nga ai njeri, ishte ndoshta ajo që më thoshte në atë kohë mamaja: ai kishte shkuar të shihte pushkatimin e një vrasësi. Vetëm mendimi se do të shkonte atje, e sëmurte keqas. Megjithatë shkoi dhe kur u kthye volli gjithë mëngjesin. Babai m'u neverit, kur e dëgjova këtë histori. Kurse tani e kuptoj fare mirë se ishte krejt e natyrshme që ai të villte. Si nuk më kishte rënë në sy se nuk ka asgjë më të rëndësishme se një dënim me vdekje dhe se, në fund të fundit, ajo ishte e vetmja gjë me të vërtetë interesante për një njeri! Në qoftë se do të dal ndonjëherë nga ky burg, do të shkoj t'i shoh të gjitha ekzekutimet me vdekje. Mua më duket se e kisha gabim që i ushqeja vetes këtë mundësi. Sepse mendimi për ta parë veten të lirë një agim prapa kordonit të policëve, si të thuash në anën tjetër, mendimi për të qenë shikues që shkon për të parë dhe që më pas do të vjellë, ma mbushte zemrën me një valë gëzimi të helmuar. Kjo ishte diçka krejt e paarsyeshme. Nuk duhej ta lëshoja veten të zhytej në hamendje të tilla sepse, menjëherë do të kisha tmerrësisht ftohtë, sa do të mblidhesha grusht nën batanije. Dhëmbët më kërcisnin dhe unë nuk e kisha veten në dorë.

Por, natyrisht, nuk mund të jesh gjithmonë i arsyeshëm. Herët e tjera, për shembull, bëja projekligje. Rishihja dënimet. Kisha vënë re se thelbësore ishte t'i jepje një mundësi të dënuarit. Një

në njëmijë, kjo mjaftonte për t'i rregulluar ashtu si duhej gjërat. Kështu, mua më dukej se mund të gjendej një përzjerje kimike, që kur të thithej do të vriste pacientin (unë mendoja: pacientin) nëntë në dhjetë raste. Pacienti do ta dinte këtë (ky do ishte kusht). Sepse duke vrarë mendjen, duke i parë gjërat me qetësi, arrita në përfundimin se gijotina nuk të jepte asnjë mundësi, as edhe një të vetme. Vdekja e pacientit ishte vendosur njëherë e përgjithmonë. Ajo ishte një çështje e mbyllur, një marrëveshje e përfunduar dhe as që mund të bëhej fjalë për t'iu kthyer përsëri. Në qoftë se gijotina ngecte, që ishte diçka e jashtëzakonshme, goditja përsëritej. Për pasojë, ajo që ishte dhe më e mërzitshme, ishte se i dënuari dëshironte me gjithë shpirt që gijotina të mos ngecte gjëkundi. Kjo është, them unë, e meta e sistemit të dënimit me vdekje. Në një kuptim kjo është e vërtetë, por në një kuptim tjetër, isha i detyruar të pranoja se aty qëndronte dhe e gjithë e fshehta e një organizimi të mirë. Me një fjalë, i dënuari ishte i detyruar të bashkëpunonte moralisht. Ishte në interesin e tij që çdo gjë të rridhte pa asnjë pengesë.

Unë isha gjithashtu i detyruar të vëreja se deri këtu kisha për këto çështje mendime që nuk ishin të drejta. Unë besova për një kohë të gjatë - nuk e di përse - se për të shkuar në gijotinë, duhej të ngjitje shkallare për të hipur në podium. Me siguri që këtë e kisha nga Revolucioni i 1789, dua të them nga gjithçka më kishin mësuar ose më kishin treguar nëpër tablo

lidhur me këto çështje. Por një mëngjes, u kujtova për një fotografi të botuar nga gazetat me rastin e një ekzekutimi të bujshëm. Në të vërtetë, gijotina ishte ngritur drejt e mbi tokë, në mënyrën më të thjeshtë. Ajo ishte shumë më e ngushtë sesa e mendoja. Është e habitshme se si nuk u kujtova për këtë më parë. Gijotina në fotografi më kishte bërë përshtypje se i ngjante në mënyrë të përsosur, një vegle të saktë dhe të shndritshme. Ne kemi gjithmonë përfytyrime të tepruara për ato gjëra që nuk i njohim. Ndërsa në rastin e gijotinës pashë se, përkundrazi, çdo gjë ishte fare e thjeshtë: ajo ishte në të njëjtin rrafsh me njeriun që ecte drejt saj. Ai po i afrohej asaj ashtu si ecim kur duam të takojmë një njeri. Edhe kjo ishte diçka e mërzitshme. Ngjitja në podium, ngritja lart në qiell, e ngacmojnë dhe e bëjnë përfytyrimin tonë të mbërthehet fort pas tyre. Ndërsa aty çdo gjë shtypej nga mekanika: të dënuarit i presin kokën mbytazi, turpshëm, por me përpikmërinë më të madhe.

Gjatë tërë kohës mendoja edhe për dy gjëra të tjera: për agimin dhe përçapjen time për falje. Megjithatë përpiqesha të mblidhja veten dhe të mos mendoja më për to. Shtrihesha, vështroja qiellin, mundohesha të përqëndrohesha i gjithi tek ai. Kur bëhej i gjelbër, ishte mbrëmje. Bëja edhe një përpjekje tjetër për të kthyer rrjedhën e mendimeve të mia. Dëgjoja zemrën. Nuk e përfytyroja dot se ajo zhurmë që më shoqëronte prej aq shumë kohësh, mund të rreshte një ditë. Asnjëherë nuk kam patur një përfytyrim të shfrenuar. Megjithatë përpiqesha

të përfytyroja çastin kur rrahjet e zemrës nuk do të jehonin më në kokën time. Por ishte e kotë. Unë nuk mund të largoja nga mendja agimin dhe kërkesën time për falje. Dhe në fund arrija dhe thosha se gjëja më e arsyeshme qe të mos e detyroja me zor veten.

Unë e dija - ata vinin në agim. Në përgjithësi, netët i mbushja duke pritur këtë agim. Asnjëherë nuk kisha dashur të më kapnin në befasi. Mua më pëlqen të gjendem i gatshëm, kur më ndodh diçka. Për këtë fillova të mos vë gjumë në sy, me përjashtim të ndonjë dremitjeje të vogël gjatë ditës, për tërë natën e natës, duke pritur me durim të regëtinte drita te qelqi i dritares, nën qiellin e pamatë. Çasti më i vështirë ishte ora e dyshimtë kur zakonisht "ata" shfaqeshin. Unë përgjoja, me të kaluar mesnata. Asnjëherë më parë veshi im nuk kishte kapur tërë ato zhurma, nuk kishte dalluar tërë ata tinguj të dyshimtë. Veç kësaj, mund të them, se në një farë mënyre, gjatë tërë kësaj kohe pata fat, sepse nuk dëgjova asnjëherë hapa. Mamaja thoshte shpesh se kurrë nuk jemi tërësisht fatkeqë. Mendimin e saj e miratoja tani, në burg, kur agimi përskuqte qiellin dhe një ditë e re rrëshqiste në qelinë time. Sepse në atë çast mund të dëgjoja hapa dhe zemra të më plaste. Me të dëgjuar edhe zhurmën më të vogël hidhesha menjëherë drejt derës, ngjishja veshin pas saj dhe prisja i përhumbur, deri kur dëgjoja i tmerruar frymëmarrjen time, që më dukej e ngjirur si grahma e një qeni, por në fund të fundit, zemra nuk plaste

dhe unë kisha fituar përsëri njëzet e katër orë.

Ditën nuk më shqitej mendimi për faljen time. Mua më duket se këtë mendim e shfrytëzova më së miri. Llogarisja sa më bindshëm përçapjen time dhe nxirrja përfundimet më të mira. Nisesha përherë nga hamendja më e keqe: lutja ime nuk merrej parasysh. "Nuk ke ç'të bësh, do të vdes." Ishte e qartë se do të vdisja para të tjerëve. Por të gjithë e dinë se jeta nuk ia vlen mundimin të jetohet. Në thelb, e dija se të vdisje në moshën tridhjetë vjeçare apo gjashtëdhjetë vjeçare, kishte shumë pak rëndësi, për deri sa në të dyja rastet, burra të tjerë dhe gra të tjera do të jetonin për mijëra e mijëra vjet. Në fund të fundit, nuk kishte gjë më të qartë se kjo. Ai që do të vdiste isha përherë unë, si të vdisja tani si të vdisja pas njëzet vjetësh. Por për habinë time, mua më pushtonte një hov gëzimi kur mendoja se mund të jetoja edhe njëzet vjet të tjera. Por duhej ta mbysja këtë hov duke përfytyruar se ç'mendime do të më pushtonin pas njëzet vjetësh kur, doja apo nuk doja, përsëri do të vdisja. Është e qartë se nga çasti kur vdesim, nuk ka rëndësi si dhe kur vdesim. Pra (më e vështira ishte të mos humbje nga sytë gjithçka përfaqësonte për arsyetimet kjo "pra"), pra, duhej të pranoja hedhjen poshtë të kërkesës sime për falje.

Këtë çast, vetëm këtë çast, kisha si të thuash të drejtë, t'i jepja në një farë mënyrë lejë vetes për të parë nga afër hipotezën e dytë: sikur mua më kishin falur. Mërzia më e madhe qe zelli që duhej të tregoja për të fashitur vrullin e gjakut dhe të trupit nga

gëzim i pakuptimtë. Duhej të tregohesha sa më i zellshëm, sa më i arsyeshëm në shuarjen e kësaj britme. Duhej që të isha sa më i natyrshëm edhe në këtë hipotezë, që ta pranoja me përulje hipotezën e parë. Kur ia dilja mbanë, fitoja një orë qetësie.

Sidoqoftë për vete dilja i fituar.

Pikërisht në një çast si ky nuk pranova përsëri të prisja priftin. Rrija shtrirë dhe merrja me mend afrimin e mbrëmjes së verës përmes zbehjes së qiellit. Sapo kisha hedhur poshtë lutjen time për falje dhe mund të ndjeja valët e gjakut tim të qarkullonin normalisht brenda meje. Nuk kisha nevojë të takoja priftin e burgut. Për herë të parë, pas shumë kohësh, mendova për Marinë. Kishin kaluar tërë ato ditë dhe ajo nuk më kishte shkruar. Atë mbrëmje, mendova dhe thashë me vete se ndoshta ajo ishte lodhur duke qenë e dashura e një të dënuari me vdekje. Po ashtu mendja më shkoi se mund të ishte e sëmurë ose të kishte vdekur. Kjo ishte brenda rregullit të gjërave. Si do ta dija tani që dy trupat tanë ishin të ndarë dhe kur asgjë nuk nuk na lidhte dhe nuk na tërhiqte drejt njëri-tjetrit. Kujtimi i Marisë, duke filluar nga ky çast, u bë për mua mospërfillës. E vdekur, nuk më interesonte më. Kjo gjë më dukej krejt normale ashtu siç e kuptoja shumë mirë se njerëzit do të më harronin pas vdekjes. Ç'u duhesha atyre i vdekur? Por mund të them se një mendim i tillë ishte mjaft i hidhur për mua.

Prifti hyri pikërisht kur po bluaja në mendje këto mendime. Kur e pashë, u drodha lehtë. Ai e vuri

re dhe më tha të mos kisha frikë. I thashë se zakonisht ai vinte në një orë tjetër. Ai m'u përgjigj se ajo ishte një vizitë miqësore që nuk kishte asnjë lidhje me lutjen time për falje, për të cilën nuk dinte asgjë. U ul në shtratin tim dhe më ftoi të rrija pranë tij. Nuk pranova. Megjithatë pamja e tij m'u duk shumë e ëmbël.

Ai qëndroi një çast ulur, me parakrahët mbi gjunjë, kokën ulur, duke vështruar duart e tij. Ato ishin të holla dhe tërë muskuj dhe sapo i pashë m'u duken si dy kafshë të shkathta. Ai i fërkoi ngadalë njëra me tjetrën. Pastaj qëndroi aq gjatë me kokën ulur sa për një çast m'u duk sikur e harrova.

Por ai ngriti përnjëherësh kokën dhe më vështroi në sy:

- Përse, - më tha, - nuk i keni pranuar vizitat e mia?

Iu përgjigja se nuk besoja te Zoti. Ai donte të dinte në isha i sigurtë për këtë dhe unë thashë se nuk e kisha pyetur ndonjëherë veten për këtë: më dukej një pyetje e kotë. Atëherë shtyu trupin prapa, u mbështet te muri, duart i shtriu mbi kofshë dhe, me një pamje sikur nuk më drejtohej mua, vuri në dukje se nganjëherë njërëzit e mbajnë veten se nuk besojnë te Zoti, kur në të vërtetë nuk është kështu. Nuk thashë asnjë fjalë. Ai më vështroi dhe më pyeti:

Si mendoni ju?

Iu përgjigja se kishte mundësi të ishte ashtu si thoshte ai. Sidoqoftë, ndoshta nuk isha i sigurtë për atë që më interesonte me të vërtetë, por isha

tërësisht i sigurtë për atë që nuk më interesonte. Ai largoi sytë nga unë dhe pa ndryshuar qëndrimin më pyeti nëse flisja ashtu nga dëshpërimi i madh që më kishte pushtuar. I shpjegova se nuk isha i dëshpëruar. Kisha vetëm frikë dhe kjo ishte krejt e natyrshme.

Atëherë Zoti do t'ju ndihmojë, - vuri në dukje. – Të gjithë ata që kam njohur si në rastin tuaj e kthyen fytyrën drejt tij.

I thashë se kjo ishte e drejta e tyre. Kjo provonte gjithashtu se kishin kohë për këtë. Sa më takonte mua, nuk doja që të më ndihmonin dhe se pikërisht nuk kisha aspak kohë të interesohesha për atë që nuk më interesonte.

Atë çast duart iu drodhën nga acarimi, por ai drejtoi trupin dhe rregulloi një palë të petkut të tij. Kur mbaroi së rregulluari, m'u drejtua duke më thirrur 'miku im": ai nuk më fliste kështu sepse isha dënuar me vdekje; për mendimin e tij ne të gjithë ishim të dënuar me vdekje. Por e ndërpreva duke i thënë se nuk ishte e njëjta gjë dhe se, veç të tjerash, në asnjë rast kjo nuk përbënte një ngushëllim.

Sigurisht, - miratoi ai, - Ju mund të vdisni më vonë në qoftë se nuk vdisni tani. Por edhe atëherë do të shtrohej e njëjta pyetje. Si do ta përballoni këtë provë të tmerrshme?

I thashë se do ta përballoja pikërisht si po e përballoja atë çast. Me të dëgjuar këto fjalë u çua dhe më vështroi drejt e në sy. Ishte një lojë që e njihja mirë. Zbavitesha shpesh me Emanuelin apo Çelesten

dhe, në përgjithësi, ishin ata që ulnin të parët sytë. Edhe prifti i burgut e njihte mirë atë lojë, këtë e kuptova menjëherë: atij nuk i dridhej qerpiku. Dhe zëri nuk iu drodh aspak kur më tha:

Pra nuk keni asnjë shpresë dhe jetoni me mendimin se do të vdisni i gjithi? - Po, - iu përgjigja.

Atëherë vari kokën dhe u ul përsëri. Më tha se i vinte keq për mua. Ai mendonte se një mendim i atillë ishte i papërballueshëm për një njeri. Ndjeva se kishte filluar të më mërziste. Largova vështrimin prej tij dhe shkova dhe qëndrova nën baxhë. U mbështeta me supet pas murit. Pa e ndjekur ashtu si duhej, dëgjova se po ia niste përsëri të më pyeste. Fliste me një zë të shqetësuar dhe ngulmues. E kuptova se ishte mallëngjyer dhe u vura veshin fjalëve që thoshte.

Ai më shprehu sigurinë e tij se lutja ime për falje do të pranohej, por unë mbartja peshën e një mëkati nga i cili duhej të çlirohesha. Sipas tij, drejtësia e njerëzve nuk ishte asgjë dhe drejtësia e Zotit ishte gjithçka. Unë vura në dukje se ajo që më kishte dënuar qe drejtësia e njerëzve. Por prifti më tha se gjyqi i tyre nuk më shleu mëkatin nga ndërgjegjia ime. I thashë se nuk e dija ç'ishte një mëkat. Mua vetëm më kishin vënë në dukje se isha fajtor. Unë isha fajtor dhe po e paguaja aq shtrenjt sa tani nuk kishin ç'të më kërkonin më tepër. Ai u ngrit përsëri atë çast dhe unë mendova se në atë qeli aq të ngushtë, po të doje të lëvizje, nuk kishe nga t'ia mbaje,

ose do rrije ulur ose do qëndroje më këmbë.

Unë ia kisha mbërthyer sytë dyshemesë. Ai hodhi një hap drejt meje dhe u ndal, si të mos guxonte të ecte më tej. Vështroi qiellin që dukej mes hekurave.

- Biri im, e keni gabim, - më tha, - Nga ju mund të kërkohet më shumë.

E çfarë mund të kërkohet më shumë? - Mund të kërkohet të shihni. - Të shoh, çfarë?

Prifti vështroi përreth vetes dhe u përgjigj me një zë, që befas m'u duk shumë i lodhur:

- E di, këta gurë kullojnë dhimbje. Gjithmonë i kam parë tërë ankth. Por nga thellësia e zemrës e di se edhe më mjeranët midis jush kanë parë të lartohet nga errësira e tyre një fytyrë hyjnore. Pikërisht këtë fytyrë ju kërkohet të shihni.

U trondita disi. I thashë se kisha muaj që vështroja ato mure. Ato i njihja më mirë se çdo gjë në botë. Ndoshta, njëherë e një kohë, kisha kërkuar edhe vetë aty ndonjë fytyrë. Por ajo fytyrë kishte ngjyrën e diellit dhe flakën e dëshirës: ajo ishte fytyra e Marisë. Por edhe atë isha lodhur kot duke e kërkuar. Tani, kishte marrë fund gjithçka. Por, sidoqoftë, nga pikëllimi që kullonte prej atyre gurëve, nuk ishte shfaqur asgjë.

Prifti më vështroi me një farë trishtimi. Tani ishte mbështetur i gjithi pas murit dhe drita më rridhte mbi ballë. Ai tha disa fjalë që nuk i dëgjova dhe më pyeti nëse mund të më përqafonte.

-Jo, - iu përgjigja.

Ai u kthye dhe eci drejt murit, mbi të cilin kaloi ngadalë dorën:

- Kaq shumë e doni këtë tokë? - murmuriti. Nuk iu përgjigja.

Prifti qëndroi gjatë me fytyrën nga muri. Prania e tij më rëndonte dhe më acaronte. Isha gati t'i thosha të largohej, të më linte vetëm, kur ai bërtiti papritmas, me një lloj shpërthimi, duke u kthyer nga unë:

Jo, nuk ju besoj dot. Jam i sigurtë se u ka ndodhur të dëshironi një jetë tjetër.

Iu përgjigja se ishte krejt e natyrshme të kisha dëshiruar një jetë tjetër, por tani nuk kishte asnjë rëndësi të doje të ishe i pasur, të notoje shumë shpejt apo të ishe i bukur. Të gjitha këto ëndrra ishin e njëjta gjë. Ai më ndërpreu dhe donte të dinte si e shihja jetën tjetër:

- Një jetë që më kujtonte jetën e këtushme! - dhe menjëherë shtova se nuk doja të vazhdoja më tej bisedën.

Ai donte të më fliste përsëri për Zotin, por unë eca drejt tij dhe u përpoqa t'i shpjegoj se më kishte mbetur shumë pak kohë. Nuk doja ta humbisja me Zotin. Ai u mundua të ndërroje temë duke më pyetur përse e thërrisja "zotëri" dhe jo "ati im". Kjo m'i ngriti nervat dhe iu përgjigja se ai nuk ishte babai im: ai ishte me të tjerët.

- Jo, biri im, - tha duke vënë dorën mbi supin tim. - Unë jam me ju. Por ju nuk mund ta dini sepse

keni një zemër të verbër. Do të lutem për ju.

Atëherë, nuk e di përse, diçka kërciti brenda meje. Fillova të bërtas me sa kisha në kokë dhe e shava dhe i thashë të mos lutej për mua. E kapa nga jaka e rrasos dhe derdha mbi të, mes një përzjerjeje gëzimi dhe zemërimi, tërë vrerin e zemrës sime. Ta ndjente ende veten të sigurtë në qiejt e tij? Megjithatë, asnjë nga qiejt e tij nuk vlente sa një fije floku femre. Ai nuk mund ta mbante veten për të gjallë, për deri sa jetonte si një i vdekur. Mua më dukej sikur nuk kisha asgjë në shpirt. Por isha i sigurtë për veten, i sigurtë për çdo gjë, më i sigurtë se ai, i sigurtë për jetën time dhe për vdekjen që më priste. Po, vetëm këtë siguri kisha. Por të paktën e mbështesja këtë të vërtetë si më mbështeste ajo. Kisha patur të drejtë, kisha ende të drejtë, kisha gjithmonë të drejtë. Kisha jetuar në këtë mënyrë dhe nuk kisha jetuar ndryshe, ndonëse mund të jetoja edhe ndryshe. E pastaj? Ishte njëlloj sikur të kisha pritur gjatë tërë kohës këtë minutë dhe agimin e zbehtë kur do të vërtetohej se kisha të drejtë. Asgjë, asgjë nuk kishte rëndësi dhe unë e dija përse. Edhe ai e dinte përse. Nga thellësitë e së ardhmes sime, në rrjedhë të tërë jetës sime të pakuptimtë, po ngrihej drejt meje përmes viteve që nuk kishin ardhur ende një frymë e errët, e cila rrafshonte në rrugë e sipër çdo gjë që më propozonin për vitet aspak më të prekshëm se vitet që jetoja. E ç'rëndësi kishtë për mua vdekja e të tjerëve, dashuria e një nëne, ç'rëndësi kishte për mua Zoti i tij, jetët, fatet që zgjidhnin njerëzit, për deri sa

mua do të më zgjidhte vetëm një fat i vetëm dhe bashkë me mua miliarda të privilegjuar që, si ai, e mbanin veten për vëllezërit e mi. A e kuptonte këtë? A e kuptonte? Të gjithë ishin të privilegjuar. Vetëm të privilegjuar kishte. Edhe të tjerët do t'i dënonin një ditë. Edhe ai do t'i dënonte. E ç'rëndësi do të kishte sikur, i akuzuar për vrasje, ai do të ekzekutohej sepse nuk kishte qarë në varrimin e nënës? Qeni i Salamonos vlente po aq sa edhe gruaja e tij. Edhe gruaja e vogël automate ishte po aq fajtore sa parizienia me të cilën ishte martuar Masoni ose sa Maria që kishte dëshirë të martohej me mua. E ç'rëndësi kishte që Rajmondi qe shoku im po aq sa Çeleste që vlente më shumë se ai? Ç'rëndësi kishte që Maria ia falte sot buzët e saj një Mersoje tjetër? A e kuptonte, pra, ai prift, ai i dënuar me vdekje, se nga thellësia e së ardhmes sime... Po më merrej fryma duke shfryrë me të bërtitura gjithçka kisha përbrenda. Por, tashmë, rojtarët e burgut po më shkulnin nga duart priftin tërë kërcënime. Por ai i qetësoi dhe më vështroi për një çast në heshtje. Sytë i kishte plot me lot. U kthye nga dera dhe u zhduk. Qetësia m'u kthye, me t'u larguar prifti. Isha i rraskapitur dhe u hodha në shtrat. Më duket se fjeta sepse u zgjova me yjet mbi veten time. Zhurmat e fshatit erdhën deri tek unë. Aromat e natës, tokës dhe të kripës freskuan tempthat e mi. Prehja e magjishme e asaj nate të përgjumur vere hyri brenda meje si valët e para të baticës. Atë çast, diku Irag, në errësirë, ushtuan sirenat e anijeve. Ato lajmëronin nisjet drejt

një bote, për të cilën, tash e tutje, nuk doja t'ia dija. Për herë të parë, pas shumë kohësh, mendova për mamanë. M'u duk se e kuptova përse në fund të jetës kishte gjetur një "të fejuar", përse luajti në përtëritjen e jetës. Atje-tej, edhe atje-tej, rreth atij azili ku shuheshin jetët, mbrëmja ishte si një prehje e trishtuar. Mamaja, aq pranë vdekjes, duhej të ndjehej aty e çliruar dhe e gatëshme për të rijetuar çdo gjë. Askush, askush nuk kishte të drejtë të qante mbi të. Edhe vetë ndjehesha i gatshëm për të rijetuar gjithçka. Tërë ai tërbim i madh sikur më kishte pastruar nga çdo e keqe, sikur kishte shuar çdo shpresë dhe, për herë të parë, para asaj nate të ngarkuar me shenja dhe yje, i hapa zemrën mospërfilljes së dhimbsur të botës. Unë e ndjeva aq shumë të ngjashme me mua, aq shumë vëllazërore, sa në fund kuptova se kisha qenë i lumtur dhe se isha ende i lumtur. Dhe që fati im të kurorëzohej plotësisht, që të ndjehesha sa më pak vetëm, më mbetej vetëm të dëshiroja që ditën e ekzekutimit tim të kishte sa më shumë njerëz dhe të gjithë të më prisnin me britma urrejtjeje.

FUND